

Sazdovski
38 vjet burg
për Belën
dhe Demirin!

Fq.5




MICOTAKIS
Do të luftojmë
kundër
Marrëveshjes
së Prespës

Fq.3



Kur shqiptarëve
u merrej
shtetësia!
Dossier

Fq.16



Koha

www.koha.mk



Aty ku ezanin
e thërret një
i krishterë

Fq.17

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3643 · e mërkurë, 24 prill 2019

7°C | 23°C

15 DEN

AKTUALE

**Më pak
udhëtarë,
më shumë
shoferë!**



Ulet me të madhe numri i udhëtarëve që shfrytëzojnë shërbimet e transportit urban në Shkup. Raportet vjetore të punës financiare për punën e ndërmarrjes publike tregojnë se në vitin 2018, shërbimet e saja i kanë 52.990.214 udhëtarë, ndërsa katër vite më parë të njëjtat shërbime i kanë shfrytëzuar 44.726.781 udhëtarë. Kjo udhëzon se për katër vite është zvogëluar për afër 8 milionë, numri i udhëtarëve që shfrytëzojnë shërbimet e transporti... Fq.2

RAJON

**Pushtetarët
shpenzojnë
9 milionë euro
për dreka** Fq.14

REPORTAZH

**Nga Shkupi,
hare në
zemrat
arbëreshe!** Fq.12-13



TË PAPRITURAT E RAUNDIT TË DYTË

"ÇELËSI" TE SHQIPTARËT



Kryeministri Zoran Zaev dhe zyrtarë tjerë të shumicës parlamentare kanë theksuar se nëse kandidatja e opozitës që kryesohet nga VMRO-DPMNE, merr një votë më shumë se kandidati i tyre, do të shpallin menjëherë zgjedhje të parakohshme parlamentare Fq.4

Paga bruto mesatare, Maqedonia e treta në rajon

Shkup, 23 prill - Nëse punon në Shqipëri, paga që merr në fund të muajit është më e ulëta në të gjithë rajonin, për të gjithë sektorët, si në banka, sigurime, industri, bujqësi, arsim dhe sidomos në teknologji informacioni dhe shëndetësi. "Monitor" ka krahasuar pagat bruto mujore, sipas aktiviteteve ekonomike për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Serbinë e Malin e Zi, bazuar në të dhënat zyrtare që kanë pu-

blikuar institutet statistikore të secilit vend, ndërsa për Kosovën pagat publikohen të përmblidhura. Paga mesatare bruto në Shqipëri, prej rreth 50 mijë lekësh (gati 400 euro) është më e ulëta nga të gjitha vendet e rajonit. Më e larta është në Mal të Zi 765 euro, Serbi 644 euro, Maqedoni 591 dhe Kosova e parafundit 528 euro. Duhet pasur parasysh se Shqipëria është një nga vendet që ka evazionin... Fq.7



ANALIZË

LINDJE – PERËNDIM, NOTRE DAME- DJEGIA E HISTORISË

Nga Irida Vasia

Francezët panë të pafuqishëm pasditen e 15 prillit të materializojë përpara syve të tyre e paimagjinueshmja: Katedralja madhështore e Notre Dame-it, kryevepra arkitekturore që është ngritur krenare për tetë shekuj e gjysmë në peisazhin parizjen duke i rezistuar revolucionit francez dhe dy luftërave botërore, po gjunjëzohej fare papritmas përpara një armiku të djallëzuar e të pabesë. Ishte thujtë e pabesueshme ta shikojë gjigantin e heshtur të historisë të gllabërohej nga flakët me një shpejtësi rrënuese, si për t'i kujtuar kështu paturpësisht njerëzimit pafuqinë e tij.

Miliona vetët në Paris e nëpër botë që e panë strukturën unike të digjej, zor se mund të mos përfshihej nga një ndjesi dëshpërimi. Ndërtesa e ngritur në 200 vjet, u zhbë brenda ditës. Të gjithë kërkojnë arsye, justifikime, diçka që t'i ndihmojë të vajojnë humbjen e një pjese të bukurisë botërore.

"Notre Dame është më shumë sesa një objekt; kjo katedrale është e lidhur me vetë themelet e kulturës tonë. Emocioni që ajo ngjall nuk ka të llogaritur", tregon një banor.

"Nëse Parisi është Kulla Eiffel, atëherë Franca është Notre Dame. E gjithë kultura, e gjithë historia e Francës është mishëruar në këtë monument", thotë Bernard Lecomte, specialist në historinë fetare.

Alarmi i zjarrit në njërin prej objekteve më të vyer të Francës ra në 6:20 pasditen e së 15 prillit; u bënë disa kontrole por nuk u diktua gjë. Fatkeqësisht, nuk kishite qenë një alarm i rremë. Kur sinjali shfryu sërish në 6:43, ishte tepër vonë: flakët kishin përfshirë trarët e drunjte e po ngjiteshin të pamëshirshme drejt çatisë.

Besimtarë e turistë e zbrazen katedralen shume shpejt. 20 minuta më vonë, ende nuk dukej ndonjë gjurmë flakësh, sipas atyre që ndodheshin në vendngjarje. Megjithatë fakti që nuk e panë zjarrin, nuk do të thotë se ai nuk po gjallonte. Notre Dame kishte monitorues zjarri që e kontrollonin tre herë në ditë strukturën prej druri poshtë çatisë, veçse nuk kishte përkatës automatik uji e hapësira e papafingos së saj, e nuk që ndarë me mure mbrojtëse kundër flakëve. Fatmirësisht, nuk pati të vdekur, por me zjarrin që shkrumboi një pjesë jo të vogël të simbolit të katolicizmit në Francën e mburrur me laicitetin e saj, diçka u shua një herë e përgjithmonë: mundësia për të parë nga afër e për të prekur me dorë një pjesë të gati 1000 viteve histori.

Banorët e Parisit nuk po besonin dot syve; të pafuqishëm për të bërë diçka, impulsi tyre i parë ishte lutja. Ndërtesa historike u arrit të shpëtohej për vetëm 15 deri në 30 minuta; ekipi i 400 zjarrfikësve luftoi 15 orë me flakët, ama nëse nuk do ta shuante zjarrin brenda këtyre minutave kritike, Notre Dame mund të mos kishite shpëtuar.

Në mesazhin e tij në Twitter, Donald Trump, ndër të parët liderë botërore që reagoi ndaj fatkeqësisë, përcolli keqardhje për episodin, e shtroi dhe variant që në fakt, mund të ketë përshkruar mendjet e jo pak personave: mbi zjarrin të hidhej ujë nga lart, me avionë çisternë. Krerët e departamentit të zjarrfikësve, nuk është se nuk e kishin menduar këtë variant; çështja është se ata e kishin trajtuar me shumë kujdes të gjithë situatën: një skenar i tillë, jo vetëm nuk do të ndihmonte, por do ta rrezikonte edhe më shumë ndërtesën e dobësuar nga zjarri. Çelësi i zgjidhjes, ne ato moment, dukej

vetëm ulja e temperaturës brenda saj. përpjekjet për ta ftohur katedralen e përflakur, vazhduan përgjatë gjithë natës.

Era e drurit të përcëlluar të katedrales ikonë mbërriti deri në Vatikan. Papa Francesku falenderoi zjarrfikësit që nuk menduan për veten kur u hodhën të shpëtonin kishën e paçmuar.

"Mirënjohja e të gjithë kishës katolike shkon për ata që bënë çdo gjë mundën, që rrezikuan dhe jetët e tyre për ta shpëtuar bazilikën. Virgjëresha Mari e bekoftë të gjithë popullin francez dhe vetë punën e rindërtimit. Qoftë ajo një punë kolektive, në lëvdimin dhe glorifikimin e Zotit", do të deklaronte Papa Farnçesku.

Zjarrfikësit morën dhe meritën e shpëtimit të thesareve të katedrales gotike: zinxhiri njerëzor që ata krijuan, që vendimtar për nxjerrjen e relikeve të vyera fetare përfshirë kurorën e gjembave, e cila besohet të jetë vendosur në kokën e Jezusit gjatë kryqëzimit dhe tunikën e Shën Luigjit. Njerëzimi po kështu nuk do të privohet as nga mundësia për të parë një fragment, siç pretendohet të Kryqit ku thuhet se vdiq Krishti, dhe një gozhdë origjinale të përdorur në atë rast; ato u shpëtuan nga flakët bashkë me organon e famshme të madhe, një numër të konsiderueshëm artefaktesh e sklupturash, statuja e Shën Mërisë me fëmijën, ajo e Shën Denisit, shenjtit që mbron Parisin, si dhe piktura e dijetarit të madh të krishterë, Thoma D'Akuinos. Justinë, një inspektore sigurie, ishte pjesë e ekipit të cilit iu besua misioni i transportit të relikeve të vyera që arritën t'i shpëtonin zjarrfikësit duke i dërguar ato drejt hollit të bashkisë ku do të jenë të sigurta në pritje të verifikimit e meremetimit.

Notre Dame që do të thotë "Zonja Jonë", në nder të Shën Mërisë, u ndërtua në një ishull të vogël, të quajtur Île de la Cité, në mesin e Senës. Ngritja e saj filloi në 1163, gjatë sundimit të mbretit Luigji VII; gurin e parë e vendosi papa Alexander III, por do të përfundonte vetëm në 1345-sën. Që prej atëherë, ka qenë dhe mbetet xhevahiri i arkitekturës gotike. Pasi ndërtimi kishte filluar, iu shuan disa harkada nga jashtë; qëllimi ishte që ato të mbështesnin muret e katedrales elegante e të parandalonin krisjen e tyre, duke i përforcuar në të njëjtën edhe hijeshinë hijeshi pamjes e stilit të saj. gjatë revolucionit francez ne vitet 1790, katedralja do të dëmtohej e lihej pas dore; shpërfillja që rrethoi këtë bukuri për syrin dhe shpirtin u reflektua edhe tek romani i famshëm I Viktor Hygoi, "Katedralja e Parisit", ku gjiganti i letrave përcolli një tablo aq të saktë të gjendjes së mjerueshme të saj, sa tani, disa gjetën ngjashmëri mes përshkrimit që ai i bënte zjarrit të nisur nga Kuazimodo me atë që rrezikonte ta zhdukte tani.

Por, Notre Dame është djegur dhe më parë. Në fakt, godina aktuale është ngritur mbi një kishë të mëhershme, që e gjeti fundin mes flakëve. Zjarri e goditi përsëri në shekullin e 13-të, duke detyruar ripërsëritjen e punimeve ne periudhën e viteve 1230–1240.

Shpirti i një qyteti gjendet tek strukturat, ashtu si dhe tek historia dhe njerëzit e tij. Për Parisin, të humbiste Notre Dame-in do të thoshte të humbiste një pjesë të shpirtit të vet. Presidenti Emmanuel Macron u përpoq tua fashiste ca dhimbjen parizjenëve me premtimin ambicioz se "Zonja jonë" do të rindërtohet brenda pesë vjetësh.

SKANDALET QË SHPERFAQIN SHTETIN E DOBËT

"Tri skandale vetëm brenda një ditë që shpërfaqin sistemin e dobët shtetëror.

1. Një i luajtur mendsh, i cili si shumë "burra" të tjerë ka besuar se është në përgjegjësinë e tij që të marra masa ndëshkuese ndaj grave, kryen vrasje të dyfishte. Vret gruan e tij dhe të djalit

2. Një i ri nga Mitrovica mbetet në rrënoja të objektit të ish-hotel Adriatikut për shkak se punimet mbikëqyrshin nga joprofesionistet.
3. Bie në toke komplet plloqa e një kompleksi banesor në ndërtim e sipër, në Fushë Kosovë. Kjo ndodhi për shkak se ndërtimtarët janë mësuar që të ndërtojnë komplekse me material të dobët dhe të pambikëqyruar nga shteti.

Shpresoj që nuk ka ndodhur edhe ndonjë skandal tjetër sot. Tepër janë tre", ka shkruar një status në Facebook, gazetari nga Prishtina Parim Olluri.

LIBRAT JANË FENERË

"Libri mbetet mediumi më i qenësishëm i shpirtit njerëzor. Librat janë koha e thellë e rrojtes njerëzore, portat e hapjes ndaj universit të madhueshëm që përshpallë jetën në format më të papërsëritshme. Librat janë fenerë që shndërrim në rrugën drejt lartësisimit tonë...!", ka shkruar një status në Facebook, shkrimtari Bardhyl Zaimi.

SIKUR TË ISHA MAQEDONAS DO MË VINTE TURP NGA KJO "DREJTËSI"!

"Besir Bela dhe Skender Demiri u dënuan me 19 vite burg për rrahjen me pasojë vdekjen të Nikolla Sazdovakit, ky i fundit i dalluar për sjellje të rënda, por ajo që më bën përshtypje është se nga ana tjetër Boban Iliçi edhe pse vrau me dashje Almirin (një fëmijë shqiptar), është në liri!

Kam një pyetje për këta që votuan Pendarovskit, ju duket Drejtësia e Barabartë?! Apo konsensusi është: të pasurojmë nga 10 fise të BDI-së dhe gjithë popullin shqiptar të shkojë në Ferr?!

Nuk e di! Edhe sikur të isha maqedonas do më vinte turp nga kjo "drejtësi"!"; ka shkruar një status në Facebook, kryetari i Gostivarit, Arben Taravari.

TASH DO T'IU BESOJMË FILMAVE SERBË PËR TË VËRTETËN E LUFTËS SONË!

"Dokumentari serb për Kosharen disa gazetarëve tanë po iu shërben si burim dhe motivim për pyetjet e tyre drejtuar ushtarëve dhe eprorëve të UÇK-së!

Një gazetar duke shtruar pyetjen tha se kam përshtypjen se kjo ka ndodhë kështu e ashtu. Eprori shqiptar ia ktheu se nuk e ke përshtypjen, por e ke parë në filmin serb! Ç'të thoshte tjetër gazetari pos ta kafshonte buzën e ta përtypte marren e vet.

Sa lehte dikohemi!

Sa shpejt blejme!

Sa lirë shitemi!

Tash do t'iu besojmë filmave serbë për të vërtetën e luftës sonë. S'kanë edhe faj gazetarët. Këta të UÇK-së: Mos u besoni atyre të FARKUT! Ata të FARKUT: Mos u besoni këtyre të UÇK-së! Kështu gazetarët kanë vendosur t'i besojnë Serbisë!", ka shkruar një status në Facebook, Liri Loshi.

"Në argumentin themelor, përse dhënë gjuhë, identitet dhe kombësi, zoti Cipras asnjëherë nuk na u përgjigj. Përse sot duhej t'u jepnim mundësi fqinjëve tanë të quhen vetëm maqedonas, të flasin gjuhë maqedonase, gjuhë të cilën nuk e pranon as Bullgaria?", tha Micotakis

MICOTAKIS PREMTON BLOKIM TË MARRËVESHJES ATHINË-SHKUP

DO TË LUFTOJMË KUNDËR MARRËVESHJES SË PRESPËS



nas. Me fjalë të tjera, në kuadër të marrëveshjes do t'i mbrojmë interesat tona kombëtare dhe në lidhje me integrimin e vazhdueshëm të vendit fqinjë. Për këtë jam shumë i qartë. Greqia e mban, për çdo kapitull që hapet dhe mbyllet, mundësia për ta bllokuar procesin integruues, nëse vlerësohet, atë nuk e them apriori, them, nëse vlerësohet se nuk u shërben interesave kombëtare", thotë Micotakis.

Në lidhje me Marrëveshjen e Prespës, lideri Demokracisë së Re përsërit se ato kanë bërë gjithçka që mundën që të mos ratifikohet në Parlament dhe se akoma pret nga Ciprasi dhe deputetët e tij t'i japin sqarime qytetarëve nga Greqia e Veriut. Micotakis komentoi se "seriozisht dyshon se a do të mund t'i bindin". "Me të vërtetë do të doja, nëse mundet SYRIZA, por nuk mundet, të mbajë diskutim të organizuar dhe në njëfarë mënyre t'ju sqarojë maqedonasve, të gjithë

grekëve se pse në fund kjo marrëveshje është e mirë", thotë Micotakis në intervistë. Ai edhe njëherë përsërit se nuk kanë marrë përgjigje nga qeveria pse me marrëveshjen jepet mundësia për fqinjët "të quhen maqedonas dhe të flasin në gjuhën maqedonase". "Në argumentin themelor, përse dhënë gjuhë, identitet dhe kombësi, zoti Cipras asnjëherë nuk na u përgjigj. Përse sot duhej t'u jepnim mundësi fqinjëve tanë të quhen vetëm maqedonas, të flasin gjuhë maqedonase, gjuhë të cilën nuk e pranon as Bullgaria?", kumtoi lideri i partisë më të madhe opozitare greke në intervistën për TV "Alfa".

Në pyetjen se a është nder për Greqinë, nominimi i Ciprasi për Çmimin Nobel për Paqe për shkak të Marrëveshjes së Prespës, Micotakis përgjigjet negativisht. "Nuk konsideroj se në përgjithësi është nder, për shkak se është marrëveshje e keqe", përgjigjet shkurt kryetari i Demokracisë së Re.



Zgjedhja e shpejtë e shefit të shtetit, afrim drejt BE-së

Kavadar, 23 prill - U informova edhe për mënyrën, në të cilën janë zbatuar zgjedhjet. Kam vërejtur se jehona ka qenë mjaft e lartë në Kavadar. Kjo është dëshmi për pjekuri demokratike në Kavadar. Por, edhe për dëshirën që sa më shpejt të zgjedhet shefi i shtetit. Edhe neve na nevojitet kjo, sepse kjo do të thotë afrim drejt Bashkimit Evropian, theksoi sot ambasadori francez Kristian Timonie, dje në Kavadar. Timonie theksoi se i presin të gjitha idetë e mira që do të mund të marrin mbështetje franceze. Qëndrojnë në dispozicion edhe ambasada edhe instituti francez, që të mbështeten të gjitha idetë e mira. Kryetari i Kavadarit, Mitko Jançev tha se ambasadori francez është mik i Komunës së Kavadarit. Ai përkujtoi se Qeveria franceze tashmë ka paralajmërim për fonde jashtë Republikës së Francës. Për herë të parë e përfshin edhe Ballkanin.

Athinë, 23 prill - Do të luftojmë që ta mbështesim emrin apo imazhin e Maqedonisë, Maqedonisë së vërtetë do të thosha, Maqedoninë autentike, në gjuhën angleze do të ishte "Real Macedonia", ajo është Maqedonia jonë, thotë kryetari i Demokracisë së Re, Kirjakos Micotakis në intervistën e televizionit grek "Alfa" dhe sqaron se partia e tij do të fillojë fushatë komunikuese për "mbështetje të Maqedonisë". Micotakis shton se kjo ka të bëjë me prodhimet dhe markat tregtare, por edhe të perspektivës evropiane të vendit fqinj, duke përsëritur të drejtën e bllokadës, por apriori siç thotë, por vetëm nëse "ajo nuk u shërben interesave kombë-

tare", edhe njëherë potencon se do të bëjë gjithçka që t'i zbusë "pasojat negative" nga Marrëveshja e Prespës", tha Micotakis. Do të luftojmë, tha ai, që të mundet më intensivisht ta promovojmë unitetin e Maqedonisë. Të jap një shembull: për disa muaj në mënyrë solemne do të hapet Muzeu i Verginas. "Me të vërtetë do të dëshiroja kjo të jetë mundësi e madhe që të mund gjithë botës t'ia paraqesim madhësinë e civilizimit maqedo-

Publicitet



ПОЧИТУВАЈ, НЕ МРАЗИ!
RESPEKTO, MOS URRE!
SAYGI GÖSTER, NEFRET ETME!
RESPECT, DON'T HATE!



“ Klemens Koja
Shef i Misionit të OSBE-së në Shkup

Liria e fjalës buron nga ideja e të drejtave të barabarta për të gjithë. Megjithatë, ajo mund të keqpërdoret në situata kur grupe ose individë të caktuar shprehin ide rreth superioritetit të një race, feje apo kombi. Në këtë rast liria e shprehjes mund të shndërrohet në fenomenin e quajtur gjuha e urrejtjes. Ekzaminimi i simptomave dhe gjetja e mjeteve për parandalimin e gjuhës së urrejtjes kanë rëndësi thelbësore. Duke njohur rreziqet që paraqet urrejtja, ne në Misionin e OSBE-së në Shkup vazhdojmë të promovojmë dhe ndihmojmë në zhvillimin e instrumenteve efektive për të mundësuar një përgjigje më të fuqishme në luftën kundër gjuhës së urrejtjes.

Кампањата е иницирана и спроведена од АЗНММ | Fushata e iniciuar dhe realizuar nga AMMSHM | The campaign is initiated and implemented by APNPM

СЛОБОДЕН ПЕЧАЛ. Бечер ПОРТА.3 Капитал М Лажит ZAMAN БЕРИС БЕРИС

Кoha НЕЗАВИСЕН СЛОБОДЕН ЗЕЛИТ ШЕНЈА M Македонија

TË PAPRITURAT E RAUNDIT TË DYTË

"ÇELËSI" TE ELEKTORATI SHQIPTAR

Kryeministri Zoran Zaev dhe zyrtarë tjerë të shumicës parlamentare kanë theksuar se nëse kandidatja e opozitës që kryesohet nga VMRO-DPMNE, merr një votë më shumë se kandidati i tyre, do të shpallin menjëherë zgjedhje të parakohshme parlamentare

Koha Destan JONUZI

Shkup, 23 prill - Rezultatet e raundit të parë të zgjedhjeve presidenciale, si dhe migrimi i qytetarëve nga vendi, kanë nxitur debatin në opinion për arritjen e censusit në raundin e dytë. Në një garë të paqartë presidenciale, mbetet e hapur edhe ideja për zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe mënyra e zgjedhjes së Presidentit. Të gjitha partitë që morën pjesë në zgjedhjet presidenciale, që tre kandidatët në një farë mënyrë shpallën fitore. Njëra palë numëron komnatat ku ka fituar, tjetra vota, dhe e treta numëron votat e shqiptarëve.

"Të gjithë thonë se janë të kënaqur, ndërsa nga ana tjetër shohim se nuk janë edhe aq të kënaqur. Kjo është kështu për faktin që të tregohet se frymë fituese, pasi që te ne qytetarët rreshtohen pas fituesit. Të gjithë në raundin e dytë, fillojnë nga zero. Zoti Reka, i cili ra nga gara nuk mund ti ruajë votat në frigorifer apo në kuletën e tij, ata njerëz ashtu edhe siç thanë vetë, do të vendosin vet se si do të votojnë, edhe pse unë mendoj se edhe ndaj tyre do të bëhet një lloj fushate propagandistike, ndoshta edhe presion dhe tentime për blerje votash. Rrethi i dytë i zgjedhjeve mendoj se nuk do të jetë aq evropian sa rrethi i parë i zgjedhjeve, pasi vendoset në rrethin e dytë. Të gjithë ishim të vetëdijshëm se në rrethin e parë nuk mund të vendoset se kush do të jetë president, ky është njëri problem", deklaroi për gazetën KOHA, Eroll Rizaov, analist. Sipas tij, problemi tjetër është se të gjithë flasin për dalje të vogël në zgjedhje, por nuk është e vogël dalja.

"Sipas përlogaritjes time dalja në zgjedhje, nga numri i qytetarëve që janë prezent në Maqedoninë e Veriut, është mbi 65 për qind. Ne kemi 500 deri 600 mijë qytetarë të cilët janë jashtë vendit, të cilët në 10 vitet e fundit kanë migruar. Fakti tjetër është se kemi 20 deri 30



për qind të qytetarëve të cilët në asnjë cikël zgjedhor nuk kanë votuar. Ky rezultat afërsisht i barabartë midis pushtetit dhe opozitës është një motiv i mirë që të dilet në zgjedhje për arsye se të dyja palët mendojnë se do të fitojnë. Sipas meje censusi do të arrihet. Për këtë janë të interesuar edhe partitë shqiptare se kush do të jetë fitues për shkak të koalicioneve në të ardhmen", theksoi Rizaov. Ai thotë se çështja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare do të ngritet pas përfundimit të rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale.

Nga ana tjetër, analisti Daut Dauti, vlerëson se mundësia për zgjedhje të parakohshme parlamentare mund të shqyrtohet vetëm nëse pushteti i humb zgjedhjet përballë opozitës, por jo edhe nëse dështojnë ato.

"Është për t'u analizuar situata për shkakun e abstinencës në rrethinë e parë, nëse është shkak i hatrit ndaj kandidatit shqiptarë e nuk kanë dashur të votojnë kundër tij, ndërkaq nuk kanë dashur ta prishin lojalitetin ndaj partive të tyre. Një numër i shqiptarëve janë votues të partive politike në pushtet. Tash kanë më tepër motiv që të dalin në votime, por është shumë e diskutueshme çështja e censusit,

për arsye se ne nuk e dimë se a është abstinencia shkak i konfiguracioneve politike, apo shkak i mungesës së votuesve (migrimit)", tha për gazetën KOHA, Dauti.

Analisti Dauti, konsideron se zgjedhja e Presidentit në parlament do ti evitonte shpenzimet e pa nevojshme. "Madje një zgjidhje e tillë do të ishte e mirë për shkak të kompetencave të kufizuara të Presidentit, vetëm në disa fusha që nuk e arsyeton dalje në zgjedhje të përgjithshme. Edhe ato kompetenca që ka presidenti për nënshkrimin e ligjeve në disa fusha janë të ndërlidhura, p.sh kompetencat në sferën e mbrojtjes janë të ndërlidhura me kompetencat e ministrit. Mendoj se më e arsyeshme është që presidenti të zgjidhet në Parlament", nënvizoi Dauti.


Ndërkohë, analisti Dame Çkatroski, mendon se censusi në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale shumë lehtë do të arrihet, duke pasur parasysh rezultatet e raundit të parë. "Dy kandidatët janë afër fitores. Që të dy kandidatëve dhe partive të tyre që i mbështesin nuk u konvencojnë zgjedhjet parlamentare. Por, jo vetëm - edhe BDI-së dhe mbështetësve të Rekës. Sa të duan le të

flasin për zgjedhje të parakohshme, besoj se as teknikisht nuk është e mundur të realizohen. Bashkësia ndërkombëtare nuk mendon të lejojë zgjedhje të parakohshme parlamentare, ndërsa ne ende jemi në Marrëveshjet e Përzhinës dhe nën presion të BE-së që të kryejmë detyra të mëdha që vendit ti caktohet datë për fillimin e bisedimeve", thotë Çkatroski.


Mendoj, shprehet më tej ai, se do të arrihet censusi dhe se nuk do të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare. "Ashtu si edhe është bërë e zakonitë në këtë vend, elektorati shqiptarë vendos se kush do të jetë president. Që për mua nuk është edhe ndonjë opsion i keq", u shpreh ai. Ndërkaq, kryeministri dhe lideri i LSDM-së, Zoran Zaev, dhe zyrtarë tjerë të shumicës parlamentare kanë theksuar se nëse kandidatja e opozitës që kryesohet nga VMRO-DPMNE, merr një votë më shumë se kandidati i tyre, do të shpallin menjëherë zgjedhje të parakohshme parlamentare. Madje nga partitë në pushtet nuk është e pranueshme që të bisedohet me opozitën për zgjedhjen e Presidentit në Parlament. Ndërsa sa i përket çështjes së censusit, si çdo herë vendimtare janë votat e elektoratit shqiptar.

BE BËN THIRRJE PËR DALJE NË RAUNDIN E DYTË TË ZGJEDHJEVE

Raundi i parë i zgjedhjeve presidenciale kaloi në mënyrë të qetë dhe transparente, por nevojiten reforma shtesë në legjislacionin zgjedhor thonë, siç lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Brukseli, liderët evropianë. Zëdhënësjat e institucioneve të BE-së, Maja Kocijančič, për MIA-n porositi se, sipas raportit të misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR, "liritë fundamentale të bashkimit dhe shprehjes ishin respektuar", në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale dhe se vlerësimi i përgjithshëm për to është pozitiv. "Mbetet e nevojshme të finalizohen reformat e filluara paraprakisht të legjislacionit zgjedhor", përkujton Kocijančič.




Bashkimi Evropian u bë thirrje qytetarëve të Maqedonisë së Veriut ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre në raundin e dytë më 5 maj masivisht të dalin të votojnë. "I inkurajojmë qytetarët ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre demokratike dhe të marrin pjesë në numër të madh në raundin e dytë që vota e tyre të bëhet e vlefshme", konsiderojnë liderët evropianë. Në mënyrë shtesë, Brukseli i porositi të gjitha palët "t'i sigurojnë kushtet e nevojshme për proces zgjedhor kredibil dhe transparent dhe stabilitet të përgjithshëm politik", qëndron në kumtesën e BE-së për raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale.




EROLL RIZAOV

Të gjithë në raundin e dytë, fillojnë nga zero. Zoti Reka, i cili ra nga gara nuk mund ti ruajë votat në frigorifer apo në kuletën e tij, ata njerëz ashtu edhe siç thanë vetë, do të vendosin vet se si do të votojnë, edhe pse unë mendoj se edhe ndaj tyre do të bëhet një lloj fushate propagandistike, ndoshta edhe presion dhe tentime për blerje votash. Rrethi i dytë i zgjedhjeve mendoj se nuk do të jetë aq evropian sa rrethi i parë i zgjedhjeve, pasi vendoset në rrethin e dytë



DAUTI DAUTI

Është për t'u analizuar situata për shkakun e abstinencës në rrethinë e parë, nëse është shkak i hatrit ndaj kandidatit shqiptarë e nuk kanë dashur të votojnë kundër tij, ndërkaq nuk kanë dashur ta prishin lojalitetin ndaj partive të tyre. Një numër i shqiptarëve janë votues të partive politike në pushtet. Tash kanë më tepër motiv që të dalin në votime, por është shumë e diskutueshme çështja e censusit, për arsye se ne nuk e dimë se a është abstinencia shkak i konfiguracioneve politike, apo shkak i mungesës së votuesve (migrimit)



DAME ÇKATROSKI

Bashkësia ndërkombëtare nuk mendon të lejojë zgjedhje të parakohshme parlamentare, ndërsa ne ende jemi në Marrëveshjet e Përzhinës dhe nën presion të BE-së që të kryejmë detyra të mëdha që vendit ti caktohet datë për fillimin e bisedimeve. Mendoj se do të arrihet censusi dhe se nuk do të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare. Ashtu si edhe është bërë e zakonitë në këtë vend, elektorati shqiptarë vendos se kush do të jetë president. Që për mua nuk është edhe ndonjë opsion i keq

Ka reaguar edhe vëllai i të akuzuarit Besir Bela, Besar Bela. Pas vendimit më nga 19 vite burg, Besar Bela tha se nuk janë të kënaqur nga vendimi dhe se do të ankohen në Gjykatën e Apelit. "E pamë se ende nuk ka drejtësi në Maqedoni, kjo është e tepërt dhe është gjykim i njëanshëm", theksoi Besar Bela

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 23 prill - Trupi gjyqësor ka dënua me 38 vjet burg Besir Belën dhe Skender Demirin. Vendimi e shpalli gjykatësja Daniella Aleksavska - Stojanovska, ndërsa siç edhe pritej nga seancat gjyqësore, i bëri fajtor për vepër penale "vrasje në mënyrë mizore" dhe që të dy u dënua me nga 19 vjet burg. Rasti filloi më 9 nëntor të vitit të kaluar dhe e udhëhoqi gjykatësja Daniella Aleksavska - Stojanovska. Më 7 shkurt të këtij viti ishte bërë rikualifikim i vrasjes së Sazdovskit nga "dhunë me pasojë vdekje" në "vrasje në mënyrë mizore", ndërsa rikualifikimi u bë pas presionit të opinionit maqedonas dhe madje edhe politikanëve, siç ishte rasti me deputetin e LSDM-së, Pavle Bogvoevski që kërkoi dënim maksimal për "vrasje mizore".

"Gjatë sulmi i ndjeri Sazdovski ka përjetuar stres të rëndë psikologji, i është shkaktuar dhimbje shpirtërore, e cila fare nuk i ka prekur vepruesit. Ata kanë qenë të vetëdijshëm për dhimbjen që ia kanë shkaktuar të dëmtuarit. Njëkohësisht, ata kanë vepruar tre ndaj një. Të akuzuarit, të cilët kanë qenë në gjendje të mirë psikike, pas rënies së Sazdovskit, kanë vazhduar ta godasin. Është humbur një jetë e re, i është cenuar e drejta njerëzore. Dëmi ndaj familjes aspak nuk mund të kompensohet", tha gjykatësja Aleskovska-Stojanovska. Sipas aktakuzës, Bela dhe Demiri së bashku me J.L. (19) i cili është në arrati, më 29 qershor të vitit të kaluar, e kanë rrahur Sazdovskin në

SHPALLET VENDIMI PËR RASTIN "SAZDOVSKI"

38 VJET BURG PËR BELËN DHE DEMIRIN!



stacionin e autobusit para fabrikës "Alkoholoid" në bulevardin "Aleksandër Makedonski" në Autokomandë. Nga lëndimet e mara, Sazdovski më 9 korrik të vitit 2018 humbi jetën në Klinikën për Mjekim Intensiv - KARIL në Qendrën Klinike "Nëna Terezë".

"Asnjë nënë nuk duhet ta varrosë djalin e saj", kanë qenë fjalët e para të Toni Sazdovskit, babait të Nikollës së ndjerë. "Dënim, për fat të keq, është aq sa e ka parapare ligji. Në Maqedoni nuk ka dënim më të madh për persona deri në 20 vjet. Megjithatë, për ne si prindër dhe për mua personalisht edhe mijëra vite duhej dënuar, gjegjësisht nuk ka gjykatë, e cila do të përcaktonte dënim të vërtetë për këtë vepër", tha Toni Sazdovski pas gjykimit në Gjykatën Penale të të akuzuarve për vrasjen e djalit të tij.

"Nuk mund të them se nuk jam i kënaqur siç ka spekulum në opinion se në Maqedoni nuk ka aspak drejtësi. Prej kësaj pamë se sa drejtësia mund të përmbushet dhe shpresoj se ndonjë gjykatë më e lartë nuk do ta ndryshojë, por do ta le të njëjtën", theksoi Sazdovski. Ai prindërve të të gjykuarve i porositi që ta thonë të dyshuarin e tretë i cili është në arrati, sepse siç tha, është sigurt se ata e dinë se ku ndodhet, ta thonë dhe të mos lejojnë që fëmijët e tyre vetë të mbesin në burg, por si bashkëpunëtor i tyre edhe ai ta bartë pjesën e tij të fajit për veprën të cilën e ka kryer.

"Për Nikollën nuk ka kthim. Të gjithë ata që e njihnin, ndërsa e njihnin shumë persona, e dinin se ai nuk ishte i dhunshëm, dëshironte të shoqërohej me të

gjithë", tha Sazdovski. Ai sqaroi se dëmi material nëse ndonjëherë paguhet në çfarëdo lloj forme do të donohet për qëllime humanitare, gjegjësisht siç tha, ato do të donohen për turneun në futboll në fshatin Rakotinci i cili organizohet për nder të Nikolla Sazdovskit, si dhe për qëllim të tjera humanitare. Ka reaguar edhe vëllai i të akuzuarit Besir Bela, Besar Bela. Pas vendimit më nga 19 vite burg, Besar Bela tha se nuk janë të kënaqur nga vendimi dhe se do të ankohen në Gjykatën e Apelit. "E pamë se ende nuk ka drejtësi në Maqedoni, kjo është e tepërt dhe është gjykim i njëanshëm", theksoi Besar Bela.

Ndryshe, dy nga sulmuesit, Besir Bela dhe Skender Demiri, janë në paraburgim në burgun "Shkupi" në Shutkë, ndërsa për të dyshuarin e tretë, i cili është i pakapshëm për organet e përndjekjes, është shpallur urdhërarrest në vend dhe jashtë vendit. Prokuroria Themelore Publike për vrasjen e të riut Nikolla Sazdovski - Sazdo tre të dyshuarit i ndjek për veprën penale "vrasje në mënyrë mizore", vepër e cila para rikualifikimit konsiderohej si "dhunë".

SHKUP, 8 AKSIDENTE ME 7 TË LËNDUAR

Shtatë persona janë lënduar më lehtë në katër nga gjithsej tetë aksidente të evidentuara në 24 orët e fundit në rajonin e SPB Shkup. Janë sanksionuar 18 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, janë përjashtuar dhjetë persona para se të marrin të drejtën e lejes për vozitje, si dhe 11 automjete të parkuara, dy të ngarkuara dhe një me pengesa teknike. Janë shqiptuar 86 masa për parkim të parregullt, ndërsa karrotreci ka marrë 59 automjete.

Paditen prindërit e tre fëmijëve që vdiqën në Veles

Shkup, 23 prill - Akuzë kundër gruas 38 vjeçare dhe burrit 46 vjeçar ka ngritur Prokuroria Publike deri te Gjykata Themelore në Veles, sepse secili nga ata ka kryer vepër penale "lënie pas dore dhe maltretim i fëmijës". Në periudhën kohore në të cilën fëmijët janë lënë vetë, në shtëpinë kishte shpërthyer zjarr në të cilin të gjithë tre fëmijët e kishin humbur jetën. Siç kumtoi Prokuroria Publike, e akuzuara

si prind - nëna e fëmijëve të moshës prej katër viteve, dy viteve dhe një viti, ndërsa i akuzuari si prind - babai i fëmijës së moshës prej një viti nuk e kishte mbrojtur jetën dhe shëndetin e fëmijëve që është kompetencë e tyre sipas dispozitave të neneve 44 dhe 46 të Ligjit për familje. Njëherësh, i akuzuari si njeri i dy fëmijëve të tjerë gjithashtu ishte i obliguar që të kujdeset për ta duke pasur parasysh fak-

tin se jetonin së bashku dhe kishte pozitën e mbrojtësit ndaj tyre, por nuk e kishte mbrojtur jetën dhe shëndetin e tyre. Dy të akuzuarit më 20 qershor të vitit 2018 e kishin lënë anash detyrën e kujdesit dhe edukimit dhe i kishin lënë pas dore tre fëmijët kështu që për një kohë të gjatë ditës i kishin lënë fëmijët vetë në shtëpinë në të cilën jetonin, ndërsa e cila përbëhej vetëm prej një hapësire. Nga Prokuroria

Publike thonë se bëhet fjalë për fëmijë të cilët sipas moshës së tyre nuk mund të kujdeseshin vetë për vete. Me atë që i kishin lënë vetë në shtëpi të akuzuarit kishin vepruar me papërgjegjësi dhe nuk mbanin llogari për jetën dhe shëndetin e tyre. Në periudhën kohore në të cilën fëmijët ishin lënë vetë, në shtëpi kishte shpërthyer zjarr në të cilin tre fëmijët e kishin humbur jetën.

KRONIKË

Ndërron jetë në aeroplan

Gjysmë ore pas mesnate, në "Aeroportin ndërkombëtar Shkup" ka aritur një aeroplan i cili ka qarkulluar në relacionin Bazel-Shkup dhe është raportuar se në të ka pasur një person i cili nuk ka dhënë shenja jete. Siç njoftoi MPB-ja, në orën 00.50 nga ana e mjekut u konstatua vdekje pa gjurmë të dhunës tek K.K (74) nga Gostivari. Pas urdhrat të prokurorit publik trupi i të ndjerit i është dorëzuar në familje.

Paditet kumanovari për racizëm në Fejsbuk

Kallëzim penal është ngritur kundër një kumanovari për përhapje të materialit racist dhe ksenofob përmes një sistemi kompjuterik. SPB Kumanovë dje ngriti kallëzim penal kundër I.J. (43) nga fshati Pelincë, Komuna Nagoriçan i Vjetër për shkak të dyshimit se ka kryer vepër penale "përhapje të materialit racist dhe ksenofob përmes një sistemi kompjuterik, neni 394-g, faqe 1 nga KP i RMV. Siç kumtoi MPB-ja, veprën e ka kryer të dielën përmes rrjetit sociale Fejsbuk.

Lëndohet një nxënës me thikë në Tetovë

Të hënën, rreth orë 11 e 55 minuta, në Sektorin për punë të brendshme Tetovë, personi kujdestar në Spitalin klinik të Tetovës ka denoncuar se ndihmë mjekësore ka kërkuar një nxënës 14 vjeçar, i cili ka pasur lëndime në formë të prerjeve në dorën e djathtë, të cilat me mjet të mprehtë ia ka shkaktuar një nxënës tjetër 15 vjeçar i shkollës fillore "Bratsvo Migjeni" në Tetovë. Janë marrë të gjitha masat dhe aktivitetet për zbardhjen e plotë të rastit.

Saraqinë, i shkruajnë grafitë ofenduese në shtëpi

Të hënën, rreth orës 09.00, në Stacionin policor Grupçin, 63 vjeçari R.V nga fshati Saraqinë, ka denoncuar se në periudhën prej orës 23.00 të datës 21 prill, deri në momentin e denoncimit, nga ana e personave të panjohur në derën hyrëse prej hekuri, të shtëpisë në të cilën jeton 65-vjeçari L.B. nga fshati Saraqinë, nga person i panjohur, me ngjyrë të zeze janë shkruar grafitë me përmbajtje fyese dhe kërcënuese. Janë duke u ndërmarrë të gjitha masat dhe aktivitetet adekuate, për zbulimin e kryerësve të kësaj vepre dhe zbardhjen e plotë të rastit. (U.H)

Liberalizimi i tregut postar në Republikën e Maqedonisë Veriore do të riaktivizojë konkurrencën dhe do të sjellë përfitime të rëndësishme për shfrytëzuesit shërbimeve postare në aspektin e shërbimeve moderne, e cila gjithashtu do të jetë më e arritshme

Koha

Qefsera ABDYLI

Shkup, 23 prill - Qytetarët e Maqedonisë së Veriut janë të revoltuar për shërbimin e dobët që ata marrin kur bëhet fjalë për shpërndarjen e letrave apo mallrave që iu dërgohen nëpërmjet postës. Pjesa më e madhe e qytetarëve thonë se problemet me shpërndarjen e letrave janë të njëjta, kur ato dorëzohen nga "Posta e Maqedonisë", kompani e vetme kjo e cila ka të drejtë për të shpërndarë letra të cilat peshojnë deri në 50 gram.

"Ne u ofrojmë përdoruesve shërbime postare, informacione rreth mënyrës së funksionimit të trafikut postar, por gjithashtu theksojmë të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore, duke e bërë më të lehtë realizimin e tyre. Qytetarët shpesh ankohen për vonesën e letrave të thjeshta, siç janë faturat, njoftimet etj, të dërguara në postë të madhe, më saktësisht nga operatorët mobil, shërbimet komunale, bankat, kompanitë e sigurimeve etj", tha drejtoresha e Agjencisë Postare, Biljana Avra-

CILËSIA E TRAFIKUT POSTAR

QYTETARËT TË PAKËNAQUR



movska Gjoreska. Të dhënat e Agjencisë Postare tregojnë se shumica e ankesave nga përdoruesit janë adresuar në "Postën e Maqedonisë", mirëpo nga kjo agjenci theksojnë se kjo pritet plotësisht duke pasur parasysh faktin se "Posta e Maqedonisë", ka 94.3 për qind të tregut postar maqedonas dhe 80 për qind e veprimtarive të saj bazohen në shërbimet e zakonshme të postës që dorëzohen në kutitë postare. Raporti Statistikorë për vitin 2018, përgatitur nga Agjencia Postare, tregon se ka rreth 3.000 ankesa të dërguara në "Postën e Maqedonisë", nga qytetarët e pakënaqur në vëllimin e realizuar prej 35 milion

sendeve postare.

Raportet e Entit Shtetërorë të Statistikave tregojnë se ka pasur rënie të vazhdueshme të dërgesave në vitet e fundit dhe sipas kësaj, një nga arsyet për rënie e këtyre shërbimeve është cilësia e pamjaftueshme e ofrimit të artikujve postare. Për shkak të kësaj situatë, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë bëri thirrje për liberalizimin e këtij tregu sa më shpejtë të jetë e mundur dhe theksojnë se konkurrenca do të përmirësojë shërbimin për qytetarët. Sipas Ligjit për shërbimet postare, "Posta e Maqedonisë" ka të drejtën ekskluzive për shpërndarjen e letrave me vlerë deri në fund të vitit 2019, edhe pse

Maqedonia është zotuar që në vitin 2007 me miratimin e Strategjisë për zhvillimin e shërbimeve postare për të futur liberalizimin e plotë të postës së tregut dhe të krijojë kushte jo diskriminuese të punës për të gjithë pjesëmarrësit e tregut.

"Liberalizimi i tregut të shërbimeve postare duhet të kryhet në vitin 2020 që do të shfrytëzojë të drejtën ekskluzive e "Postës së Maqedonisë" dhe do të lejojë të gjithë ofruesit e shërbimeve postare të operojnë në treg dhe të ofrojnë shërbime për të drejtat dhe detyrimet e barabarta. Në një treg të liberalizuar, konsumatorët vendosin për të zgjedhur në varësi të

mundësive për të përmbushur kërkesat dhe në varësi të cilësisë, shpejtësisë, pikave të hyrjes, të tilla si zgjidhjen e problemeve. Ne besojmë se liberalizimi i tregut postar në Republikën e Maqedonisë Veriore do të riaktivizojë konkurrencën dhe do të sjellë përfitime të rëndësishme për shfrytëzuesit shërbimeve postare në aspektin e shërbimeve moderne, e cila gjithashtu do të jetë më e arritshme", shtoi drejtoresha e Agjencisë për zyrtat postare.

Drejtoresha sqaron se në agjenci, përdoruesi mund të kundërshtojë vetëm nëse me parë i ka shfrytëzuar të drejtat me operatorin postar. Ajo shton se këto janë ankesa klasike për funksionimin e operatorëve, të cilëve Agjencia Postare në një afat të caktuar ligjor është përgjegjëse ose vendos të ushtrojë të drejtat e transportuesve të dërgesave. Agjencia vendos për ankesën administrative brenda 30 ditëve nga dita e pranimit. Ata theksojnë se operatori postar nuk është gjithmonë fajtor për vonimin e llogarive mujore të qytetarëve. Gjithashtu shtojnë se ka edhe shumë probleme me paketa drejtuar gabimisht për shkak të proceseve të migrimit të popullsisë, nuk janë vende të populluara me asnjë sistem rrugorë, dhe shumë qytetarë kanë vendosur kuti postare ose ata janë të lirë dhe të dëmtuar, kështu që ndikon në shpejtësinë dhe besueshmërinë e dorëzimit.

Në vitin 2018, huadhënësi ndërkombëtar investoi më shumë se 1.1 miliard euro në Ballkanin Perëndimor përmes 67 projekteve, ndërsa objektivi i BERZH është të investojë 40% të angazhimeve të saj vjetore në ekonominë e gjelbër deri në vitin 2020

Shkup, 23 prill - Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) synon të investojë përsëri rreth 1.1 miliardë euro në Ballkanin Perëndimor këtë vit, me fokus në sektorin privat, lidhjen dhe tranzicionin në ekonominë e gjelbër, sipas presidentit të BERZH-it, Suma Chakrabarti.

"Ne jemi një partner i vjetër i rajonit, i përkushtuar për të mbështetur ndërtimin e një ekonomie

BERZH-i TREGON INVESTIMET NË RAJON

MBI 1.1 MILIARDË EURO PËR BALLKANIN

që u lejon njerëzve të saj, sidomos të rinjve, të vendosin talentet e tyre dhe të përfitojnë nga përpjekjet e tyre në vendin e tyre. financimi i nevojave të vendeve, por gjithashtu duhet të jetë një rritje e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për t'i shërbyer popullit të tyre", tha Chakrabarti për SeeNews në një intervistë. Në Kosovë, BERZH po synon një rritje të ndjeshme të investimeve të saj - deri në 100 milionë euro në vit gjatë periudhës së ardhshme, nga 52 milionë euro në vitin 2018.

"Në total, ne kemi investuar 363 milionë euro në 63 projekte në Kosovë deri më sot. Sfidat që duam të trajtojmë janë të ngjashme me ato të rajonit më të gjerë: nxisin potencialin e sektorit privat, forcojnë integrimin dhe adresojnë sfidën e energjisë", tha Chakrabarti. Në vitin 2018, huadhënësi ndërkombë-

tar investoi më shumë se 1.1 miliard euro në Ballkanin Perëndimor përmes 67 projekteve. "Prioritetet tona janë zhvillimi i sektorit privat si motori i rritjes, punësimi dhe inovacionit, lidhja si një koncept që mbështet integrimin e rajonit jo vetëm në kuptimin fizik (infrastrukturë), por edhe përmes ndihmës për tregti dhe investime rajonale dhe krijojnë kushtet për përafrimin e BE-së dhe kalimin në një ekonomi të gjelbër duke adresuar sfidat urgjente mjedisore dhe gjithashtu duke rritur mbështetjen e vendeve në burimet e ripërtërishme të energjisë", shpjegoi Chakrabarti.

Për energjinë e rinovueshme, ai shtoi "jemi duke punuar ngushtë me autoritetet për të finalizuar kuadrin rregullator në një formë që do të mundësojë investime në energji të pastër". Presidenti i

BERZH tha gjithashtu se është i bindur se takimi vjetor i bankës në Sarajevë në maj do të ndihmojë në nxitjen e investimeve në të gjithë rajonin. Përveç përkrahjes për integrimin rajonal të Ballkanit Perëndimor, BERZH është e angazhuar fuqishëm për integrimin e saj në BE me investime, si dhe me këshilla për reformat ekonomike dhe institucionale. Është gjithashtu një investitor i madh në shumicën e projekteve të mëdha të transportit dhe infrastrukturës energjetike që lidhin rajonin me Europën.

"Ne jemi shumë të përfshirë në investimet në infrastrukturën mjedisore, siç është trajtimi i ujërave të zeza ose menaxhimi i mbeturinave të ngurta - një fushë tjetër e mbështetjes për vendet që zbatojnë acquis të BE-së", tha Chakrabarti. "Përveç marrjes së normave të BE-së si pjesë e standardeve të

projektit, ne gjithashtu ndihmojmë në ndërtimin e institucioneve më të mira në kuadër të Iniciativës tonë 'Klima për Investime' dhe 'Iniciativa Qeverisëse'. Nën këto nisma promovojmë integrimin rajonal përmes mbështetjes së bashkëpunimit rajonal të dhomave të tregtisë ose krijimit të një platforme investuese rajonale nëpërmjet lidhjes së bursave kombëtare". Qëllimi i BERZH është krijimi i një sektori energjetik, i cili siguron energji të pastër, të sigurt dhe të përballueshme, tha Chakrabarti, duke shtuar se edhe para se banka të përfundonte investimet e reja, projektet e saj të energjisë së ripërtërishme tashmë e kishin tejkaluar investimin e saj në lëndët djegëse fosile. Objektivi i BERZH është të investojë 40% të angazhimeve të saj vjetore në ekonominë e gjelbër deri në vitin 2020.

Deri më 30 prill të dorëzohen Paraqitja tatimore vjetore

Shkup, 23 prill - Më 30 prill skadon afati përfundimtar për dorëzim të Paraqitje tatimore vjetore për vërtetimin e tatimit personal të të ardhurave për vitin 2018 për qytetarët nga ana e Drejtorisë për të ardhura publike (DAP), ndërsa aktiviteti për gjenerim dhe dorëzim të Paraqitjeve tatimore vjetore është në vijim. Tatim-paguesit - personat fizikë, që janë regjistruar në sistemin "e-Tatim personal" përmes profileve të tyre shfrytëzuese mund të kryejnë verifikim në Paraqitjet tatimore vjetore, informon DAP. "Qytetarët kanë mundësi më së voni deri më 31 maj ta konfirmojnë apo korrigjojnë Paraqitjen preliminare tatimore vjetore. Deri në përfundim të afatit përfundimtar ligjor, qytetari mund ta ndërrojë statusin e paraqitjes, gjegjësisht ta vërtetojë apo korrigjojë. Pas skadimit të afatit ligjor, gjegjësisht më 1 qershor, Paraqitjet tatimore vjetore do të marrin status të paraqitjeve përfundimtare tatimore, konform statusit të fundit të Paraqitjes tatimore vjetore - të konfirmuar apo korrigjuar, thonë nga DAP do të vërtetohen edhe Paraqitjet tatimore vjetore, të cilat nuk janë as të vërtetuara, as të korrigjuara nga ana qytetarit. Paraqitjen tatimore vjetore të cilën qytetari e ka korrigjuar, ndërsa ka marrë status të paraqitjes tatimore përfundimtare, porosisin, do të duhet të aprovohet nga një person zyrtar i Drejtorisë për të ardhura publike. "Nëse personi zyrtar nuk e aprovon paraqitjen do të pasojë marrje e vendimit për vërtetimin të tatimit personal të të ardhurave për vitin 2018", precizojnë nga DAP. Nga Drejtoria apelojnë që qytetarët që kanë realizuar të ardhura, ndërsa ende nuk janë regjistruar në sistemin e-Tatim personal, këtë ta bëjnë në afat të shkurtër të mundshëm.

Paga mesatare bruto në Shqipëri, prej rreth 50 mijë lekësh (gati 400 euro) është më e ulëta nga të gjitha vendet e rajonit. Më e larta është në Mal të Zi 765 euro, Serbi 644 euro, Maqedoni 591 dhe Kosova e parafundit 528 euro

Shkup, 23 prill - Nëse punon në Shqipëri, paga që merr në fund të muajit është më e ulëta në të gjithë rajonin, për të gjithë sektorët, si në banka, sigurime, industri, bujqësi, arsim dhe sidomos në teknologji informacioni dhe shëndetësi.

"Monitor" ka krahasuar pagat bruto mujore, sipas aktiviteteve ekonomike për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Serbinë e Malin e Zi, bazuar në të dhënat zyrtare që kanë publikuar institutet statistiko-re të secilit vend, ndërsa për Kosovën pagat publikohen të përmblendhura. Paga mesatare bruto në Shqipëri, prej rreth 50 mijë lekësh (gati 400 euro) është më e ulëta nga të gjitha vendet e rajonit. Më e larta është në Mal të Zi 765 euro, Serbi 644 euro, Maqedoni 591 dhe Kosova e parafundit 528 euro. Duhet pasur parasysh se Shqipëria është një nga vendet që ka evazionin më të lartë në sigurimet shoqërore, çka nënkupton që pagat reale mund të jenë dhe më të larta, pasi INSTAT deklaroi pagat në bazë të informacionit nga Tatimet, për të cilat paguhen sigurime shoqërore.

Profesioni më i paguar në të gjithë rajonin është ai i bankierëve në Mal të Zi, ku mesatarisht fitohet rreth 1440 euro në muaj (aktivitetet financiare dhe të sigurimit). Edhe në Shqipëri, ky aktivitet është më i paguari në raport me të tjerët brenda vendit, me rreth 840 euro po sërisht mbetet më i nënpaguar në rajon. Në Serbi dhe Maqedoni, aktivitetet financiare dhe të sigurimit paguajnë përkatësisht rreth 1000 dhe 1200 euro bruto në muaj, rreth 20-40% më shumë se në Shqipëri. Duhet pasur parasysh se ky sektor

SHQIPËRIA KA PAGAT MË TË ULËTAT NË TË GJITHË SEKTORËT PAGA BRUTO MESATARE, MAQEDONIA E TRETA NË RAJON



VIZION, TRAJNIM, TEKNOLOGJI NË 20 VITET E ARDHSHE

"Vizion, trajnim, teknologji në 20 vitet e ardhshme" është quajtur konferenca e grupit punues të konsorciumit të NATO/PpP (partneritet për paqe) për mësim të avancuar në distancë që këto tre ditë mbahet në Shkup, në organizim të Akademisë ushtarake dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Në këtë grup punues vendi ynë merr pjesë nga viti i kaluar kur është ftuar përmes programit DIP, të sponsorizuar, informoi Mitko Bogdanovski, prodekan i Akademisë ushtarake "Gjeneral Mihajlo Apostollski" në Shkup. Qëllimi është, theksoi ai, që të ndahen përvojat, për shkak se në

përgjithësi, siç sqaroi, të gjithë bazohemi në platforma të ngjashme, megjithatë mënyrat, në të cilat shfrytëzohen ndoshta ndonjëherë nuk janë adekuate apo nuk shfrytëzohen në tërësi. "Mes tjerash qëllimi është që të ndahen përvojat për atë si në mënyrë më adekuate t'i shfrytëzojmë dhe metodologjitë, respektivisht qasjen e shfrytëzimit të këtyre platforma", deklaroi Bogdanovski. Ai theksoi se Akademia ushtarake në tërësi i ruan instruksionet që i merr nga NATO-ja sepse ka disa projekte, me të cilat edukim shtesë me kuadrin e tyre.

në vendin tonë është më i formalizuar, ndaj dhe pagat janë reale.

Mali i Zi mban rekord dhe për pagat që jep në sektorin e bujqësisë, me 770 euro në muaj, pothuajse e barabartë me pagën mesatare të atij vendi. Nëse je një ekspert i teknologjisë së informacionit, vendet e rajonit që të paguajnë më shumë janë Maqedonia dhe Serbia, me përkatësisht rreth 1100 dhe 1200 euro në muaj, që është pothuajse dyfishi i asaj që merr i njëjti ekspert në Shqipëri. Në Serbi, një programues kompjuteri merr mesatarisht 1500 euro bruto, sipas të dhënave më të detajuara nga Zyra Statistikore e Serbisë. Edhe në Maqedoni, një programues kompjuteri merr 1530 euro. Të nënpaguar në raport me

rajonin janë dhe punonjësit shqiptarë në sektorin e industrisë përpunuese, me rreth 270 euro, ndërsa në rajon paguhen të paktën dyfishin. Edhe industria nxjerrëse, ndonëse nga paga më të lartë, rreth 600 euro, sërisht i ka gati sa gjysma e rajonit në të njëjtën kategori. Edhe në shtet, ku evazoni është zero, sërisht administrata publike shqiptare, mjekët, mësuesit janë më pak të paguarit. Paga mesatare në shtet (Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale) është 480 euro në Shqipëri, rreth 530 euro në Kosovë, rreth 670 euro në Maqedoni, 760 euro në Serbi dhe më e larta në Mal të Zi me rreth 880 euro. Mali i Zi është vendi që ka të ardhur

rat më të larta për frymë në rajon, me rreth 475 të mesatares së Bashkimit Europian, nga 30% që e ka Shqipëria, sipas statistikave të tjera të Eurostat, më e ulëta në Europë.

Në arsim, mësuesit shqiptarë paguhen mesatarisht 20-50% më pak se në vendet e tjerë fqinjë (gati 500 euro në Shqipëri, kundrejt 725 euro në Mal të Zi). Në shëndetësi, mjekët e infermierët shqiptarë paguhen mesatarisht 50-80% më pak se homologët e tyre në rajon (425 euro paga mesatare në shëndetësi, kundrejt 820 euro në Mal të Zi). Se fundmi edhe Kosova dyfishoi pagat për sektorin e shëndetësisë duke paguar me rreth 1200 euro një mjek specialist dhe mbi 500 euro një infermier.

Gjysma e grave, jashtë tregut të punës

Shkup, 23 prill - Një e treta e grave bejone se përkatësia e tyre është të kenë fëmijë dhe të kujdesen për shtëpinë dhe familjen dhe në plan të dytë e kanë përfitimin, derisa shumica e grave, 52.8 për qind, pajtohen se detyrimet e amvisërisë i pengojnë të punojnë jashtë shtëpisë. Këtë e theksoi Vesna Ivanoviq, udhëheqëse e Zyrës së "UN Woman" në Shkup në promovimin e djeshëm të video fushatës "A e di" të përgatitur nga Komiteti i Helsinkit

për të Drejtat e Njeriut. Videoja është në suaza të projektit "Gratë kanë të drejtë", ndërsa financohet nga Bashkimi Evropian "UN Woman". Qëllimi i projektit është ngritja e vetëdijes publike për parandalimin, mbrojtjen dhe uljen e diskriminimit mbi gratë.

"Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës për vitin 2018, numri i përgjithshëm i grave të punësuar vitin e kaluar ka qenë 39,6 për qind. Gjysma e grave janë

jashtë tregut të punës, ndërsa nëse përfshihen në tregun e punës, në pjesën më të madhe përballen me diskriminim", tha Ivanoviq. Urania Pirovska, drejtoreshë ekzekutive e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, sqaroi se në vitin 2015 dhe 2016 ka pasur jashtëzakonisht një numër të madh të vrasjeve të grave nga ana e partnerëve apo ish-partnerëve të tyre apo anëtarë të familjeve të tyre të gushtë, dhe për këtë, siç tha, në shtetin tonë ende

nuk ka përgjegjësi përkatëse të kërkesave të grave që do të sillte deri te barazia e drejtë dhe reale në shoqëri. "Në videot përqendrohemi në aspektet kryesore që do të thonë disa qasje deri te shërbimet e ndryshme apo qasje deri te drejtësia, dhe do të kuptojmë se në realitet bëhet fjalë për një mungesë sistematike të një jo kulture sistematike dhe të mungesë së vetëdijes, para së gjithash të atyre që duhet në mënyrë parimore dhe kur guas i

nevojitet, ta ofrojnë ndihmën përkatëse. Këtu mendoj për gratë të cilat janë viktimat të dhunës familjare, ndërsa për të cilat as nëpunësit policorë as të punësuarit në qendrat për punës sociale nuk prononohen në mënyrë në të cilën guas do t'i mundësonin ta tejkalojnë stresin, sëmundjen fizike, traumën, as megjithatë ekziston ndonjë këshillim çfarë më tej do t'i ndihmojë të riintegrohet në shoqëri", tha Pirovska.

NDOTJA E AJRIT DHE TRANSPORTI URBAN

MË PAK UDHËTARË, MË SHUMË SHOFERË!

Nga Qyteti i Shkupit thonë se punojnë jo vetëm në vendosjen e tramvajit si mjet transportues në Shkup, por edhe në ndryshimin e linjave të autobusit. Me fjalë të tjera, planifikohet që sistemi i ri i linjave të autobusit të jetë komplementar me lëvizjen e tramvajit



të veturave të regjistruara në Shkup prej 122 mijë në vitin 2012 në mbi 143 mijë mijë në vitin 2017, që në mënyrë shtesë ka rritur ndotjen në Shkup. Në ndërkohë, autoritetet e qytetit të Shkupit thonë se deri në fund të vitit me një kredi të vlefshëm 10 milion euro nga Banka Evropiane për rindërtim dhe zhvillim do të blejnë ndërmjet 35 dhe 50 autobusë me gaz, që do të nxjerrin nga përdorimi autobusët e vjetër që ndotin ambientin. Ekspertët e komunikacionit thonë se në Shkup nevojitet të vendoset transport më i shpejtë me kapacitete më të mëdha që do të marrin parasysh edhe uljen e ndotjes së ajrit. Profesi universitar Nikolla Krstanovski thotë se në Evropë ekzistojnë 34 qytete me madhësi të ngjashme me Shkupin, ku kryeqyteti jonë i vetmi nuk ka transport me një efikasitet të lartë dhe nuk ka as tramvaj, autobusë të shpejtë apo rrjet ndër urban të

hekurudhës, Nga ana tjetër, përkundër vendosjes së më shumë masave si autobusë të rinj, sistemit të ri të biletave, Qendrës për menaxhim dhe kontroll të transportit, akoma transporti urban nuk është tërheqës për qytetarët.

“Zhvillimi i rrjetit transportues nuk e ndjek zhvillimin urban, ndërsa kemi edhe konflikt midis linjave direkte dhe nevojës për transport të udhëtarëve me shpejtësi të ulët dhe xhirot e ulët të autobusëve, apo pasagjerët duhet të kalojnë nga autobusi në autobus duke humbur kohë në pritje. Njëherazi edhe shpejtësia e transporti urban nuk mund të krahasohet me veturat, apo autobusët nuk janë konkurrues me veturat”, shton më tej Krstanovski. Sipas tij, në tollovitë më të mëdha në transportin urban në Shkup, në një linjë pritjet edhe nga gjashtë minuta, ndërsa pritjet për një autobus mund të zgjasin edhe

10 deri 40 minuta, andaj edhe transporti urban nuk është edhe aq tërheqës për udhëtim.

“Zgjidhje për këtë problem është vendosja krahas autobusëve në transportin urban edhe të transportit të shpejtë dhe me kapacitete më të mëdha të bartjes së udhëtarëve siç është për shembull tramvaji. Nëse pasagjerët kanë mundësi që shpejt dhe në mënyrë komode të arrijnë deri tek një destinacion, ato vetë gradualisht do të heqin dorë nga përdorimi i veturave”, thotë eksperti Krstanovski.

Në ndërkohë nga Qyteti i Shkupit thonë se punojnë jo vetëm në vendosjen e tramvajit si mjet transportues në Shkup, por edhe në ndryshimin e linjave të autobusit. Me fjalë të tjera, planifikohet që sistemi i ri i linjave të autobusit të jetë komplementar me lëvizjen e tramvajit nëpër rrugët e kryeqendrës së vendit, apo pasagjerët do të kenë mundësi shpejt të kalojnë nga një mjet transportues në tjetrin. Njëherazi punohet që Shkupi të fitojë sistem efikas, ekologjik dhe financiarisht të qëndrueshëm të transportit publik. I tërë projekti i tramvajit në Shkup do të kushtojë afër 270 milionë euro i financuar me të holla nga fondet evropiane apo nga arka e shtetit. Planifikohet që fillimisht të vendoset në funksionim traseja prej Novo Lisiçe deri në Gjoçe Petrov, traseja e dytë do të jetë prej Draçeve deri në Butel, e treta prej Avtokomande deri në Bit-pazar, dhe e katërta prej Gjoçe Petrov deri në Saraj.

Ndryshe, në vendosjen e sistemit të tramvajit do të përdoren edhe përvojat e qytetit të Zagrebit ku në qendër të qytetit në minimum qarkullojnë autobusët urban, ndërsa më shumë qarkullon tramvaji për transport të udhëtarëve në transportin urban.

Maqedonia më rritje më të madhe të bujtjeve

Krushevë, 23 prill - Maqedonia në vitin 2018 ka realizuar rritje më të madhe në Evropë, në numrin e bujtjeve të turistëve, ndërsa Krusheva së bashku me Shkupin, Ohrin dhe Manastirin janë udhëheqësit e kësaj rritje, shkruan ueb-portali <https://www.travel-advisor.eu>. Sipas këtij portali, në Maqedoni janë rreth 250 hotele të kategorizuara dhe shumë akomodime private, dhe gjithsej vlerësohet se turistët kanë në dispozicion mbi 34.000 shtrëtrë. Më të vizituara janë Shkupi, Ohri, Manastiri, Krusheva, zonat malore dhe të verës. Rritja në numrin e vizitave turistike prej 22 për qind është sukses i madh dhe Maqedoninë e vendos në majë të destinacioneve turistike kur flitet për rritjen e bujtjeve, shkruan portali. Autoritetet lokale të Krushevës janë tejet të kënaqur që qyteti është në majën e destinacioneve në Maqedoni të dëshiruar për turistët. Në vitin 2018 Komuna e Krushevës shënon rritje prej 67 për qind në numrin e bujtjeve dhe vetë kjo tregon se interesi për Krushevën si destinacion bëhet gjithnjë më i popullarizuar. Komuna përgatit broshura promovuese, ueb-faqe dhe aplikacion, video promovuese dhe vizita të një pjese të panairëve në fqinjësi të shtetit. Sipas kryetarit të Krushevës, Tome Hristovski, përpjekja e komunës tashmë po jep rezultat, ndërsa turizmi është në fokus të punës.

Koha Fiskik PASHOLLI

Shkup, 24 prill - Ulet me të madhe numri i udhëtarëve që shfrytëzojnë shërbimet e transportit urban në Shkup. Raportet vjetore të punës financiare për punën e ndërmarrjes publike tregojnë se në vitin 2018, shërbimet e saja i kanë 52.990.214 udhëtarë, ndërsa katër vite më parë të njëjtat shërbime i kanë shfrytëzuar 44.726.781 udhëtarë. Kjo udhëzon se për katër vite është zvogëluar për afër 8 milionë, numri i udhëtarëve që shfrytëzojnë shërbimet e transporti urban në Shkup. Në ndërkohë përkundër ndotjes së madhe që po ndodh dimrit në kryeqendrën e Maqedonisë së veriut, jo vetëm që nuk kemi rritje të shfrytëzimit të transportit urban, por përkundrazi kemi rritje të numrit

TË PREMTEN TRANSPORTI PUBLIK SIPAS ITINERARIT PËR TË DIELËN

Me rastin e festave të ardhshme të Pashkëve, të premtën, më 26 prill, automjetet e transportit publik do të qarkullojnë sipas itinerarit për ditën e diel, me përjashtim të autobusëve të linjave 11, 11A, 18A, 32, 47A, 51, 55, 55B, 56, 56A, 64A, 70, 74, 80A, 81, 118, 160, 180, që do të qarkullojnë sipas itinerarit të javës. Të shtunën 27 prill, të dielën 28 prill, dhe të hënën 29 prill, autobusët e të gjitha linjave do të transportojnë sipas itinerarit për ditën e diel”,

kumtoi JSP. Autobusët sipas itinerarit të qarkullimit javor do të punojë zakonisht të gjitha ditët e festave prej orës 10 deri 18, ndërsa autobusët që transportojnë deri në Vodno e Mesme 25 (Qendra e transportit-Vodno e Mesme) dhe 25B (Shtëpia e shtypit-Vodno e Mesme) të hënën, 29 prill, do të transportojnë sipas itinerarit të ditës së diel. Teleferiku të martën më 30 prill, nuk do të punojë.

PREZANTOHEN POTENCIALI TURISTIK I IRANIT

VIZAT, ARSYE PËR VIZITAT E DOBËTA TURISTIKE

Shkup, 23 prill - Regjimi i vizave dhe njoftimi i pamjaftueshëm me kapacitetet turistike janë pengesë kryesore për shifrën e pakënaqshme të vizitave turistike mes Iranit dhe Maqedonisë së Veriut. Ambasadori i shtetit islamik Iran, Husein Kerimi theksoi se prezantimi i djeshëm i potencialeve turistike të Iranit, është pikërisht në funksion të shkaktimit të interesit për rritje të bashkëpunimit turistik, për çka thotë, potencialet janë të mëdha.

“Mes gjashtë-tetë milion iraniane në vit dalin nga vendi për qëllime turistike. Nëse arrijmë vetëm një për qind të tërheqim në Maqedoni ajo do të jetë e kënaqshme”, tha ambasadori Kerimi në



prezantimin e pasuar me prezantimin e filmit të shkurtër për bukuritë, përmendoret kulturore-historike dhe vendet e shenja për turizëm fetar të Iranit dhe me ekspozitë të vogël të zejtarisë iraniane

tradicionale. Ai konsideron se për vendosje të bashkëpunimit nevojitet nismë e operatorëve turistik nga vendi për bashkëpunim me agjencitë turistike iraniane. Mënyra më e mirë për të ardhur

deri te partneriteti është me vizitën e panairëve të mëdha turistike në Teheran dhe në Isfahan.

Në lidhje me vizat, ambasadori Kerimi shton se Ambasada është e gatshme të ndihmojë me dhënien e vizave për vizitat turistike në afat të mundshëm më të shkurtër, duke theksuar se aplikimi mund të bëhet edhe nëpërmjet rrugës elektronike nga cilido vend. Tashmë kanë biseduar edhe me MPJ-në tonë për lehtësim të dhënies së vizave për vizitat grupore turistike. Operatorët turistik të Maqedonisë pajtohen se vizat janë problemi më i madh për vendosjen e bashkëpunimit më të rëndësishëm ekonomik, që është, thonë,

rast edhe me Kinën dhe kërkojnë lehtësim të regjimit të vizave.

Biljana Pejoska Risteska nga Oda ekonomike për turizëm të Maqedonisë thotë se për turistët iranian procedura për dhënien e vizave është e komplikuar dhe duhet të aplikojnë në ambasadën tonë në Turqi. Kryetari i Odës për turizëm të Maqedonisë Kasam Shakiri, theksoi se ky është takimi i parë i llojit të tillë me Ambasadën iraniane e cila shpreson se do të ndihmojë për njoftim më të mirë me ofertën turistike të këtij vendi dhe realizimin e bashkëpunimit. Iranin në vit e vizitojnë rreth tre milionë turistë të huaj, kryesisht nga Evropa, SHBA-ja, Kanada. (Z.V)

Ky ishte panairi i 14 me radhë që është organizuar nga qendra për karrierë ku kanë marrë pjesë mbi 80 kompani dhe organizata të ndryshme nga Maqedonia të cilat aktivitetin, ofertat e tyre i kanë prezantuar përpara studentëve, stafit akademik dhe mysafirëve të tjerë. Ky Panair paraqet mundësi për studentët të takohen me punëdhënësit potencial dhe të bisedojnë për punësimin e tyre ose për angazhim si praktikant

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 23 prill - Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë për herë të katërbëdhjetë ka organizuar panairin e karrierës që organizohet nga qendra për karrierë pranë këtij Universiteti. Mbi 80 kompani pjesëmarrëse të vendit, në këtë mënyrë janë më afër studentëve, të cilët mund të gjejnë veten e tyre qoftë për të kryer praktikën, por edhe punësimin në të ardhmen. Pikërisht edhe kjo ka qenë ideja që ky panair të mbahet çdo vit, që punëdhënësit të njihen me kuadrot që ofrojnë universitetet, por edhe studentët të mund të gjejnë veten e tyre. Në këtë panair studentët gjithashtu kishin mundësi edhe të aplikonin për punë duke dorëzuar CV-t e tyre. Për rëndësinë që ky panair ka për studentët, universitetin dhe komunitetin e biznesit foli rektori i Universitetit të Evropës Juglindore,

NË UEJL ORGANIZOHET PANAIRI I KARRIERËS

MBI 60 PËR QIND E TË DIPLOMUARVE GJEJNË PUNË



akademik Abdylmenaf Bexheti, i cili theksoi se prodhojnë kuadër adekuat për tregun e punës.

"Duhet ta ndjekim zërin e punëdhënësve dhe së bashku me takime të tilla, si Panairi, ne tentojmë ta afrojmë ofertën e njerëzve të arsimuar drejt konsumit të kuadrit profesional, që u është e nevojshme kompanive. Ne i ndjekim studentët tanë përmes 'Qendrës Alumni' dhe mund të them se prej 60 deri në 65 për qind e studentëve të diplomuar punësohen që në vitin e parë pas përfundimit të arsimit. Tash më 14 vjet, i ndërtojmë urat me bashkësinë e biznesit dhe kjo është e pashmangshme. Me kompanitë u dakorduar se cilat programe spe-

cifike t'i vendosim. Kështu është edhe me shembullin me programin 'Sipërmarrësia' për vitin e ardhshëm, kemi 50 bursa nga një kompani. Ky do të jetë program rajonal në gjuhën angleze, në të cilin do të përfshihen edhe vendet e rajonit", tha rektori Bexheti. I pranishëm në këtë panair ishte edhe kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore, i cili theksoi se ky panair paraqet një mundësi të veçantë për studentët, kompanitë dhe universitetet për të thelluar bashkëpunimin mes tyre.

"Prezenca e mbi 84 kompanive në këtë panair tregon se bashkëpunimi mes universiteteve dhe sektorit të biznesit po sjell rezulta-

te, sepse shumë studentë e gjejnë vendin e tyre në sektorin e biznesit. Ne, përveç panairëve iniciojmë edhe tribuna me qëllim që të jemi në trend me lidhjen e biznesmenëve dhe institucionet arsimore, sepse shpresa e biznesit është tek të rinjtë e diplomuar që dalin nga universitetet", tha Nebi Hoxha, kryetar i OEMVP-së. Përfaqësuesit e kompanive, të cilat kishin shpalosur ofertat e tyre në këtë panair, thonë se bashkëpunimi mes sektorit të biznesit dhe institucioneve akademike është në nivelin e duhur, dhe se çdo vit kuadrot që prodhojnë këto institucione angazhohen si praktikant në kompani të ndryshme të cilët më vonë edhe punësohen varësisht kuali-

fikimit të tyre. Ky ishte panairi i 14 me radhë që është organizuar nga qendra për karrierë ku kanë marrë pjesë mbi 80 kompani dhe organizata të ndryshme nga Maqedonia, të cilat aktivitetin, ofertat e tyre i kanë prezantuar përpara studentëve, stafit akademik dhe mysafirëve të tjerë. Ky panair paraqet një mundësi të mirë për studentët që ata të takohen punëdhënësit potencial, ku kanë mundësi të diskutojnë rreth mundësive të punësimit, angazhimit të tyre si praktikant në ndonjërin prej këtyre kompanive, si dhe për të diskutuar rreth përshtatshmërisë së kualifikimeve dhe aftësive të tyre me kërkesat e tregut të punës apo kompanive në fjalë.

Tek Liqeni i Dibrës gjendet një bombë e vjetër dore

Dibër, 23 prill - Në bregun e Liqenit të Dibrës në vendin e quajtur "kurora" dje është gjetur një bombë e vjetër dore. Një kalimtar i rastit e ka vërejtur bombën në orën 13:35 minuta ku më pas ka raportuar në Stacionin e Policisë në Dibër. "Rajoni u siguroi nga nëpunës policorë deri në orën 18, kur një nëpunës i autorizuar nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit e ka sekuestruar mjetin. Konstatohet se bëhet fjalë për një bombë dore të prodhimit italian nga Lufta e Dytë Botërore, deklaroi Stefan Dimoski, zëdhënësi i Sektorit të Punëve të Brendshme nga Ohri.

VAKSINIMI NË TERREN

NË GOSTIVAR JANË VAKSINUAR 83 PËR QIND TË FËMIJËVE

Gostivar, 23 prill - Në rajonin e Gostivarit, me MRP nuk janë vaksinuar 350 fëmijë prej të cilëve numri më i madh janë nga qyteti. Në shkollë vaksinë kanë marrë 25 fëmijë. Sipas punonjësve shëndetësorë, përfshirja me vaksinim në tre muajt e parë të vitit ka mbërritur 83 për qind, që është përmirësim i caktuar krahasuar me vitin e kaluar. Prej sot ka filluar edhe imunizimi në terren.

"Për qindja e fëmijëve të vaksinuar është rritur, po kjo nuk është e kënaqshme. Veçanërisht edhe për shkak të faktit që përqindjen e rrisin pikat shëndetësore, ndërsa në qytet përfshirja edhe më tej është e ulët. Për këtë shkak u bëj apel prindërve të mos bien në fushat kundër vaksinimit, sepse vakcina është mënyra më e sigurt për mbrojtje", thonë nga Reparti



për imunizim në Shtëpinë Shëndetësore Gostivar. Theksuan se kanë marrë sasi shtesë të vaksinave MRP furnizimet janë mbushur me vakcina nga prodhuesi holandez. Nga paraqitja e fruthit, në Gostivar janë regjistruar 25 persona të sëmurë të moshave të ndryshme. Paraqitja e fruthit në Gostivar,

punonjësit shëndetësorë e sqarojnë edhe me përfshirjen me vaksinimin e vitit të kaluar, që ka arritur 52 për qind. Nga 822 fëmijë, të cilët i janë nënshtruar vaksinimit, vitin e kaluar janë imunizuar 432 fëmijë dhe ka qenë përfshirje më e vogël në 40 vitet e fundit.

Në ndërkohë, në Shkup janë

vaksinuar 12.468 fëmijë të moshës deri 14 vjeç prej 16.361 fëmijëve të pavaksinuar. Në qendrat e tjera për shëndet publik në mbarë vendin, janë vaksinuar 7.776 fëmijë prej 26.495 fëmijëve të pavaksinuar. Vetëm me shkallë të vaksinimit prej mbi 95 për qind, do të sigurojmë imunitet kolektiv dhe do të pamundësohet përhapja e virusit mes popullatës, deklaroi për MIAn anëtari i Komisionit për sëmundje ngjitëse pranë Ministrisë së Shëndetësisë, dr. Vladimir Mikiq. Prindërit, theksoi, i dëgjuan rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe e njohën rëndësinë për vaksinim me kohë të fëmijëve me vaksinën MRP. "Të gjithë fëmijët të cilët janë të pavaksinuar, që të mbrohen nga komplikimet e mundshme duhet të vaksinohen menjëherë", shtoi dr. Mikiq.

S'ka shkop magjik që na çliron nga Trumpi apo Brexiti

Nga
Nesrine MALIK



Gati një vit më parë, Radio Publike Amerikane, NPR, intervistoi biografin e Robert Mylerit, Garet Graf. Libri ishte një hagiografi klasike amerikane. Myleri "i pasur", shkoi të studiojë në Universitetin e Prinstonit, pastaj ndoqi shokun e tij të ngushtë Dejvid Haket në Luftën e Vietnamit, pasi Haket u vra në përpjekje për të shpëtuar një togë ushtarësh që kishte rënë në një pritë. Biografi i tij, ishte kujdesur të përmendte që në fillim se Myleri në fakt, nuk kishte të drejtë të shërbente në ushtri. Një gju i lënduar, e kishte përjashtuar nga rradhët e ushtrisë, por pas 1 viti shkëputje, ai kërkoi më ngulm të shkonte në front. Në Vietnam u mbulua me lavdi, dhe fitoi medaljen e trimërisë për shpëtimin e 2 marinsave të plagosur.

Intervista ishte e ngarkuar me shumë nëntekste. Kishim pra një njeri, që ishte antimateria e Donald Trumpit. Një njeri, që kishte një arsye legjitime të mos shkonte në luftë, ndryshe nga ai që ju e dini, dhe që megjithatë luftoi. Detyra për të shkatërruar Trump, dhe rikthimin e SHBA-së në statusin e saj të dikurshëm, nuk mund t'i jepej një figure më të përshtatshme se ai. Një republikani, që ka luftuar në frontin e luftës. Legjenda e Mylerit, u shkrua përpara se ai ta jetonte atë. Perversioni historik i ngjarjeve që e çuan Trumpin në Shtëpinë e Bardhë, mund të kishte ndodhur vetëm nëse do të kishte ndërhyrë një fuqi e huaj nihiliste. Kjo, dhe telashet e tij ligjore, me siguri që do ta fundosnin Trumpin. Por nuk qe e thënë. Ndërsa raporti i Mylerit nuk është publikuar tërësisht, tani më është e qartë se Trump nuk do të fajësohet për ndonjë shkelje, dhe do të garojë për një mandat të dytë. Për SHBA-në nuk do të ketë pra një ndryshim të shpejtë të gjendjes ku ndodhet.

Midis besimtarëve të një "Russiagate", ka nga ata që mund ta ketë shfrenuar deri diku fantazinë. Por është një pilulë që është kuptueshmërisht e vështirë për t'u gëlltitur, që pavarësisht të gjitha shkeljeve të Trump, nuk do të ketë asnjë gjykim penal. Dhe çfarë ndodh tani? Raporti i Mylerit, kishte investuar shumë tek ideja, se e gjitha kjo mund të jetë thjesht një ëndërr e keqe. Kjo është një jehonë e refrenit të vitit 20017, se "Hilari Clinton e fitoi votën popullore". Edhe nëse kolegji zgjedhor nuk është më i përshtatshëm për qëllimin, rreziku i vërtetë me të cilin duhet të ballafaqohemi, është fakti pse Trump mori kaq



shumë vota. Por jo, liberalët i thonë vetes se fajin e ka sistemi, se është Rusia ajo që sulmoi Komitetin Kombëtar Demokrat, se këtu ka ndikuar edhe shkarkimi i Xhejms Komejt, dhe se është përgjegjësi e "The New York Times" që mbuloi gjerësisht hakerimin e vjedhjes kibernetike të e-maileve të Klintonit.

Ajo që ne duhet të pranojmë, është se mund të jenë edhe që të gjitha këto gjëra, por ato sërish nuk ndryshojnë faktin se miliona njerëz votuan për Trumpin, për të rikthyer nativizmin, dhe për t'u shkaktuar dhimbje të tjerëve. Ta mohosh këtë, do të thotë të jesh ende i dehur nga teoria e "jashtëzakonshmërisë amerikane", pavarësisht të gjitha fakteve

kundër në 3 vitet e fundit.

Kjo tregon se sa shumë të izoluar janë disa, nga mënyra se si funksionon aktualisht SHBA-ja. Ata që merren me politikën më të zhurmshme të Trump - mbi njerëzit me ngjyrë, emigrantët dhe myslimanët - nuk kanë fantazi të tilla për SHBA-në "e vërtetë". Një arratisje e ngjashme nga realiteti, ndodh edhe me shkeljet mbi financimin e fushatës, apo parregullsitë e financimit të fushatës pro Brexit. Votuesit iu nënshtruan propagandës së djathtë kundër BE-së dhe emigracionit, shumë kohë përpara se të mbahej referendumi. Masat financiare shtrënguese dhe fragmentarizimi, bënë pjesën tjetër. Asnjë nga këto nuk është e thjeshtë për t'u

Brexit dhe Trump nuk ishin perversione të shkaktuara nga aktivistët e korrumpuar, por kulmime natyrale të dështimeve disa dekadëshe të politikës. Është koha të përballemi me këtë realitet, dhe të heqim dorë nga "mbulesat komode" psikologjike. Sikurse thoshte Maja Angelu, kur kombet tregojnë se kush janë, besojuni atyre herën e parë



përtytur. Dhe kështu, në vend të kësaj, një referendum i dytë bëhet shkop i një magjik, "raporti Myler" i Mbretërisë së Bashkuar. Por nuk ka asnjë mënyrë për të dalë nga ky debat. Fiksimi pas diferencës së ngushtë të humbjes në referendum, e humbet fokusin nga thelbi. Miliona votues britanikë, mund të mos e dinin në detaje se mbi çfarë po votonin, ata mund të mos ishin në gjendje të kuptonin dallimin midis një bashkimi doganor dhe anëtarësimit në një treg të përbashkët. Por ata e dinin se çfarë ishin duke refuzuar: emigrantët, një sistem ekonomik të fragmentuar, një parlament jo përfaqësues. Disa votues pro Brexit, janë duke i kërcënuar gazetarët, dhe sillen rreth figurave të Tereza Mej dhe Sadik Khan, të tjerë thjesht e shohin Brexit-in si mënyrën e fundit për të rifituar njëfarë kontrolli mbi jetën e tyre. Brexit dhe Trump nuk ishin perversione të shkaktuara nga aktivistët e korrumpuar, por kulmime natyrale të dështimeve disa dekadëshe të politikës. Është koha të përballemi me këtë realitet, dhe të heqim dorë nga "mbulesat komode" psikologjike. Sikurse thoshte Maja Angelu, kur kombet tregojnë se kush janë, besojuni atyre herën e parë.

(The Guardian)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përvjeç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë, 23 prill 2019 | Numri i parë i gazetës do të më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Dy anët e medaljes së problemit të largimit të të rinjve



Nga Augustin PALOKAJ

Por largohem, sepse jashtë vendit më respektojnë më shumë dhe e vlerësojnë punën. "Nuk kam pasur mundësi të gjej punë në vendin tim, sepse nuk jam i lidhur me asnjë parti politike". "Kam mbaruar fakultetin, por nuk arrita të gjej punë". Këto janë arsytet më të shpeshta që i përmendin të rinjtë, që e lëshojnë vendin e tyre për të punuar në ndonjë shtet tjetër. Këto nuk janë vetëm arsytetime të të rinjve nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Bosnjë-Hercegovina. Janë më së shpeshti arsytet të cilat i përmendin të rinjtë nga Kroacia, të cilët në numër jashtëzakonisht të madh largohen nga shteti i tyre. Që nga hyrja në BE e këtij shteti më të ri anëtar, më 1 korrik të vitit 2013, supozohet se nga Kroacia janë larguar afro 200.000 të rinj. Ky është numri i banorëve të Splitit, qytetit të dytë më të madh në Kroaci. Pra, për më pak se shtatë vjet pothuajse është zhdukur popullsia e qytetit të dytë më të madh. Shumica e të rinjve kroatë kanë shkuar në Gjermani dhe Irlandë, në një masë edhe në Austri e vende të tjera të BE-së. Kjo dukuri në Kroaci është quajtur si tragjedi kombëtare. Qeveria po tenton të gjejë një strategji afatgjate demografike. Sepse në të njëjtën kohë Kroacia ka mbetur pa fuqi punëtore në shumë sektorë. Për këtë vit Kroacia lëshon rreth 65.000 leje pune për të huajt. Sepse në sektorin e ndërtimit, turizmit dhe bujqësisë nuk ka punëtore. Shumë kompani po e ulin prodhimin, po anulojnë porosinë, sepse nuk po gjejnë punëtore. E në Dublin, Limerik dhe vende të tjera të Republikës së Irlandës po krijohen klube kroatë, Kisha katolike i dërgon priftërinjtë për të mbajtur meshën në gjuhën kroatë, ndërsa shumica e të rinjve thonë se, me përjashtim të ardhjes në pushime, nuk mendojnë të kthehen. Sepse thonë se e kanë gjetur lumturinë e tyre në këtë vend, ku pothuajse gjithmonë bie shi. Diellin e Kroacisë thonë se e kanë mall, por kur u kujtohet fati në vendin e tyre, duke kërkuar punë, e duke jetuar nga pensioni i prindërve deri sa nuk gjenin punë, duke parë bashkëmoshatarët të përparojnë, sepse kanë lidhje politike, atëherë thonë se më të lumtur janë në Irlandë dhe aty mendojnë se do të krijojnë familje dhe t'i edukojnë fëmijët. Sepse edhe shkollat në Ir-

landë janë më të mira, edhe shërbimet shëndetësore janë më të mira. Dhe, thonë, shumë pak dëgjojnë debate politike irituese.

Para disa muajsh komisionari i BE-së për Bujqësi, Philip Hogan, tregonte në Bruksel se sa i lumtur ishte kur shihte të rinjtë nga Kroacia në qytetin e tij në Irlandë, duke shërbyer në një restorant. Për këtë komisionar kjo ishte një shenjë e mirë. Ishte një shenjë se të rinjtë nga Kroacia po e shfrytëzojnë një prej të arriturave më të mëdha të projektit të integrimi evropiane, atë të lëvizjes së lirë të punëtoreve. Ai madje refuzonte ta quante këtë si „emigrim të fuqisë punëtore“ pasi në BE ekziston një treg i vetëm, i përbashkët unik i punës. Pra, formalisht, të shkojë dikush nga Sllavonki Brodi apo Osijeku për të punuar në Dublin apo Bruksel është njëllë sikur të shkojë në Zagreb. Ai i ka të gjitha të drejtat në secilin vend të BE-së, sikur edhe punëtoret vendas. Përfshirë edhe shtesat për fëmijë dhe asistencën sociale. Në rastin e Rumanisë apo Bullgarisë, punëtoret nga këto shtete në disa shtete të Perëndimit, i kanë vetëm të ardhurat për fëmijë më të mëdha sesa do ta kishin rrogën në vendin e tyre: pra, sikur në secilin treg, ashtu dhe në tregun e punës vlen parimi i ofertës dhe kërkesës. Punëtoret, sikurse dhe malli, shkojnë aty ku vlejnë më shumë. Blerësit, apo punëdhënësit, marrin mallin apo punëtoret që mund t'i paguajnë më pak. Dhe komisionari nga Irlanda, kur përballet me argumentin se në Kroaci, pothuajse në mënyrë hysterike po konsiderohet largimi i të rinjve si një tragjedi, rikujton fatin e Irlandës para shumë vitesh dhe uron që e njëjta të ndodhë me Kroacinë.

Para disa dhjetëra vitesh me miliona njerëz nga Irlanda largoheshin për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e edhe për vendet e tjera. Ata iknin nga varfëria dhe madje edhe të uritur. Thuhet se 10 herë më shumë irlandezë jetojnë jashtë Irlandës sesa në Irlandë. Por sot Irlanda është një prej shteteve më të pasura të Bashkimit Evropian. Sot mijëra njerëz nga shtetet e tjera vijin për të gjetur të ardhmen e tyre në Irlandë. Ky shtet tradicional dhe ky popull historikisht fetar, sot, ka për kryeministër Leon Varatkar, një politikan me prejardhje indiane dhe që publikisht deklarohet si homoseksual.

Populli dhe shteti i Irlandës ka evoluar aq shumë në secilin aspekt. Dhe kjo shihet qartë, sepse ky shtet është bërë magneti që tërheq më së shumti jo vetëm punëtoret e huaj, por edhe kompanitë e mëdha botërore. Korrupsioni pothuajse është fenomen i panjohur në këtë shtet.

Rasti i Kroacisë dhe Irlandës përdoret si një shembull se si mund të rikthehet kahja e migrimit. Ikur nga Kroacia më parë me miliona njerëz ishin larguar nga Bullgaria dhe Rumania, e para tyre nga Polonia e Lituania. Kjo së pari kishte ndikim të madh në shtetet nga ata largoheshin. Por kishte edhe anën tjetër të medaljes. Uljen e madhe të nivelit të papunësisë. Kroacia para se të hynte në BE kishte nivelin e papunësisë 17%, ndërsa sot e ka vetëm 7 për qind. Largimi i të rinjve ishte një prej elementeve kryesore të uljes kaq të shpejtë të papunësisë. Por, duke pasur parasysh se Kroacia doli nga recesioni, edhe rritja ekonomike ndihmoi që të krijohen vendet e reja të punës. Kombinimi i punësimit të kroatëve jashtë vendit dhe krijimi i vendeve të reja të punës bëri që sot papunësia në Kroaci të jetë jo vetëm më e vogël se në Greqi e Spanjë, por më e vogël edhe se në Itali dhe Francë.

Por ky fenomen krijoi probleme të mëdha sociale, sidomos për disa zona të Kroacisë. Në rajonin e Sllavonisë apo Likës, fshatrat janë pothuajse të boshatisur. Një shtëpi në këto zona thuhet se mund të blihet për vlerën e një automobili të dorës së dytë. Investimet që po bëhen në këto pjesë nuk e kanë ndalur atë që edhe në Kroaci quhet eksodus. Prandaj, sot në Kroaci kërkojnë fuqi të freskët punëtore. Deri para disa vitesh punëtoret vinin nga Bosnjë-Hercegovina, pasi kroatët e atjeshëm kanë shtetësi kroatë. Por, pikërisht për këtë, ata tash, me pasaporta kroatë nuk shkojnë në Kroaci për të punuar për 800 euro, por shkojnë në Gjermani apo Irlandë. Ata në këtë mënyrë zgjidhin problemet e tyre jetësore, sepse nuk kanë kohë për të pritur rezultatet e politikave demografike. Dhe Kroacia, vendi nga i cili janë larguar qindra e mijëra të rinj, në kërkim të një jetë më të mirë jashtë, ku thonë se i trajtojnë më mirë, ku nuk duhet të kenë lidhje politike për të gjetur punë, është bërë vend pothuajse i ëndrrave për shumë kosovarë, të cilët para

Ambasadës kroatë presin viza pune për të shkuar në Kroaci. Ardhja e kosovarëve, krahas punëtoreve nga shtetet e tjera, do të rimëkëmbë në një mënyrë edhe ekonominë kroatë. Do të ulë efektin e largimit të të rinjve.

Gjithë kjo lëvizje është episodike, dhe lëvizje të tilla ka pasur shpesh edhe në të kaluarën. Në Poloni thuhet se në dy vjetët e fundit numri i polakëve që janë kthyer nga vendet e tjera e ka tejkaluar numrin e atyre që janë larguar. Pra, po vërehen shenjat e para të rikthimit të kahës. Ata që kthehen vinë me një kapital, me shumë njohuri të reja, me shumë përvojë dhe atëherë mund edhe të investojnë dhe të jetojnë mirë edhe në vendin e tyre. Por rasti i Kosovës ka një problem tjetër. Kosova është aq larg integritet në BE, sa që nuk mund të llogarisë se do të mundë të përfitojë nga anëtarësimi për të përmirësuar situatën ekonomike në atë masë sa që të bëhet destinacion i preferuar jo vetëm për kthimin e shtetasve të saj nga diaspora, por edhe për ardhjen e të huajve.

Nuk duhet gjykuar ata të cilët largohen nga atdheu i tyre në kërkim të një vendi pune, apo të një vendi më të mirë pune. Ky është një problem serioz për vendet nga të cilat ata largohen, por në anën tjetër ata persona zgjidhin, së paku përkohësisht, një çështje të rëndësishme personale dhe familjare. Në afat të gjatë, në rast se nuk kthehet kahja dhe njerëzit kthehen nga diaspora, apo vinë edhe të huajt për të punuar, shteti humb vitalitetin e fuqisë punëtore e me këtë edhe vë në rrezik sistemin pensional. Nëse do të marrë shembull nga Kroacia, Kosova nuk do të duhej të përsëriste gabimet që ka bërë Kroacia. Korrupsioni, politizimi i shërbimeve publike, shndërrimi i qytetarëve në makineri votuese për disa parti të caktuara politike, stërmushja e sistemit pensional me veteranë të luftës, shumë edhe të rrejshëm, e kanë bërë Kroacinë të ketë ekonominë afër kolapsit. Dhe vetëm tash, nën presionin e BE-së, po bëhen reforma të dhimbshme sikur ato të rritjes së moshës në 67 vjet për shkuarje në pension. Sipas ekspertëve, edhe Kosova po shkon drejt një krize fiskale në të ardhmen për shkak të rritjeve të rrogave në shërbimet publike, rritjen e të punësuarve në administratë. Në këtë mënyrë, nuk mbeten shumë

Nuk duhet gjykuar ata të cilët largohen nga atdheu i tyre në kërkim të një vendi pune, apo të një vendi më të mirë pune. Ky është një problem serioz për vendet nga të cilat ata largohen, por në anën tjetër ata persona zgjidhin, së paku përkohësisht, një çështje të rëndësishme personale dhe familjare. Në afat të gjatë, në rast se nuk kthehet kahja dhe njerëzit kthehen nga diaspora, apo vinë edhe të huajt për të punuar, shteti humb vitalitetin e fuqisë punëtore e me këtë edhe vë në rrezik sistemin pensional



vatra për investime publike në krijimin e vendeve të reja të punës. E kur është fjala për nivelin e papunësisë, edhe kur papunësia zvogëlohet, efekt pozitiv në ekonomi ka vetëm nëse në të njëjtën kohë rritet numri i të punësuarve. Largimi i të rinjve nga një shtet, prandaj është një fenomen shumëdimensional dhe nuk duhet shikuar vetëm nga një këndvështrim. Por një shtet serioz kurrë nuk mund ta konsiderojë strategji të duhur luftimin e papunësisë përmes punësimit të qytetarëve të saj në shtetet e tjera...

(koha.net)

Koha, e mërkurë, 24 prill 2019




• Pamje nga fshati Çifti



• Kisha Arbëreshe në Kozencë



• Antonio dhe Rina Belushi



• Flamujt para Bibliotekës A. Belushi

UDHËPËRSHKRIM

NGA SHKUPI, HARE NË ZEMRAT ARBËRESHE!

Në ndarje, përqafimi vëllazëror tradhtojnë sytë e arbëreshëve që pikojnë lot dhe mall për fatin e trishtë të zogjve të shqipes, që u davaritën gjithandej nëpër botë. Ne me vete morëm besën e tyre, se do ta ruajnë si sytë e ballit amanetin e të parëve për ta ruajtur arbërishten - Gjuhën e Zemrës

Nga Sevdail DEMIRI, Kozencë/Itali

Një rrugë e gjatë nëpër tokë e det duhej bërë nga Shkupi në këtë mesprill 2019, për të arritur në 'zogun e këmbës italiane', aty ku me shekuj mrekullisht po mbijeton një komunitet i gjerë shqiptarësh, i ndarë nga trangu arbëror më se pesë shekuj më parë. Kolektivi i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve - Shkup, i drejtuar nga Skender Asani, mori një udhëtim të tillë, me qëllim të njohjes nga afër me kulturën dhe traditën arbëreshe, si një nga gurët më të çmuar të kalasë sonë kombëtare.

Arbëreshët e Italisë popullojnë me shumicë rreth 50 fshatra, që jetojnë kryesisht në krahinën e Kalabrisë dhe Sicilisë, në Italinë Jugore, ndërsa caku ynë ishte Kalabria, konkretisht qyteti i Kozencës me fshatrat përreth. Në pjesën e vjetër të Kozencës, ndalemi para bustit të Skënderbeut. Pak metra më tutje, gjendet Kisha Arbëreshe, e cila daton nga shekulli i XVI. Aty e takojmë priftin Pjetër Lanca, i cili pasi e mbaron shërbesën, na përqafon të gjithëve vëllazërisht dhe me një shqipe arkaike, na rrëfen itinerarin arbëresh. "Arbërishten e kemi Gjuhë të Zemrës, kurse italishten Gjuhë të Bukës", thotë ai.

Dita e nesërme na gjen në Universitetin e Kalabrisë, në periferi të Kozencës, si e vetmja qendër publike universitare në gjithë krahinën kalabreze dy milionëshe, e cila në gjirin e saj mblidhte afër 30.000 studentë në 80 drejtime studimore. Aty na pret krahëhapur drejtuesi i degës së Albanologjisë, Francesco Altimari, i cili



vite më parë ishte edhe mysafir i Institutit shqiptar në Shkup. Me qindra projekte studimore kryesisht në fushën e studimit të arbërishtes, shpërndaheshin nëpër programe studimore, nëpër libra, fjalorë, enciklopedi e konferenca shkencore të kësaj dege, që nga viti 1975. Ai na njofton se në gjithë Italinë funksionojnë gjithsej gjashtë katedra albanologjike, dhe në vazhdimësi është duke u punuar që të mblidhet i gjithë fondi i trashëgimisë kulturore arbëreshe, që të konkurrohet për të qenë e mbrojtur nga UNESCO. Njoftohemi nga afër me procesin e digjitalizimit të leksikut të pasur arbëresh, një projekt shumë domethënës i cili po zhvillohej duke ndjekur standardet më të larta të hulumtimit shkencor. Bashkë e vizitojmë Bibliotekën e Shkencave Humane të Universitetit të Kalabrisë, ku fascinohe mi nga fondet shumë të pasura me botimet shqipe. Tani kjo bibliotekë u pasurua edhe me afër 100 libra e revista të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve - Shkup, të cilat ua dorëzoi drejtori Asani, duke e prezantuar edhe punën dhe veprimtarinë e Institutit tonë në Shkup.

"Benvenuti a S.Cosmo Albanese - Mirë se erdhët në Strigar", qëndrojnë dy tabela të mëdha para hyrjes në fshatin e lindjes së poetit të njohur arbëresh Zef Serembe (1843-1901). Busti i tij sot qëndron para godinës së Bashkisë

së Strigarit, ndërsa rrugët kryesore të fshatit janë të dekoruara me plaka ku spikasin vargjet e tij me mbishkrimin "Rrugëtimi serembian". Një takim spontan me banorët dhe autoritetet komunale, ndërsa nënkryetari i bashkisë, Arkangjel Minishi, na shoqëron rretherrtull duke na i treguar të gjitha veçoritë etnografike të fshatit. Afër kishës ndodhet edhe Pallati i De Radës, një ndërtesë e madhe muzeale ku gjenden të ekspozuara fotografi, ikona, mjete të punës, biblioteka, makina e shkrimit, madje edhe shtrati i poetit të madh, ikonës së Rilindjes Kombëtare. Jeronim De Rada, ky poet e veprimtar i madh, u bë edhe pionier i gazetarisë shqiptare, duke e botuar gazetën e parë të njohur në historinë e shtypit shqiptar "L'Albanese d'Italia - Shqiptari i Italisë" (1848).

Befasia e radhës na pret në Bashkinë e Qanës (Cerzeto), përkatësisht në katundin Shën Japëk. Kryebashkiaku Xhuzeppe Rico, përfaqëson në mënyrën më brilante komunitetin arbëresh. Ai thotë se arbëreshët janë mjaft të bashkuar, por shumë pak ndihet dora e shtetit në këto anë, të cilat gjithnjë e më shumë po shpopullohen. Të rinjtë ikin për punë dhe jetë më të mirë nëpër qendrat e mëdha, ku ndjesia për identitetin arbëror dita-ditës zvetënohet. Rico na prezanton muzeun e ri etnografik të fshatit, i cili së shpejti pritet të hapet për publikun. Aty ndërkohë





• Kolektivi i ITSHKSH para bustit të Skënderbeut në Kozenca

vjen mësuesi Karmine Stamile, i cili e kishte mbledhur gjithë trashëgiminë e pasur të fshatit dhe e kishte grumbulluar në atë muze plot me vegla të vjetra të punës, veshje arbëreshe, fotografi, libra. Muzeu do të quhej Pallati Fazio, meqë po ngrihej në shtëpinë e dikurshme të mjekut të fshatit Oreste Fazio, me kontributin e Bashkisë Qanë. Përmbi fshat ndodhej Kisha katolike e ritit latin, ku kish te shërbyer Anton Santori, në nderim të të cilit, emrin e tij e mbante sheshi përkaj kishës. Mësues Stamile, nuk na lëshon pa na ftuar në shtëpinë e tij për provuar ca pije dhe gatime tradicionale arbëreshe. Atmosfera do të kulmojë nën tingujt fascinues të çiftelisë së studiuesit të folklorit Izaim Murtezani, dhe këngës "Xhamadani vija-vija", të cilën do ta përcillnim të gjithë bashkë si në kor.

Të nesërmen zbarkojmë në katin Frasnitë. Me ndihmën e kolegut Mustafa Ibrahim, i cili disa herë i kishte vizituar këto zona, shkojmë drejt e te dera e një arbëreshi të dëgjuar anekënd trojeve shqiptare. Antonio Belushi, që tani kishte shkelur në vitin e 85-të të jetës, është prift arbëresh, gazetar, shkrimtar, pedagog, etnolog dhe veprimtar i dalluar i kauzës arbëreshe. Së pari nxjerr në ballkon flamujt kombëtar, na fton në sallën e bibliotekës së tij, e aktivizon magnetofonin me këngë arbëreshe në sfond, dhe me një shqipe shumë të kuptueshme fillon të na rrëfejë historinë e degdisjes së arbërve në këto troje nga trevat jugore, që në

kohën e Skënderbeut. Belushi është autor i dhjetëra librave që rrëfejnë për historinë dhe trashëgiminë kulturore arvanitase dhe arbëreshe, ndërsa që nga viti 1980 botues i revistës "Lidhja". Thesari i tij më i madh është Biblioteka që bartë emrin e tij, ku gjenden mbi 10.000 tituj librash, gazetash e koleksionesh nga të gjitha trevat arbërore-shqiptare. Pranoi me kënaqësi ftesën e drejtorit Asani, që së shpejti ta kemi edhe në Shkup, në ndonjë aktivitet shkencor të Institutit. Na 'qerasë' me libra dhe revista, dhe bashkë me motrën Rina na uron rrugë të mbarë me këngën arbëreshe "Shtrëngoni dorën o vëllezër".

Lëshohemi rrugës me gurë të gdhendur të Frasnitës për të shkuar te autobusi që na priste, dhe meqë disa nga ne u vonam duke parë stilin e veçantë të arkitekturës frasnite, kur afrohem te autobusi dëgjojmë ushtrim, këngë me çifteli nga një shtëpi arbëreshe! Izaimi me Besnikun, Isametin, Riniun, Blerimin, Isamedinin, Izerin, ia kishin krisë këngës "O malet e Arbërisë...". Spontanisht kishin hasur mu para derës së një admiruesi dhe kultivuesi të kulturës arbëreshe, Mikel Greko, kryetar i Shoqatës Kulturore Folklorike "Vëllezërit Arbëreshë". "Kam hare... Zemrat tona u bënë një...", thotë Mikeli plot mall për emocionet e papitura që i dhuruan mysafirët nga Shkupi. Në rolin e publikut 'ahengut' iu bashkëngjitëm edhe ne që zëri fort nuk na shkonte, por që nuk përtornim për të duartrokatur, unë, Sken-

deri, Seferi, Avziu, Halili, Mustafa, Miniri, Murtezani, Agroni, Elhami, Nexhati, ciceroni Avdirahimi.

Disa kilometra nga Frasnita e frashëllinjeve, ngjitemi në njërin nga fshatrat më të bukur jo vetëm se të Kalabrisë, por edhe mbarë Italisë. Çifti apo Cerzeto në italishte, shtrihej midis shkëmbinjve të thepisur, të cilat në fundin e tyre krijojnë kanjone me bukuri përalllore. Në sheshin kryesor na pret busti i Skënderbeut, dhuratë nga qeveria shqiptare (2008), dhe lëshohemi kah Bashkia, përballë të cilës gjendet "Museo Etnico Arbëresh", një muze lokal shumë i pasur me veshje, mjete të punës, fotografi të ndryshme. Aty e kishte selinë edhe revista kulturore me emër tipik shqiptar "Katundi Ynë", e themeluar që në vitin 1970. Disa nga arbëreshët që takuam aty thanë se çdo ditë kanë vizitorë nga të gjitha trevat e Italisë, ndërsa shqiptarët janë më të rrallë, prandaj edhe ky takim ishte më i veçantë. Atëherë kur nuk arrimim të kuptoheshim mirë me fjalë, Besnik Rameti u kërkon të këndojnë arbërisht, dhe të gjithë bashkë ia thonë "Moj e bukura More...".

Në ndarje, përqaftimi vëllazëror tradhetojnë sytë e arbëreshëve që pikojnë lot dhe mall për fatin e trishtë të zogjve të shqipes, që u davaritën gjithandej nëpër botë. Ne me vete morëm besën e tyre, se do ta ruajnë si sytë e ballit amanetin e të parëve për ta ruajtur arbërishten - Gjuhën e Zembrës.

"Hare, hare...", na përshëndetën arbërisht!

Gjatë rrugës në drejtim të Barrit, e më pas Durrësit dhe Shkupit, ndalemi në një qytet të vjetër sa vetë historia e njerëzimit. Matera, një vendbanim turistik, gërmadhë në gropë të gurit, nën mbrojtjen e UNESCO-s, vërshohej nga qindra vizitorë nga të gjitha këndet e botës! Por ama, në asnjë kënd të saj nuk gjejmë dot ngrohtësinë e Shpirtit të Arbrit, që e gjetëm në Kozencë, Strigar, Qanë, Frasnitë, Çifti... Kujtimet tona do të jetojnë gjatë matanë Adriatikut!



• Revista LIDHJA e A. Belushit



• Tabelat në hyrje të fshatit Strigar



• Udhë dhe Pallati i De Radës



• Para Bashkisë Strigar, busti i Serembes

KOSOVË, PUSHTETARËT SHPENZOJNË 9 MILION PËR DREKA

Në vitin 2018-të, shpenzimet për dreka zyrtare kapën vlerën e 3.4 milionë euro, me një rritje gjysmë milionë më shumë se një vit më parë. Për tri vjet në Kosovë nga buxheti i shtetit u harxhuan rreth 9.1 milionë euro për këtë qëllim. Ngritja e çmimeve të konsumit dhe rritja e numri të zyrtarëve duket se dhanë efektin e vet

Në bazë të infrastrukturës ligjore që e rregullon çështjen e shpenzimeve të reprezentacionit dhe drekat zyrtare, zyrtarët që e gëzuan këtë të drejtë, shpenzuan miliona euro para publike.

Sipas të dhënave të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2018 të Republikës së Kosovës, nga buxheti i vendit janë shpenzuar 3 milionë e 409 mijë euro për dreka zyrtare.

Në 2018-ën, evidentohet vlera më e lartë e shpenzimeve në tri vitet e fundit.

Në tri vitet e fundit, shpenzimet për drekat zyrtare shënuan një trend rritës. Në vitin 2016-të shpenzimet ishin 2 milionë e 824 mijë euro për të pasuar më pas në vitin 2017-të 2 milionë e 901 mijë



euro me një rritje prej 2.7 për qind apo shprehur në vlera prej 77 mijë euro më shumë.

Në anën tjetër shpenzimet për dreka zyrtare në vitin që shkoi vërehet se kishte një rritje të theksueshme.

Për dallim nga viti 2016 e 2017, në vitin 2018, ato u rritën në 3 milionë e 409 mijë euro. Shprehur në përqindje paraqet një rritje prej 17.5 për qind më shumë në raport me një vit më parë.

Në 2018-tën ato ishin për 508 mijë euro më shumë se një vit më parë.

Bazuar në të dhënat e publikuara, zyrtarët e shtetit shpenzojnë mesatarisht mbi 3 milionë euro për dreka e darka zyrtare.

Një ndër kontribuuesit e rritjes së këtyre shpenzimeve, mund të jenë rritja e çmimeve të

konsumit.

Ku si pas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ka shënuar rritje të vazhdueshme për tri vitet fundit.

Kontribuues tjetër mund të konsiderohet rritja e numrit të ministrive, së bashku me rritjen e numrit të zëvendës ministrave dhe zyrtarëve të tjerë të cilët gazojnë të drejtën për dreka zyrtare me para publike.

Në vitin 2016-të kur vendi udhëhoq nga ish-kryeministri Isa Mustafa, shpenzimet për dreka zyrtare kishin vlerën e 2.8 milionë euro në krahasim me vitin 2018 kur Kosova udhëhoq nga kryeministri Ramush Haradinaj, shpenzimet për këtë qëllim kapin vlerën e 3.4 milionë euro.

Shpenzimet e qeverisjes Ha-

radinaj janë më të larta për gjysmë milionë euro më shumë se në raport me vitin 2016-të ku timonier i Qeverisë ishte Isa Mustafa.

Në anën tjetër, Në vitin 2017-të, Gazeta Jeta në Kosovë kishte bërë një hulumtim se sa i kushton rritja e numrit të Ministrive dhe Zëvendës ministrave buxhetit të vendit.

Numrin e madh të zëvendës ministrave e kishte konsideruar sfidë edhe për Ministrinë e Administratë Publike ministri i këtij digasteri Mahir Yagcilar.

Lidhur me shpenzimet për drekat zyrtare edhe nëpër komunitat e Kosovës, KALLXO.com tash e sa kohë është duke i publikuar fatura e shpenzimeve dhe luksin e zyrtarëve edhe nëpër komunitat e Kosovës.



Lideri opozitar serb thotë se duhet pajtim me Kosovën

Politikani opozitar serb, Dragan Gjilas, ka thënë se duhet pajtim me Kosovën, por që sipas tij, askush nuk po punon për këtë.

Politikani opozitar serb, Dragan Gjilas, njëherësh kryetar i partisë "Aleanca për Serbinë", ka thënë se pajtimi me Kosovën është e vetmja rrugë, por askush nuk po punon për të.

Sipas tij, kanë kaluar 20 vjet nga bombardimet dhe asgjë nuk ka ndryshuar në të mirë të qytetarëve.

"Kanë kaluar 20 vjet që nga bombardimet dhe njerëzit jetojnë më keq dhe më keq. Pajtimi i dy kombeve do të thotë që ju mund të udhëtoni lirshëm, se ekonomia është e lirë punojmë dhe bashkëpunojmë në fusha të ndryshme, që policia të nënshkruajë një dokument në mënyrë që kriminelët të mos mund të fshihen, bashkëpunojnë prokurorët, për të zgjidhur problemin e pronës", ka thënë Gjilas për "N1".

Ai po ashtu ka folur edhe për anëtarësimin e Kosovës në OKB, por që partia e tij nuk e mbështet këtë pasi që sipas tij, nuk ka bazë për të.

Tutje, Gjilas në këtë intervistë ka thënë se Kosova po përdoret si mjet politik.

"Kosova është pjesë integrale e Serbisë dhe është e pavarur për shqiptarët, Kosova i takon serbëve dhe shqiptarëve, të gjithë e përdorin Kosovën si një mjet për politikën e brendshme, kur flasin për jetën e keqe të qytetarëve që po largohen nga Kosova. Për mua, Kosova është pjesë përbërëse e Serbisë, nuk është një përkuftizim pajtues i statusit. Ditën kur qytetarët e Serbisë dhe Kosovës kanë paga të larta, që ata mund të mendojnë se ku do të shkojnë në det me fëmijët, atëherë ne do të zgjidhim problemin", ka theksuar Gjilas.

RRITEN KOSTOT E JETESËS NË TIRANË, NDËR MË TË SHTRËNJTAT NË RAJON

Kostot e jetesës në kryeqytet janë rritur në 2019-n në raport me vendet e tjera të rajonit. Jetesa në Tiranë tashmë është po aq e shtrenjtë sa në Beograd dhe pak më e lirë në raport me Podgoricën. Të dhënat janë marrë nga portali Expatistan.com, i cili krahason kostot e jetesës midis qyteteve të ndryshme për individët që lëvizin për arsye punësimi në shtete të tjera. Për të përcaktuar kostot e jetesës, portali i ka kategorizuar në 5 grupe: ushqim, strehim, veshje, transport, kujdes personal dhe argëtim.

Për vitin 2019, Podgorica mbetet qyteti më i shtrenjtë i rajonit. Në krahasim me Beogradin dhe Tiranën, kryeqyteti i Malit të Zi është vetëm 2% më i shtrenjtë. Atje kushton më shtrenjtë ushqimi,

strehimi dhe transporti.

Ndryshe nga viti 2018, Tirana është po aq e shtrenjtë sa Beogradi, ku më shtrenjtë kushtojnë po ashtu ushqimi, strehimi dhe transporti.

Për vitin 2019, Shqipëria është më e shtrenjtë se Sarajeva, në të cilën një vit më parë jetesa për të huajt që zhvendosin atje ishte më e shtrenjtë se Tirana. Diferenca në kostot e jetesës në krahasim me Tiranën është më e theksuar në Shkup dhe në Prishtinë. Shkupi është rreth 11% më i lirë se Tirana. Sipas portalit, atje kushton më shtrenjtë transporti (rreth 3% më shtrenjtë) dhe argëtimi rreth 28% më shtrenjtë.

Prishtina vijon të mbetet vendi më i lirë i Ballkanit Perëndimor. Të gjitha kategoritë janë më të lira se



në Tiranë. Në total kostot e jetesës atje 30% më të lira.

Veshjet dhe kujdesi personal janë më të shtrenjtë në Tiranë në krahasim me kryeqytetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Në krahasim me Beogradin dhe Shkupin, në Tiranë veshjet kushtojnë përkatësisht 2 dhe 3% më shtrenjtë. Në krahasim me Podgoricën, ato janë 7% më të shtrenjtë,

ndërsa me Sarajevën rreth 9%. Prishtina mbetet kryeqyteti më i lirë për sa i përket veshjeve. Në raport me Tiranën, diferenca është e madhe, pasi të vishesh atje kushton rreth 75% më lirë. Edhe për kujdesin personal, ku bëjnë pjesë tarifet e vizitave te doktori, çmimet e ilaçeve dhe çmimet e produkteve personale, Tirana është më e shtrenjtë. (Monitor.al)

TAKIMI KIM-PUTIN, TË ENJTEN NË VLADIVOSTOK

Lideri i Koresë së Veriut, Kim Jong-un, do ta vizitojë së shpejti Rusinë për një samit me presidentin, Vladimir Putin, kanë raportuar të martën mediat shtetërore koreanoveriore, teksa një gazetë ruse ka shkruar se takimi mes dyshes do të ndodh të enjten në Vladivostok.

Vizita e Kimit është pjesë e përpjekjeve të liderit koreanoverior për të siguruar mbështetje të jashtme për planet e tij të zhvillimit ekonomik, pas dështimit të samitit të dytë SHBA-Kore e Veriut, gjatë shkurtit të këtij viti në Vietnam, si pasojë e mos pajtimeve rreth heqjes së sanksioneve ndaj Fenianit, ka raportuar "Reuters", transmeton "Koha Ditore".

Agjencia shtetërore koreanoveriore (KCNA) ka raportuar të martën se vizita do të ndodhë së shpejti, por nuk ka përcaktuar



ndonjë afat kohor apo lokacion. Gazeta ruse "Kommersant" ka shkruar se vizita është përcaktuar për 25 prill në Vladivostok, duke cituar dy burime të afërta me procesin e përgatitjes së vizitës.

Kremlini nuk ka dhënë ndonjë koment zyrtar lidhur me raportin, por zëdhënësi i saj, Dmitry Peskov, u ka thënë gazetarëve të hënën se Putin dhe Kim janë duke u përgatitur për një takim gjatë fundit të

prillit.

Ndërkaq, agjencia koreanojugo e lajmeve "Yonhap" ka raportuar se ndihmësi kryesor i Kimit, Kim Chang Son, është parë në Vladivostok të dielën.



IRA e Re merr përgjegjësinë për vrasjen e gazetares Lyra McKee

Grupi i ashtuquajtur IRA e Re e pranoi përgjegjësinë për vrasjen e gazetares Lyra McKee në Irlandën e Veriut. Përmes një deklarate, grupi tha se kërkon "falje të sinqertë" për familjen dhe miqtë e saj.

McKee, 29 vjeçe, u qëllua në kokë të enjten e kaluar, derisa mbulononte disa trazira në qytetin Londonderi, transmeton "REL".

Grupi i disidentëve republikanë IRA e Re besohet të jetë formuar midis viteve 2011-2012.

Ai e kundërshton marrëveshjen e nënshkruar në të Premten e Madhe të vitit 1998, me të cilën grupi IRA, apo Ushtria Republikane Irlandeze, ka pranuar një zgjidhje politike, pas dhunës disavjeçare në Irlandën e Veriut. IRA ka luftuar për fundin e sundimit britanik në Irlandën e Veriut dhe ribashkimin e Irlandës.

Marrëveshja e së Premtes së Madhe ka qenë rezultat i negociatave intensive që kanë përfshirë qeveritë e Mbretërisë së Bashkuar dhe të Irlandës së Veriut. IRA e Re thuhet se lidhet me katër vrasje.

Pothuajse 10% e të gjithë pronës së BE-së është në pronësi të kinezëve

Sipas raportit të Komisionit Evropian, një e treta e totalit të aktiveve të Bashkimit Evropian janë në duart e kompanive të huaja dhe 9.5% e kompanive evropiane kanë pronarët me bazë në Kinë, Hong Kong apo Macau.

Krahasuar me vitin 2007, kur norma ishte vetëm 2.5 për qind, kjo është një rritje të konsiderueshme, edhe pse i përgjithshëm në duart kineze është ende një pjesë relativisht e vogël e biznesit evropian, tha një raport i BBC, shkruan albinfo.ch.

Investimet kineze në Evropë arritën kulmin në vitin 2016, kur vle-

ra e përgjithshme ishte 37.2 miliardë euro. Pas kësaj, pati një ndalesë.

"Kjo është kryesisht rezultat i kontrolleve më të rrepta të kapitalit që vijnë nga Kina, por edhe ndryshimet në klimën globale politike kur bëhet fjalë për investimet kineze", tha Agatha Krac i grupit "Rhodium" për BBC.

Nga viti 2000 deri në vitin 2018, kinezët kryesisht investuan në ekonomitë më të mëdha evropiane, si Britania, Gjermania, Italia dhe Franca. Lista e 10-të përfshin Holandën, Finlandën, Suedinë, Portugalinë, Spanjën dhe Ir-



landën.

Sipas analizës së vitit të kaluar të Bloomberg, kinezët kanë prona

ose kanë një pjesë të tyre në katër aeroporte evropiane, gjashtë porte dhe 13 klube futbolli.

Davutoglu kritikon partinë e Erdoganit për humbjen e zgjedhjeve lokale

Ish-kryeministër dhe aleat i ngushtë i presidentit Recep Taip Erdogan, Ahmet Davutoglu, kritikoi ashpër Partinë në pushtet AK, të hënën, duke fajësuar ndryshimet e politikave dhe një aleancë me nacionalistët, për ecurinë e saj të dobët në zgjedhjet lokale të Turqisë muajin e kaluar.

Në sfidën e tij të parë të madhe publike ndaj Erdogan, që kur u largua nga zyra tre vjet më

parë, Ahmet Davutoglu, një anëtar i AKP, përplas politikën ekonomike të partisë, kufizimet e medias dhe dëmet që ai tha se i kishte bërë ndarjes së pushteteve dhe institucioneve të Turqisë.

Davutoglu, një figurë e profilit të lartë në parti, ka shërbyer si kryeministër midis 2014 dhe 2016, përpara se të shkarkohet nga Erdogan, i cili ka drejtuar Turqinë me AKP-në e tij për 16 vjet.

Në një goditje serioze ndaj Er-

doganit, AKP humbi kontrollin e kryeqytetit, Ankarasë dhe qytetit më të madh të Turqisë, Stambollit, në zgjedhjet e 31 marsit. AKP dhe paraardhësi i saj islamikë kishin qeverisur të dy qytetet për 25 vjet. "Rezultatet e zgjedhjeve tregojnë se politika e aleancës ka shkaktuar dëm për partinë tonë, si në aspektin e niveleve të votuesve, ashtu edhe identitetit të partisë", tha Davutoglu në një deklaratë prej 15 faqesh. AKP dhe




Partia e Lëvizjes Kombëtare (MHP) formuan një aleancë para zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare në qershor të vitit

të kaluar, në të cilën Erdogan fitoi presidencën ekzekutive, por pa nivelin e mbështetjes për rënien e partisë së tij.

SHPËRNGULJA E SHQIPTARËVE PËR NË TURQI NË DOKUMENTET DIPLOMATIKE JUGOSLLAVE (2)

KUR SHQIPTARËVE QË SHPËRNGULESHIN U MERREJ SHTETËSIA!



Nga Qerim LITA

Të mërkurën e kaluar publikuam dokumentin me titull "Referat i përgjithshëm për shpërnguljen e popullsisë myslimane nga Serbia Jugore", hartuar më 6 prill 1939, nga komiteti ndërministror pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Qeverisë jugosllave, i cili qe themeluar menjëherë pasi në Stamboll qe parafuar Konventa jugosllav-turke, për shpërnguljen e 40.000 familjeve shqiptare-muslimane, nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Sanxhaku për në Turqi. Është me rëndësi të theksohet se autoritetet e atëherëshme hegjemoniste serbomadhe, me qëllim të dëbimit sa më parë të shqiptarëve nga trojet e tyre etnike dhe kolonizimin e tyre me elemente sllave (serbe e malazeze), më 21 gusht të vitit 1934, bënë ndryshimin dhe plotësimin e nenit 55 të Ligjit për shtetësi jugosllave, të miratuar gjatë vitit 1928, përmbajtja e të cilit ishte si më poshtë:

"Janë bërë shtetas të Mbretërisë ata ish shtetas të Turqisë, të cilët më 25 gusht 1913 kanë qenë banor të ndonjë komune të territorit që iu bashkua ish Mbretërisë së Serbisë, si dhe ata, të cilët më 8 nëntor 1913 kanë qenë banorë të cilësdo komunë në territorin e aneksuar nga ish Mbretëria e Malit të Zi, dhe të cilët kanë ngelë si të tillë deri më 1 dhjetor të vitit 1918. Personave të cilët janë shpërngulur në Bullgari, nëse kthehen në vend në një afat prej tre viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, me vendim të Ministrisë për Punë të Brendshme, do t'u pranohet shtetësia e tyre. Popullsia jo sllave, e cila në kuptimin paragrafit të dytë të këtij neni është bërë shtetase e Mbretërisë, u ndërpritet kjo e drejtë, nëse në afat prej pesë viteve nga hyrja në fuqi të këtij Ligji deklarohen para pushtetit ekzekutiv të shkallës së parë se tërhiqen nga shtetësia.

Pushteti ekzekutiv i shkallës së parë deklarata e përmendura më lartë do ua dërgoj pushtetarëve ushtarak e komunal, të cilët kanë për obligim të njëjtit menjëherë të shlyejnë nga listat ushtarake e komunale. Këta persona do të jenë të obliguar të shpërngulen nga Mbretëria në afat prej një viti, nga dita e dhënies së deklaratës, gjatë së cilës do të mund të bartin me vete të gjitha të mirat e tyre të tundshme. Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë për Punë të Brendshme këtyre të shpërngulurve do t'u përcaktoj procedura lehtësuese për shpërngulje dhe për shitjen e pronës së tyre."

Me ndërhyrjen dhe plotësimin të fundit, bëhet ndryshimi dhe plotësimi i tekstit të paragrafit tre të nenit 55, ku thuhet shprehimisht: "Jo sllavët, të cilët në kuptimin e paragrafit të dytë të këtij neni, janë bërë shtetas të Mbretërisë ndërpritin të jenë të tillë nëse pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji e deri me 1 nëntor të vitit 1938 para organeve kompetente të pushtetit të shkallës së parë, ose në cilëndo për-

Më 15 prill të vitit 1935, Ministria e Punëve të Jashtme jugosllave, përmes një letre, urdhëronte konsullin e përgjithshëm në Stamboll, që të bëj një hulumtim të hollësishëm rreth planeve "kolonizuese turke" për arsye se, siç thuhej në letër, "këtyre ditëve do të organizohet një konferencë ndërministrorë" në të cilën do të trajtohet problemi i shpërnguljes së popullsisë shqiptare për Turqi. Për rrjedhojë, konsulli i përgjithshëm jugosllav, më 2 maj 1935, përmes një Analize, njoftonte Beogradin, për mundësitë "reale", rreth arritjes së një marrëveshje me autoritetet turke për shpërnguljen e popullsisë shqiptare myslimane për në Turqi

faqësi tonën diplomatike apo konsullare në botën e jashtme, deklarojnë se tërhiqen nga shtetësia. Deklaratat të cilat u janë dorëzuar pushtetit të përmendur sikurse edhe përfaqësive diplomatike e konsullorë nga ana e personave në fjalë pas 1 nëntorit të vitit 1938, e deri në hyrje në fuqi të këtij Ligji, do të konsiderohen si të dërguara me kohë". Ndërkohë, më 15 prill të vitit 1935, Ministria e Punëve të Jashtme jugosllave, përmes një letre, urdhëronte konsullin e përgjithshëm në Stamboll, që të bëj një hulumtim të hollësishëm rreth planeve "kolonizuese turke" për arsye se, siç thuhej në letër, "këtyre ditëve do të organizohet një konferencë ndërministrorë" në të cilën do të trajtohet problemi i shpërnguljes së popullsisë shqiptare për Turqi. Për rrjedhojë, konsulli i përgjithshëm jugosllav, më 2 maj 1935, përmes një Analize, njoftonte Beogradin, për mundësitë "reale", rreth arritjes së një marrëveshje me autoritetet turke për shpërnguljen e popullsisë shqiptare myslimane për në Turqi. Dy dokumentet në fjalë, të cilët në vazhdim po i japim të plotë, gjenden në Arkivin e Jugosllavisë në Beograd, fondet 370 dhe 411, përkatësisht, Legata Jugosllave në Ankara dhe Konsulli i Përgjithshëm Jugosllav në Stamboll.

Dok. 1.

**"Ministria për Punë të Jashtme
Proc. Nr. 9445 Beograd, 15 prill 1935
LËNDA: Shpërngulja e popullsisë jo-sllave
nga Serbia Jugore për në Turqi
KONSULLIT TË PËRGJITHSHËM MBRETË-
ROR, Stamboll**

Ministria nga ai Konsull i Përgjithshëm ka pranuar më shumë raporte për kolonizimin që Qeveria turke është duke e kryer në brendi, e në mënyrë speciale në Thraki. Ato raporte duke i vlerësuar si interesante dhe të dobishme Konsulli i Përgjithshëm lutet që këtë çështje edhe në të ardhmen ta përcjell me vëmendje dhe Ministrinë ta njoftoj për rrjedhën e tij.

Sikurse është e njohur për Konsullin e Përgjithshëm, te një pjesë e caktuar të popullsisë jo-sllave nga Serbia Jugore (Kosova, Maqedonia, Sanxhaku dhe Mali i Zi, asaj kohe autoritetet serbomadhe i emërtonin si treva jugore serbe, përkatësisht Serbi Jugore - Q.L.) ekziston tendenca të shfrytëzohet me dispo-


zitat e nenit 55 të Ligjit tonë për shtetësi për shkak shpërnguljes nga vendi ynë. Aspirata të një pjesë e popullsisë së Serbisë Jugore edhe atë sikurse te turqit poashtu edhe te shqiptarët.

Shpërngulja e turqve kryhet pa pengesa: ata po shpërngulen në Turqi. Ndërkohë, shpërngulja e shqiptarëve po has në vështirësi, pasi ata në radhë të parë duan të shpërngulen për në Shqipëri. Në anën tjetër këtë shpërngulje po e vështirëson Qeveria shqiptare, për arsye se konsujt shqiptarë këtu te ne refuzojnë të japin viza dhe me këtë e pamundësojnë shpërnguljen për Shqipëri. Këtë çështje ata pjesërisht e bëjnë për shkaqe financiare e pjesërisht për shkaqe politike e nacionale.

Për këtë arsye shqiptarët nga Serbia e Jugut, në pamundësi të shpërngulen në Shqipëri, bëjnë përpjekje të shpërngulen në Turqi. Ata shumë lehtë marrin viza ka konsulli turk, për arsye se Turqia një emigracion të tillë është duke e favorizuar. Me t'u pajisur me viza turke ata për në Turqi kryesisht shkojnë përmes Selanikut me atë se, ose atje ngelin përgjithmonë, ose nga atje më pas kalojnë në Shqipëri.

Në kohë të fundit është vërejt se ekziston një numër i caktuar i personave të cilët para qeveritarëve tanë kanë dhënë deklaratë të paraparë me nenin 55 e të cilët nuk janë shpërngulur. Disa nga ata pohojnë se nuk mund të shpërngulen për arsye se nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet e rrugës.

Kjo Ministri ka ndërmarrë hapa të duhura deri te Ministria për Punë të Brendshme që të grumbulloj të dhëna të sakta për numrin e personave të këtyre, sikurse edhe detaje tjera për ta. Nuk është në interesin tonë që këta njerëz të pengohen nga dëshira e tyre për t'u shpërngulur, e nëse arsyeja e vetme për mos shpërnguljen e tyre është mungesa e shpenzimeve rrugore, atëherë atyre duhet t'u mundësohet shkuarja në cilëndo mënyrë qoftë. Ndoshta do të ishte e përshtatshme të grumbulloheshin dhe me shpenzimet e shtetit tonë të përcillen deri në kufirin shtetëror turk, qoftë përmes rrugës tokësore qoftë përmes Selanikut, detit. Këtyre ditëve në këtë Ministri do të mbledhet një konferencë ndërministrorë e cila tërë këtë çështje do ta merr në shqyrtim. Lutet ai Konsull i Përgjithshëm, nëse ajo është në suazat e kompetencave të



veta, ta lexoj e sa më parë ta dërgoj raportin si dhe sugjerimet e veta eventuale për këtë Ministri.

Në mënyrë të veçantë kërkohet mendimi i asaj konsullate për çështjet si vijojnë:

a/ përmes cilës rrugë duhet të kryhet transporti publik: rrugës tokësore ose përmes detit;

b/ cilat dhe çfarë hapash duhet të ndërmerren te Konsullata turke;

c/ të shpërngulurit çfarë nga sendet e tyre do të mund të merrnin me vete.

Përveç kësaj lutet Konsulli i Përgjithshëm për çfarëdolloj sugjerimi të dobishëm eventual në pikëpamjen e zbatimit të këtij aksioni".

Dok. 2

**"Konsulli i Përgjithshëm Mbretëror
Proc. Nr. 115 Stamboll, 3 maj 1935
Ministrisë për Punë të jashtme
Dhomës Politike
Në përgjigje të letrës së Ministrisë Proc.
Nr. 9445 nga data 15 prill k.v. Konsullata e**

Përgjithshme Mbretërore ka nderin të Ju dërgoj si vijon.

Çështja e shpërnguljes së popullsisë jo-sllave, nga territori i Serbisë Jugore, pa dyshim se përbën, një ndër çështjet më të mëdha politike-nacionale. Qëndron fakti, se elementi shqiptar-mysliman i vendosur përgjatë tërë kufirit tonë shtetëror nga Liqeni i Shkodrës e deri te Liqeni i Ohrit, më pak apo më shumë përbën një masë kompakte. Kufiri shqiptar-jugosllav nga Bojana në det e deri te Liqeni i Prespës ka një gjatësi prej 477 kilometra. Ky element përgjatë kufirit shtetëror përbën rrezikun e përhershëm, aq më tepër se mbështetet në shtetin shqiptar, i cili me vet faktin e ekzistimit është përcaktuar të jetë kundërshtar ynë megjithëse nga oportuniteti politik në momente të caktuara mund të jetë në marrëdhënie jashtëzakonisht të mira me ne. Ky problem meriton kujdesin më të madh dhe për zgjidhjen e tij nevojitet të bëhen përpjekje të mëdha dhe të shpenzohen mjete të shumta materiale. Për zgjidhjen e tij ka më shumë metoda, realizimi i së cilës lidhet për vite të tëra. Më të rëndësishmet janë kolonizimi dhe ripopullimi. Kolonizimi ka dhënë rezultate të mira edhe deri më tash dhe të njëjtën duhet vazhduar, duke pas kujdes të veçantë që elementi nacional të dërgohet sa më afër kufirit. Ndoshta do të ishte në një jopërrputshmëri të tepruar mirëpo konsideroj se duhet bërë edhe ndonjë përpjekje përmes kishës. Në të vërtetë kisha ortodokse nuk ka ide misionare dhe prandaj kjo përpjekje do të shkonte me vështirësi. Është e njohur çështja se në Gjermani krijohet feja gjermane, ndërsa në Bashkimin Sovjetik feja përndjekjet, si në njërin shtet po ashtu edhe në tjetrin ka më shumë interesa nacionale e sociale.

Shpërngulja përbën masën më radikale, veçmas shpërngulja në Turqi. Shpërngulja në Shqipëri do ta rriste popullsinë e shtetit shqiptar dhe përforcimin e lëvizjes irredentiste, i cili atje vetëm se ekziston e të cilin e nxitë pushteti shtetëror shqiptar dhe propaganda e huaj. Ai element shqiptar i cili shpërngulet në Turqi për kombin shqiptar llogaritet si element i humbur përfundimisht. Për këto arsye plani për shpërngulje në Turqi përbën zgjidhje më me fat të këtij problemi.

Qeveria e Turqisë i ka dhënë detyrë vetvetes që elementin e huaj nga territori i saj ta largoj dhe ta zëvendësoj me elementin turk përkatësisht mysliman nga vendet ballkanike. Qeveria turke konsideron se me marrëveshjet për paqe pas luftërave ballkanike e botërore janë shndërruar në krijimin e kufijve të pastra etnografik me çka mbeturinën e elementit jomysliman duhet detyrimisht larguar dhe përmes asaj rruge të bëhet një vend tërësisht homogjen. Pas luftës së suksesshme me Greqinë, i tërë elementi grek nga territori turk përveç Stambollit, është i përndjekur. Përveç grekëve ka krahina si Thrakia ku përmes përndjekjeve dhe formave tjera më të ndryshme janë detyruar të shpërngulen 15.000 bulgarë. Meqenëse se Thrakia është ekspozuar dhe e cila në aspektin strategjik përbën një krahinë shumë me rëndësi për republikën turke, prandaj qeveria turke bënë përpjekje që këtë krahinë ta nacionalizoj dhe populloj. Sot, në Thraki nëse mund të ketë disa qindra grek me 600 bulgarë në Llozengrad dhe Edrene dhe numër të parëndësishëm të hebrenjve. Qeveria turke favorizon popullzimin e elementit mysliman nga vendet ballkanike. Dy viteve të fundit numri më i madh i të ardhurve ka qenë nga Rumania pastaj nga Bullgaria, ndërsa më i vogli nga vendi ynë. Qeveria turke në buxhetin e këtij viti ka paraparë shumë prej 1 milion lirave për vendosjen e ardhacakëve në Thraki. Përveç arsyeve nacionale-ushtarake të përmendura më lartë qeveria turke përpiqet që ta rris numrin e popullsisë së vet, sepse konsideron, se me rritjen e numrit të popullsisë rritet edhe autoriteti i saj ndërkombëtar.

Kur ekziston një disponim i tillë të qeveria turke, atëherë kjo tash përbën momentin e volitshëm që përmes rrugës së negociatave të ngritet kjo çështje. Qeveria turke do ta pranonte me kënaqësi propozimin tonë në këtë drejtim, aq më tepër, nëse kjo shpërngulje të shkohej përmes një plani të caktuar dhe me ndihmën tonë materiale. Çështjen do të duhej ta ngrenim sa më parë, që mos të ngelim prapa rumunëve dhe bullgarëve, të cilët gjithashtu janë të interesuar për këtë çështje. Sipas mendimit të Konsullatës së Përgjithshme çdo mysliman në Serbinë Jugore i cili dëshiron ta lëshoj territorin tonë dhe të shpërngulet në Turqi duhet t'i lejohet ta shesë pasurinë e tij të tundshme e të patundshme.

Njëkohësisht duhet lejuar që me vete t'i bart edhe parat e fituara. Gjithashtu duhet vazhduar afati i nenit 55 të Ligjit për shtetësi edhe për pesë vjet. Rruga më e rëndësishme për shpërngulje do të ishte rruga detare Selanik - Stamboll. Kjo rrugë për person kushton 300 dinar të cilën shumë do ta paguante shteti ynë. Me shumën prej 1 milion dinarësh do të shpërnguleshin mbi 3.000 vetë. Përveç kësaj shpërnguljen mund ta realizonim edhe përmes transportit hekurudhor Selanik-Dedeagaç-Edrene. Kjo rrugë do të ishte diç më e shtrenjtë, sepse kjo rrugë është hekurudhë klasike orientale nga e cila është vështirë të reduktohet.

Konsulli i Përgjithshëm"

(vijon të mërkurën e ardhshme)

REPORTAZH I BBC-SË: NË SHQIPËRINË E TOLERANCËS FETARE

ATY KU EZANIN E THËRRET NJË I KRISHTERË

Shqipëria vijon të tërheqë vëmendjen e botës për bashkëjetesën e saj fetare. Dhe është BBC ajo që i ka kushtuar një reportazh këtij fenomeni, i konsideruar si një pasuri e gjallë e shqiptarëve që ia ka ënda çdo vendi, sidomos atyre me konflikte sektare. Një korrespondent i medias prestigjioze britanike është ndalur në Berat, ku ka takuar një muezin, ish-të krishterë të konvertuar, nëpërmjet edhe figurës të cilit, ka ndërtuar tablonë e një vendi të paqte fetarisht, si një garanci edhe për paqe sociale....

Nga Quinn HARGITAI

Edhe pse kjo ishte hera e parë që po takoja Hasib Buba-n, kisha dëgjuar zërin e tij tashmë disa herë duke bërë jehonë nëpër rrugët me kthesa dhe rrugicat e Beratit, një qytet i vogël në pjesën jug-qendrore të Shqipërisë. Me flokët e mbyllta, të ndara me kujdes, një mjekër mirë të mbajtur, udhëheqësi fetar 25-vjeçar shpjegoi se si një nga detyrat e tij si muezin është të thërrasë ezanin për faljen e namazit, gjë që ndodh pesë herë në ditë.

Ai është fotografia e vërtetë e një muslimani të devotshëm; por unë mbeta i befaspur kur mësova se kjo nuk ka qenë gjithmonë kështu. "Në fakt unë jam rritur si i krishterë," shpjegon Buba, "dhe për vite me rradhë kam ndjekur këtë rrugë. Më vonë në moshë të pjekur, pata një debat me një nga miqtë e mi, i cili ishte musliman. Debatu vazhdoi për muaj, dhe në mënyrë që të jem sa më i përgatitur për diskutimet tona, unë fillova të lexoja për Islamin, përpiva gjithçka që pata mundësi në lidhje me këtë fe. Në fund, edhe pse mu duk se debatin e fitova unë, i gjithë procesi më shtyri të bëj pyetje në lidhje me bindjet e mia. Përgjigjet e dhëna nga Islami kishin më shumë kuptim për mua, kështu që unë u



konvertova në musliman", thotë ai.

Edhe pse zgjedhja për t'u konvertuar mund të duket e habitshme për shumëkënd, realiteti është se Shqipëria prej kohësh konsiderohet si një vend i tolerancës dhe harmonisë fetare. Fetë dominuese në Shqipëri janë Islami dhe Krishterimi, ku muslimanët përbëjnë më shumë se gjysmën e popullsisë. Megjithatë, mbetet një unitet i përbashkët në mes të banorëve të vendit. Kishat dhe xhamitë shpesh zënë të njëjtën rrugë, dhe martesat ndërfetare janë pranuar gjerësisht në kulturën e vendit. Veçanërisht vlen të shquhet Berati, në të cilin gjendet Muzeu Onufri që mban ikonën e burimit të jetës. Kjo vepër artistike shqiptare e shekullit të 18-të përshkruan një skenë të krishterë me minare në sfond dhe është lavdëruar si një simbol i harmonisë fetare të famshme të vendit. Gjatë një vizite në vitin 2014, Papa Françesku, kreu i kishës katolike, vlerësoi vendin ballkanik për tolerancën e saj të dukshme fetare, duke thënë se kjo tolerancë duhet të shërbejë si një shembull për gjithë botën. Gjatë fjalës së tij në Tiranë, Papa Françesku vlerësoi "bashkëjetesën paqësore" të feve në vend, duke shtuar se "kjo është veçanërisht e rëndësishme në këto kohëra kur fryma autentike fetare është duke u shtrembëruar nga grupe ekstremiste".

Kurioz të di se si ka arritur popullsia e Shqipërisë të mbesë e bashkuar, e pyeta Buba-n për mendimin e tij mbi këtë temë. "Shqipëria ka pasur gjithmonë traditë të pranimit të të tjerëve. Nëse shikoni nëpër historinë e vendit, ju do t'a shihni harmoninë në çdo shekull. Edhe gjatë Perandorisë Osmane. Shumë njerëz ia atribuojnë atë komunizmit, por unë nuk e besoj". Buba është duke iu referuar periudhës në mes të viteve 1944 dhe 1992, kur Shqipëria ishte nën një regjim të rreptë komunist të udhëhequr nga diktatori Enver Hoxha. Gjatë regjimit, Shqipëria u bë shteti tërësisht i izoluar praktikisht me asnjë lidhje me botën e jashtme.

Në vitin 1967, Hoxha forcoi kontrollin e tij mbi vendin edhe më tej duke ndaluar të gjitha fetë, duke

deklaruar Shqipërinë si shteti i parë ateist në botë. Gjatë kësaj kohe, kishat dhe xhamitë u konfiskuan nga ushtria dhe u shkatërruan apo u kthyen në kinema e salla për vallëzim. Klerikët ishin zhveshur nga titujt e tyre, ishin turpëruar dhe në disa raste madje ishin burgosur. Disa spekulojnë se ky përjashtim i dhunshëm i fesë së organizuar ka rezultuar me adaptimin e mendimit laik ndër shqiptarët, dhe se vendi është i njohur për mungesë të çfarëdo tensioni ndërfetar, sepse besimi nuk është një element i rëndësishëm i jetës për shumë njerëz sot. Dhe Buba lutet që kjo të ndryshojë. Për të ilustruar se si harmonia fetare ekziston në Shqipëri, ai solli shembullin e fundit të Malbardhit, një fshat i vogël në veri të Shqipërisë. Disa vjet më parë, zona e vogël bëri bujë në të gjithë vendin, kur popullsia lokale muslimane kishte mbledhur fonde dhe kishte rindërtuar kishën e vetme katolike të fshatit, e cila ishte shkatërruar bashkë me shumë kisha tjera gjatë sundimit të Hoxhës.

Këto tregime janë veçanërisht me rëndësi në kohën e sotme. Me frikën nga rritja e mundshme e grupeve ekstremiste, duket se vija e dallimeve në mes të besimeve ka shkuar duke u shtyrë edhe më thellë. "Kam dëgjuar gjitha këto biseda të disa personave që dëshirojnë të ndërtojnë mure dhe të ndalojnë besimtarët e besimeve të caktuara nga hyrja në vendet e tyre", tha Buba.

"Kjo vetëm se do të ngjallë urrejtje dhe keqkuptim. Arsyeja pse ekziston harmonia në Shqipëri është për shkak se ne angazhohemi njëri me njërin. Ne debatojmë, diskutojmë dhe edukojmë veten në lidhje me ata që na rrethojnë".

Është e vështirë të thuhet nëse bota do të marrë shembullin e Buba-s dhe të Shqipërisë për zemër, por ka diçka për të thënë për shtetin e vogël ballkanik në të cilën fëmijët rriten duke dëgjuar edhe thirrjen për namaz edhe kambanat e kishave prej jashtë dritareve të tyre. Për ta, bashkëjetesa dhe harmonia janë bërë aq të natyrshme sa ajri që thithin.

(KultPlus.com)



"PRANVERE E PAHARRUAR NË FSHATIN E HARRUAR", PREMIERË NDËRKOMBËTARE NË MOSKË

Në Moskë nga data 18-15 prill po mbahet edicioni i 41 i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit, kurse me pjesëmarrje jashtë konkurrencës u paraqit edhe filmi "Pranvere e paharruar në fshatin e harruar" i regjisorit Kushtrim Bekteshi. Ky i fundit, në një prononcim për ga-

zetën KOHA, tregoi disa detaje rreth këtij festivali dhe pjesëmarrjes në të.

"Filmi ynë "Pranvere e paharruar në fshatin e harruar" është selektuar në programin zyrtar të festivalit, jashtë konkurrence. Filmi ynë në këtë festival pati pre-

mierën ndërkombëtare me datën 21 prill, ndërsa më 24 prill jepet përsëri.

Portali "Festival Film" e ka rekomanduar për publikun edhe filmin tonë në përzgjedhjen e 15 filmave që nuk duhet lëshuar pa i parë në këtë edicion të festivalit, e

besoj kjo ka ndikuar që interesimi për ta parë filmin ishte shumë i madh. Premierën ndërkombëtare të filmit tonë (më 21 prill) e prezantoi para publikut dhe gazetarëve, selektorja e festivalit Eugeniya Tirdarova, ndërsa pas premierës u diskutua për filmin.

Pati interesim nga gazetarët dhe publiku, të cilët bënë disa pyetje rreth filmit", u shpreh regjisorin Kushtrim Bekteshi.

Filmi është shfaqur i titruar në anglisht dhe rusisht. Festivali Ndërkombëtar i Filmit më Moskë është i kategorisë A.

EKSPOZITË RETROSPEKTIVE E KOSTADIN TANÇEV DINKA NË HAMAMIN E DAUT PASHËS

Galeria Nationale ka lëshuar një komunikatë për mediat me të cilën njofton se më datë 24 prill 2019 (e mërkurë), me fillim në ora 20:30, në hapësirat e Hamamit të Daut Pashës do të hapet një ekspozitë retrospektive e Kostadin Tançev – Dinka. Ekspozitën do ta hapin d-r Drita Starova Qerimi, Drejtore e Galerisë Nationale, m-r Robert Allagjovovski, Koordinator Kombëtar për Zhvillimin e Kulturës dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Vladimir Borojeviç, artist figurativ dhe disenjator.

Profesori Kostadin Tançev Dinka gjatë karrierës së tij shumëdekadëshe të frutshme dhe krijuese, ka lënë gjurmë të rëndësishme në zhvillimin e skenës artistike të Maqedonisë, si autor i artit figurativ, ashtu dhe si disenjator i artit figurativ. Në fushën e grafikës kontemporare, shumica e konsiderojnë si mjeshtër prijës inovator në programet mësimore të disenjimit, skenografi dalluar, krijues kulmor i pllakateve dhe disenjator i publikimeve.

Duke u nisur nga roli i rëndësishëm të cilin Kostadin Tançev Dinka ka luajtur në skenën bashkëkohore të artit figurativ të Maqedonisë dhe rëndësia e tij në kontekstin e afirmimit të tendencave të reja të artit figurativ në artin figurativ bashkëkohor të Maqedonisë,



nisë, para së gjithash, në fushën e disenjimit të artit figurativ dhe artit kontemporar, ekspozita retrospektive ka për qëllim të bëjë prerjen e krijimtarisë së tij të artit figurativ dhe kështu të aktualizojë dukuri dhe tendenca të caktuara me interpretime historike, problematike, tematike, stilistike, por edhe aktuale të artit figurativ bashkëkohor botëror dhe të Maqedonisë. Në ekspozitë do të prezantohen diku 90 vepra (grafika, pllakate, fotografi, logo) nga të gjitha fazat e krijimtarisë së autorit. Kustosë të ekspozitës janë Maja Nedellkoska Bërzanova, Maja Çankullovska Mihajlloska dhe Goranço Gjorgjievski.

Kostadin Tançev ka lindur në vitin 1940 në Vallandovë. Shkollën

e artit kontemporar ka mbaruar në Shkup në vitin 1961. Që nga viti 1961 studion në Akademinë e Artit Kontemporar në Beograd, e pas përfundimit të shkollës së parë, me rekomandimin e Këshillit Universitar të Universitetit të Beogradit, gjatë viteve 1963-1964 kishte qëndruar për specializim në Londër. Gjatë studimeve të shkollës së dytë, kishte qenë në klasën e profesorëve: Miha Petrov, Bogdan Kërshiq dhe Millosh Çiriç. Si student i vitit të pestë kishte marrë pjesë në konkursin ndërkombëtar të komunikimit vizual, të organizuar nga Organizata Ndërkombëtare e Disenjatorëve Grafikë IKOGRADA. Në mesin e shumë pjesëmarrësve nga shumë vende kishte hyrë në përzgjedhjen më të ngushtë, pra

në mesin e dhjetë më të mirëve. Që si student kishte qenë anëtar i Shoqërisë së ULUPUs dhe IKOGRADA. Në përbërjen e punimit të diplomës, ai realizoi filmin e parë të animuar të Akademisë së Artit Kontemporar në Beograd.

Gjatë viteve 1969-1970 ai punon në sektorin e propagandës ekonomike (marketingut) në NIP "Nova Makedonija". Në periudhën e viteve 1973-1975 kishte qëndruar në Paris, ku kishte ekspozuar në disa galeri. Në vitin 1975 kishte ekspozuar në ekspozitën "50 pikturistët e rinj premtues" në Sallonin e Majit "Defans" në Paris. Pas kthimit nga Parisi, në vitin 1975, ai vazhdon të punojë si udhëheqës i Sektorit të Disenjimit Grafik dhe Enteritit në Qendrën Kulturo-

Informative në Shkup. Gjatë viteve 1978-1981, ai kishte marrë pjesë aktive në hulumtimet shkencore dhe realizimin e formave të reja të komunikimit kulturor dhe krijimtarisë, që ishin zbatuar në kuadrin e Laboratorit Estetik të Fakultetit Filozofik pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi".

Nga viti 1985 ishte zgjedhur si arsimtar i Fakultetit të Arteve Figurative në Shkup, në katedrën grafike për lëndët e vizatimit dhe grafikës me teknika grafike. Në të njëjtën kohë, ai ishte angazhuar në mësimdhënien e pjesës së orientuar të studimeve, në drejtimin e disenjimit grafik dhe me mentorimin e tij, me sukses po zhvillohet procesi arsimor-educativ për pajisjen e librit dhe ilustrimit, fotografisë, komunikimeve vizuale, pllakateve dhe standardeve grafike. Me studentët e vitit të tretë dhe të katërt, në drejtimin e disenjimit grafik, ai kishte marrë pjesë në konkurse të shumta republikane për komunikime vizuale, në të cilat janë marrë çmime të shumta. Ai merr pjesë në realizimin e veprimtarisë botuese të Fakultetit, sidomos në botimin e Hartës Grafike të profesorëve të FAF në vitin 1987, publikimin me rastin e jubileut dhjetëvjeçar të FAF, të hartës studentore të vitit 1986 dhe katalogeve dhe zgjidhjeve konceptuale të shumta, për nevojat e Fakultetit.

“Kemi punuar aq sa kishim kohë për ndeshjen ndaj Akadameija Pandevit, por shpresoj se do të arrijmë që me lojë të organizuar të vazhdojmë me rezultat pozitiv dhe të mbajmë hapin për pozitën e katërt, për të cilën shpresojmë që në fund të arrijmë edhe daljen në Ligën e Evropës”, theksoi Ergin Abdul

Koha

Fisnik NUHIU

Shkup, 23 prill - Pas takimeve të zhvilluara të shtunën në Ligën e Parë futbolistike të Maqedonisë së Veriut, të mërkurën në program do të jenë përballjet e xhiros së 30. Ndashje derbi e javës do të luhet në Çair, ku ekipi vendas FC Shkupi do të jetë nikoqire e finalistit të sivjetshëm në Kupën e Maqedonisë, Akademija Pandev. Skuadra e Shkupit pas fitores në terren mysafir ndaj Pobodës të shtunën të mërkurën do të kërkon fitoren e radhës ku do të ruante pozitën e katërt në tabelë që në rast se Akademija Pandev fiton Kupën, atëherë pozita e katërt do ti siguronte daljen në Evropë. “Pas dy fitoreve që kemi shënuar, ekipi ka treguar formë të mirë dhe atmosfera në klub është shumë pozitive. Kemi punuar aq sa kishim kohë për ndeshjen ndaj Akadameija Pandevit, por shpresoj se do të arrijmë që me

LIGA E PARË - JAVA E 30

SHKUPI KËRKON FITOREN NDAJ AKADEMIJA PANDEVIT



lojë të organizuar të vazhdojmë me rezultat pozitiv dhe të mbajmë hapin për pozitën e katërt, për të cilën shpresojmë që në fund të arrijmë edhe daljen në Ligën e Evropës”, theksoi Ergin Abdul. Skuadra e Shkupit ndaj Akademija Pandevit ka vetëm një mungesë, pasi shkaku i pesë kartonëve të verdhë Amir Bilali nuk ka të drejtë loje. Nga ana tjetër lideri i tabelës do të udhëtoj drejt Strumicës, ku do të jetë mysafiri e Bellasicës të cilët në 29 xhirot e zhvilluara kanë tubuar vetëm 27 pikë, dhe rrezikojnë rënien nga Liga e Parë. Kuqezinjët, në këtë përballje

do të hyn si favorit dhe kërkojnë që të marrin tri pikët e reja qo do ti ofronte edhe më afër titullit të tret në Ligë. “Fundi i kampionatit gjithmonë është sfidues për shkak se dëshira e ekipeve për realizimin e ambicieve i bën ndeshjet interesante, pavarësisht nëse përballë njëra tjetrës janë skuadra me pozita krejtësisht të ndryshme. Ilustrim i kësaj është përballja ndërmjet Bellasicës dhe Shkëndijës, vendasit kërkojnë pikë për mbijetesë, ndërsa ne për titullin e kampionit. Do të jetë takim interesant dhe i vështirë për ne, por besoj se me maksimu-

min e të gjithëve do të dalim fitues nga kjo përballje”, shprehet për gazetën Koha portieri i Shkëndijës së Tetovës, Bekim Rexhepi. Ndryshe skuadra e Renovës pas tri humbje rresht të mërkurën në stadiumin e qytetit në Tetovë, do të ketë mundësi që ti rikthehet fitoreve, ku për kundërshtarë do të ketë skuadrën e Sileksit. Skuadra e Rabotniçkit do të luaj ndaj Pobodës të cilët nga viti i ardhshëm pritet të jenë pjesë e Ligës së Dytë, ndërsa Makedonija CJP do të pret Vardarit. Të gjitha takimet zhvillohen të mërkurën me fillim prej ora 16:00.



Këshillat e Altin Lalës për Milot Rashicën


Legjenda e futbollit shqiptar, Altin Lala i ka dhënë këshilla Milot Rashicës për zhvillimin e karrierës së tij. Ish-futbollisti i Hannoverit beson se futbollisti kosovar mund të bëhet lojtar i madh. Altin Lala beson se Milot Rashica mund të bëhet lojtar i madh në të ardhmen. Werder Bremeni do të luajë me Bayern Munichun të mërkurën në ndeshjen gjysmëfinale të Kupës së Gjermanisë (DFB Cup), ndërsa krejt shpresat e ekipit gjelbër e bardhë janë tek futbollisti kosovar. Djaloshi i artë i Kosovës në pjesën e dytë të sezonit në Bundesliga ka realizuar 7 gola, ndërsa kishte realizuar edhe në ndeshje të kupës. 22 vjeçari është këtu ku është edhe falë Altin Lalës, i cili e ka ndihmuar shumë. Tash ish-futbollisti i Hannoverit mendon se Rashica po ecën me hapa gjigantë përpara. “Fakti se një klub si Werder Bremen me një trajner si Florian Kohfeldt ka vendosur për Milotin, i cili ka shumë durim dhe besim, është mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e këtij djaloshi”, ka thënë për mediat gjer menaxheri Altin Lala. Ndërsa, trajneri i Werderit është i kënaqur me kontributin e lojtarit, i cili tash po e ndihmon ekipin në të gjitha aspektet. “Fillimisht, Miloti nuk e dinte se duhej të vepronte dhe të kontribuonte më shumë në mbrojtje”, ka thënë trajneri gjerman. Ndërkohë, Lala shton se Miloti ka nevojë të përmirësohet në disa detaje të vogla, por se po shkon me hapa të sigurt drejt të qenit një lojtar i madh. “Unë shpesh i kam thënë Milotin se ai mund ta bëjë një gjë të vogël, të thjeshtë pak më mirë. Janë gjëra që nuk kanë të bëjnë asgjë me talentin, por me punën”, ka përfunduar ish-përfaqësuesi i Kombëtares shqiptare.

Rënia e madhe e kampionit të botës

Në një ditë kur Manchester Unitedi është rrahur keq, 4:0, dhe kur Liverpooli ka fituar për t'u kthyer në vendin e parë në Premier League, futbollisti shqiptar Shkodran Mustafi ia ka dalë të jetë prej më të përfolurve në futbollin anglez. Mbrojtësi i qendrës, Mustafi, të dielën bëri gabim të rëndë, ndërsa Arsenalit pësoi 3:2 në shtëpi nga Crystal Palace. Dhe nëse për bazë merren shkrimet e tifozëve nëpër rrjetet sociale e po ashtu qëndri-

met e analistëve, atëherë periudha e Mustafit tek Arsenalit mund t'i jetë afruar fundit. Mustafi reagoi keq në tentim për të bllokuar Wilfried Zahan, me synim që portieri i Arsenalit të arrinte i pari te topi. Por Zaha shmangu lehtë mbrojtësin shqiptar dhe shënoi gol për Crystal Palace. Ai moment mund të jetë vendimtar për karrierën e Mustafit tek Arsenalit. Ka kohë që ai nuk është i pëlqyer te tifozët e klubit londinez, por të dielën mbrë-

ma dhe të hënën komentet ndaj tij ishin shumë negative dhe me plot fyerje nga më të ndryshmet. Sipas "express.co.uk", Mustafi ishte fajtor në të tre golat e pësuar nga Arsenalit, veçanërisht në të dytin. Sipas këtij mediumi, Arsenalit do të dëgjojë ofertat për mbrojtësin e qendrës kur të hapet afati kalimtar në fund të edicionit aktual. Ish-ylli i Arsenalit, Martin Keown, ka kritikuar paraqitjen e Mustafit në ndeshjen e së dielës.




FFK-ja organizon turne përkujtimor për Fadil Vokrrin

Dje u mbajt mbledhja e Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit të Kosovës, ku u vendos që të rregullohet varri i ish-presidentit të Federatës, Fadil Vokrrin, si dhe të mbahet një turne përkujtimor për nder të tij. Turneu për nder të Fadil Vokrrit do të fillojë më 23 korrik, në datëlindjen e tij, dhe aty të marrin pjesë veteranët e klubeve ku ka luajtur vetë Vokrrin gjatë karrierës së tij, Llapin, Prishtinën, Partizanin e Fenerbahçes. “Meqenëse po afrohet njëvjetori i vdekjes së legjendës së futbollit dhe ish-presidentit Fadil Vokrrin, KE mori vendim dhe themeloi Komisionin për rregullimin e varrit. Kështu që,

Komisioni i përbërë nga Agim Di-brani, kryetar, Arianit Ahmeti, Ilaz Mjaku e Mirsad Çollaku anëtarë do të përkujdesen për mbarëvajtjen e punimeve të varrit të ish-presidentit”, shkruhet në njoftimin e lëshuar nga FFK-ja. “Po ashtu, KE në datëlindjen e legjendës Fadil Vokrrin më 23 korrik do të organizojë një turne përkujtimor në kategorinë e veteranëve të kohës dhe brezit të Fadil Vokrrit, e ku do të marrin pjesë veteranët e klubeve, në të cilat ka luajtur legjenda, Llapin, Prishtinën, Partizanin dhe Fenerbahçen”. Për këtë turne dhe mbarëvajtjen e tij, Komiteti Ekzekutiv i FFK-së e themeloi Ko-

misionin në përbërje Bakir Burin, kryetar, Jusuf Tortoshi e Luan Salihi, anëtarë. Vokrrin e filloi karrierën e tij si futbollist me Llapin, mirëpo debutimin si futbollist profesionist e bëri me Prishtinën në vitin 1980. Karriera e tij 15-vjeçare e dërgoi atë në Partizan, Nimes, Fenerbahçe, Bourges 18. Në fund të karrierës së tij, në vitin 1995, ai u pensionua në klubin Montlucon. Pas karrierës së tij mbresëlënëse si futbollist, Vokrrin e mori përgjegjësinë e pozitës së presidentit të Federatës së Futbollit të Kosovës më 16 shkurt 2008, dhe këtë pozitë e mbajti deri në vdekjen e tij. Vokrrin e shtroi rrugën



për suksesin e treguar në Ligën e Kombeve, ku Kosova u promovua nga Liga D në Ligën C dhe e siguroi një vend në play-offs për kualifiki-

me në Kampionatin Evropian. Falë punës së tij në FFK, Kosova u anëtarësua në UEFA dhe në FIFA në maj të vitit 2016.

TETË GARUES PËRFAQËSOJNË KOSOVËN NË LOJËRAT EVROPIANE

Ka shkuar në tetë numri i sportistëve që do të përfaqësojnë Kosovën në Lojërat e dyta Evropiane Minsk 2019, që mbahen prej 21-30 qershor në kryeqytetin e Bjellorusisë

Ka shkuar në tetë numri i sportistëve që do të përfaqësojnë Kosovën në Lojërat e dyta Evropiane Minsk 2019, që mbahen prej 21-30 qershor në kryeqytetin e Bjellorusisë. Organizatori i LE Minsk 2019 i ka konfirmuar Komitetit Olimpik të Kosovës pjesëmarrjen e pesë xhuditëve, Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Akil Gjakova dhe Loriana Kuka, të cilët janë kualifikuar me normë. Distria është bartësja e dytë në kategorinë deri 48 kilogramë, Majlinda është e katërta (-52 kg), Nora e para (-57 kg), Akili i katërta (-73 kg), ndërsa Loriana e teta (-78 kg). Trajneri i



xhudos, Driton Kuka, beson se edhe nga Minsku do të kthehen me medalje. "Normalisht, gjasat janë për medalje dhe besoj që do të kthehem me medalje, sa e qysh mbetet të shihet. Në xhudo, Lojërat Evropiane janë edhe Kampionat Evropian, domethënë do të jetë shumë garë e fortë", ka dek-

laruar Kuka për faqen zyrtare të KOK-ut. Pikërisht në xhudo, Kosova numëron një medalje të bronzit të fituar nga xhuditja Nora Gjakova, në debutimin e ekipit kosovar në Baku 2015. Para xhuditëve, por me ftesë, KOK-ut i është konfirmuar edhe pjesëmarrja e boksieres, Donjeta Sa-

dikut, karateistit, Alvin Karaqi dhe pingpongistit, Fatih Karabaxhaku. Afati i dërgimit të konfirmimeve nuk është mbyllur ende dhe në ditët në vijim ka gjasat të vije në KOK edhe konfirmimi për ndonjë sportist të sporteve tjera, sipas njoftimit nga Komiteti Olimpik.




Bucks eliminojnë Pistons

Milwaukee u bashkohet skuadra të tjera të NBA që kanë siguruar kualifikimin në raundit çerekfinal të play-off-it. Skuadra më e mirë e sezonit të rregullt e çoi në 4-0 rezultatin e serisë ndaj Detroit Pistons e tashmë e presin të paktën 4 përballje me Boston Celtics, që eliminuan po me rezultatin 4-0 Indiana Pacers. 104-127 përfundoi takimi i fundit i zhvilluar në "Little Caesars Arena" të Michiganit, ku shkëlqeu "ylli" i Bucks, Giannis Antetokounmpo, me plot 41 pikë, 3 asiste dhe 9 "rebound", ndërsa Reggie Jackson i Pistons u ndal në 26 pikë, pa mundur të bëjë më shumë për të shmangur humbjen. Antetokounmpo bëhet lojtari i parë në historinë e NBA-së që realizon mbi 40 pikë në më pak se 32 minuta në fazën play off. Nuk do të ketë duele të tjera që e mbyllin serinë me shifrat 4-0, pasi Houston Rockets e humbën sfidën e katërt ndaj Utah Jazz me rezultatin 107-91. Skuadra nga Salt Lake City triumfoi në "Smart Home Arena" duke e shtyrë festën e Rockets, pavarësisht se James Harden realizoi 30 pikë. Më i miri i kësaj përballjeje rezultoi Donovan Mitchell me 31 pikë, i ndihmuar nga Jae Crowder e Ricky Rubio respektivisht me 23 dhe 18 pikë.

Publicitet



KOMUNA E KARPOSHIT
KRYETARI I KOMUNËS



Në bazë të nenit 35 ndërsa në lidhje me nenin 51 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18), Kryetari i Komunës së Karposhit, në vijim sjellë

LAJMËRIM

Për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike për Projektin arkitektonik-urbanistik për PN 3.2 dhe PN 3.5 (PK 420/1, 420/2, 420/3, 422/24, 422/4, 422/5, 422/25, 422/28 dhe 422/20) në PDU Çereku i qytetit CS 15 - Krivi Doll, Komuna Karposh - Shkup.

Anketa publike për Projektin arkitektonik urbanistik për PN 3.2 dhe PN 3.5 (PK 420/1, 420/2, 420/3, 422/24, 422/4, 422/5, 422/25, 422/28 dhe 422/20) në PDU çereku i qytetit CS 15 Krivi Doll, Komuna Karposh - Shkup, do të mbahet nga data 02.05.2019 deri më 09.05.2019, çdo ditë pune nga ora 07:30 deri 15:30, në hapësirat e Komunës Butel (Baraka 2 - rr. Radika nr.9).

Prezantimi publik për Projektin arkitektonik urbanistik për PN 3.2 dhe PN 3.5 (PK 420/1, 420/2, 420/3, 422/24, 422/4, 422/5, 422/25, 422/28 dhe 422/20) në PDU çereku i qytetit CS 15-Krivi Doll, Komuna Karposh - Shkup, do të mbahet më datë 08.05.2019 në ora 13:00, në hapësirat e Komunës Butel (Baraka 2 - rr. Radika nr.9).

Me projektin arkitektonik-urbanistik bëhet definimi i kufijve të parcelave ndërtimore në kuadër të parcelave kadastrale (PK 420/1, 420/2, 420/3, 422/24, 422/4, 422/5, 422/25, 422/28 dhe 422/20) gjegjësisht parcelave ndërtimore PN 3.2 dhe PN 3.5, sipas situatës dhe respektimi i marrëdhënieve juridike prone - pronësi të objekteve ekzistuese, ndërsa me qëllim të realizimit të PDU dhe respektim i parametrevë të dhëna me PDU, hapësira e përfshirjes projektuese është 1422,93 m².

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike ndodhen në hapësirat e Komunës Karposh (Baraka 2-rr.Radika nr.9) dhe në sistemin E-urbanizëm.

Njoftimin për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike, shtojcën grafike për Projektin arkitektonik urbanistik për PN 3.2 dhe PN 3.5 ((PK 420/1, 420/2, 420/3, 422/24, 422/4, 422/5, 422/25, 422/28 dhe 422/20) në PDU Çereku i qytetit CS 15- Krivi Doll, Komuna Karposh, dhe informacione më të hollësishme për të njëjtat do të publikohen në UEB faqen e Komunës Karposh www.karpos.gov.mk.

Në afatin e caktuar, subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mund të parashtrojnë vërejtjet në listat anketuese në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 - rr. Radika nr. 9) dhe në formë elektronike përmes sistemit informativ E-urbanizëm, në pajtim me nenin 35 paragrafi 5 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).

KRYETARI I KOMUNËS
KARPOSH

Stefan Bogoev

Në bazë të nenit 384 nenit 385 si dhe nenit 387 të Ligjit mbi shoqatat tregtare "Fl.Zyrtare e RM" Nr.28/04 nenit 38 nenit 40 si dhe nenit 41 të Statutit të "Knauf-Radika" S.H.A.- Dibër, Kuvendi i S.H.A. shpall:

Gips dhe prefabrikatet e gipsit
Knauf-Radika sh.a. Dibër
Kuvendi i S.H.A. shpall
THIRRJE PUBLIKE

Gips dhe prefabrikatet e gipsit "Knauf-Radika" S.H.A.- Dibër, thërret të gjithë aksionarët të marrin pjesë në seancën e XXVI-të të Kuvendit të Shoqërisë aksionare, e cila do të mbahet më datë 03.06.2019 (e hëne), me fillim në ora 13:00 në lokalet e S.H.A. Rr. "8 Shtatori" p.n.

Kuvendi vendos në mënyrë meritore nëse në seancë marrin pjesë aksionarët të cilët disponojnë me së paku gjysmën e aksioneve me të drejtë vote. Për mënyrën e votimit vendos Kuvendi i Shoqërisë nëse më Ligj ose Statut nuk është paraparë ndryshe.

Secili aksionar i cili ka dëshirë të marr pjesë në seancën e Kuvendit konform nenit 391 të LSHT, është i detyruar të paralajmërojë pjesëmarrjen e tij në seancën e Kuvendit, më së voni deri para fillimit të seancës.

Secili aksionar ka të drejtë një personi të tretë t'i lëshojë një autorizim në formën me shkrim dhe të notorizuar për ta përfaqësuar në Kuvend.

Duke filluar nga dita e shpalljes të kësaj thirrje publike deri në ditën e mbajtjes të seancës, secili aksionar ka të drejtë në lokalet ku gjendet selia e Shoqërisë të njoftohet me materialet e parapara për shqyrtim dhe vendosje në seancën e këtij Kuvendi.

Për seancën e konvokuar të këtij Kuvendi, konform nenit 390 të LSHT, propozohet të shqyrtohet ky:

Rendite

Pjesa procedurale:

- Zgjedhja e Kryesuesit të seancës së Kuvendit.
- Zgjedhja e procesmbajtësit, numëruesit dhe verifikuesit të procesverbalit të seancës së Kuvendit.

Pjesa punuese:

- Shqyrtimi dhe miratimi i
 - Llogarisë përfundimtare për vitin 2018
 - Raporteve financiare për vitin 2018, dhe
 - Raporti vjetor për veprimtarinë e Shoqërisë për vitin 2018.
- Miratimi i Vendimit për shpërndarjen e fitimit për vitin 2018, dhe përcaktimin e kalendarit për pagesën e dividendes.
- Miratimi i Vendimit për aprovimin e punës të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe atij Drejtues për vitin 2018.
- Përcaktimi i revizorëve për raportet financiare të Shoqërisë për vitin 2019.

REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E LIKOVËS

Seksioni për Punë komunale, urbanizëm, ndërtimtar, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe ZHEL

Në bazë të nenit 35, paragrafi 3 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gz. zyrtare e RM-së" nr.199/14, 44/15), nenit 50, pika 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gz. zyrtare e RM-së" nr.5199/2014, 44/2015, 157/2015, 193/2015, 31/2016, 90/2017, 64/2018, 168/2018), nenit 22 të Statutit të Komunës së Likovës dhe miratimit të Programit vjetor për punimin e planeve urbanistike të Komunës së Likovës për vitin 2019 me Vendim nr. 08-1305/13 të datës 26.12.2018 nga Këshilli i Komunës së Likovës, Kryetari i Komunës së Likovës e jep këtë:

LAJMËRIM

Për organizimin e prezantimit publik dhe anketës publike për Propozimin e Kryetarit të Komunës së Likovës

Kufijtë e përfshirjes janë: **Planit urbanistik jashtë vendbanimit - PUJV për ndërtimin e G2 - industri e lehtë jondotëse, A4-vendosje e përkohshme dhe B2-Njësi të mëdha tregtare në v.q. Shamak, KK Opajë, Komuna e Likovës.**

Përfshirja është sipërfaqe prej 2,3 ha.

Anketa publike dhe prezantimi publik me propozim programin e Kryetarit të Komunës, do të zbatohet me ekspozimin e Propozim Planit në hapësirat e sallës të Këshillit të Komunës së Likovës.

Anketa Publike do të zgjatë 10 ditë pune edhe atë prej 29.04-10.05.2019, çdo ditë pune nga ora 10:00 deri 15:00.

Në afatin e përmendur, qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga rajoni konkret të përfshirë me planin mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozime dhe mendime në listat anketuese.

Prezantimi publik me prezantimin profesional të planit do të mbahet më datë 06.05.2019 në ora 10,30 në hapësirat e sallës së Këshillit të Komunës së Likovës.

Punoj, Ida Dije Arifi
Kontrolloi, Feim Selmani
Aprovoi, Nexhadi Osmani

Komuna e Likovës
Kryetar,
m-r Erkan Arifi

NEVILLE I TURPËRON YJET E MANCHESTERI QË PO E ZHGËNJEJNË SOLSKJAERIN

Gary Neville, beson se të gjithë lojtarët e përfshirë në fazën e sulmit janë duke kaluar një sezon jo edhe aq të mirë, si dhe portieri David De Gea, i cili zakonisht e shpëton skuadrën e "Djajve të kuq"



Ish-mbrojtësi i Manchester Unitedit, Gary Neville, beson se të gjithë lojtarët e përfshirë në fazën e sulmit janë duke kaluar një sezon jo edhe aq të mirë, si dhe portieri David De Gea, i cili zakonisht e shpëton skuadrën e "Djajve të kuq". Gary Neville ka thënë se Paul Pogba dhe David De Gea janë dy nga gjashtë lojtarët që janë performuar në nivelin e tyre për Manchester Unitedin gjatë kohës së fundit. Goditja e fundit për "Djajtë e kuq" ishte disfata turpëruese 4:0

në Liverpool kundër Evertonit. Manchester Unitedi është përballur me shumë kritika për paraqitjen në këtë ndeshje e ndër ta ishte edhe Neville. Ish-mbrojtësi anësor i Manchester Unitedit tani ka sugjeruar se shumë nga liderët

e skuadrës kanë lejuar që niveli i tyre i lojës të bie shumë, duke theksuar se reparti i sulmit dhe portieri duhet t'i kthehen formës së mirë. "Ka pesë sulmues në klub—Marcus Rashford, Anthony Martial, Romelu Lukaku, Alexis Sanchez dhe Paul

Pogba—i cili është afër sulmit. Këta pesë janë lojtarë yje, ata mund të bëhen më të mirët në pozitën e tyre, por të gjithë janë duke luajtur në nivelin e tyre", ka thënë Neville. "Alexis Sanchez... nuk e di çfarë i ka ndodhur atij. Marcus Rashford... këto javët e fundit ka qenë larg formës së mirë të tij. Romelu Lukaku nuk shfaqet në ndeshjet e mëdha. Kjo gjë është thënë për të tash e shumë vite". "Paul Pogba duket se është kthyer të jetë Paul Pogba që e shihnim në drejtimin e Mourinhos, edhe ka qenë jashtëzakonisht mbresëlënëse gjatë tre muajve të fundit. Dhe Martiali, ai është kthyer nga lëndimi, por duket se është përsëri në atë disponimin negativ". "De Gea nuk duket aspak si De Gea që ishte më mirë, ai duket i shpërqendruar. Ne kemi negociatë për kontrata të reja me pesë apo gjashtë lojtarë dhe kjo gjë mund t'i shpërqendrojë ata".




Viniciusi pritët të kthehet në skuadrën e Realit

Tifozët e Real Madridit nuk kanë shumë gjëra që mund t'i emocionojnë deri në fund të sezonit, mirëpo këtë gjë mund t'ua dhurojë kthimi i Vinicius Juniorit në skuadër, pas shtatë ndeshjeve të lënduar. Tani që një vend kualifikues për sezonin e ardhshëm të Ligës së Kampionëve pothuajse është siguruar, qëllimi kryesor i Zinedine Zidane është që ta analizojë të gjithë skuadrën e tij para se ta marrë vendimin për cilët lojtarë dëshiron t'i ketë në skuadër për sezonin e ardhshëm. Vinicius ka qenë njëri ndër gjërat e pakta që i kanë gëzuar tifozët e Real Madridit këtë sezon, që nuk ka qenë aspak i suksesshëm për madrilënët. Sulmuesi brazilian i ndihmoi skuadrës gjatë periudhës më të vështirë, në janar dhe në shkurt. Tashmë kanë filluar shumë spekulime për lojtarë që Real Madridi mund t'i blejë verës dhe lojtarët që mund të largohet nga klubi. Zidane është trajner që nuk i pëlqen t'i kthejë lojtarët nga lëndimet, megjithatë Vinicius është më afër se kurrë të kthehet në skuadrën e "Los Blancos". Ai pritët të luajë për disa minuta në ndeshjen e së enjtes kundër Getafes, në stadiumin Coliseum Alfonso Perez. 18-vjeçari do të kthehet në fushë për herë të parë që nga ndeshja e Ligës së Kampionëve kundër Ajaxit, më 5 mars. Vinciusi ka munguar në shtatë ndeshjet e fundit të Real Madridit, të gjitha në kuadër të La Ligës. Por, ai dëshiron t'i kthehet futbollit në mënyrë që të jetë i zgjedhur për skuadrën e Brazilit për Kupën e Amerikës këtë verë.

Zhvillimi i jashtëzakonshëm i Mbappes në Ligue 1

Ai mund të jetë vetëm 20-vjeçar, mirëpo Kylian Mbappe tashmë e ka fituar tri herë titullin e Ligue 1. Që kur debutoi për Monacën në sezonin 2015/2016, francezi e ka fituar titullin e ligës fillimisht me klubin e parë, ndërsa dy sezonet e radhës me klubin e tij të ri, Paris Saint-Germainin. Në të njëjtën kohë, numrat e tij individualë janë ngritur në shifra të frikshme dhe kjo gjë dëshmohet edhe përmes grafikës së paraqitur më poshtë. Paraqitjet e tij kanë shkuar nga 14 në 44, 46 dhe 40. Edhe numri i golave të shënuar ka pësuar rritje të ngjashme, nga 26 në 21 dhe pastaj 36. Ndërsa, sa i përket asistive, ai ka shkuar nga 14 asiste në 15 dhe këtë sezon i ka 17. Me ende pesë ndeshje të mbetura

deri në fund të këtij sezoni, këto statistika për sezonin 2018/19 mund të ngrihen edhe më shumë. Në këtë sezon, Mbappe e ka marrë rolin e një lideri të skuadrës, për shkak të lëndimeve të Neymarit dhe Edinson Cavanit. "Gjithçka që kam arritur deri më tani ka qenë e rëndësishme, por unë ende kam shumë për të bërë. Më mundon vazhdimësia dhe unë s'kam mundur të arrijë gjithçka në dy sezone", është shprehur Mbappe. Asnjë futbollist tjetër nuk mund t'i barozojë statistikat e Mbappes në Francë për këtë sezon. Nicolas Pepe i Lille është golashënuesi i dytë më i mirë i ligës dhe ai i ka plot 11 gola më pak se francezi i PSG-së. Në Evropë, vetëm Lionel Messi e mposht Mbap-



pen në garën për Këpucën e Artë, pasi që argjentinas i ka shënuar 33 në krahasim me 30-të të francezit. Si njëri prej yjeve më të rinj në majat e futbollit të botës, vlera e Mbappes është më e lartë se e cilitdo futbollist tjetër, sipas Qendrës Ndërkombëtare për Studime Sportive. Ata e vlerësojmë Mbappen me 216 milionë euro, pastaj vijojnë Harry Kane (197 milionë euro), Neymar (197 milionë euro), Mohamed Salah (173 milionë euro) dhe Lionel Messi (170 milionë euro).



Mahrez kërkon ballafaqim me Guardiolen për zëvendësimet


Riyad Mahrez është i pakënaqur te Manchester City. Fantazisti, që i kushtoi arkës së klubit pothuajse 70 milionë euro verën e kaluar, dëshiron të luajë më shumë dhe mendon se nuk e meriton të jetë zëvendësues në minutat e fundit, ashtu siç ka ndodhur në 7-8 ndeshjet e fundit. Mahrez pritët të ketë një ballafaqim me Guardiolen për të kuptuar nëse spanjollit e sheh si titullar. Nëse situata nuk ndryshon, atëherë ish-kampioni i Anglisë me Leicester City-n do të kërkojë për një aventura të re. Futbollisti algjerian në 26 ndeshje të Premier League ka mundur të shënojë 6 gola, ku në tre raste me finalizimet e tij u ka dhënë fitoren Citizens.

Mesfushori i Barcelonës ende mahnitet kur Messi i flet

Arthur Melo ka qenë i mrekullueshëm për Barcelonën këtë sezon dhe përkundër që është një lojtar i rëndësishëm në skuadrën e Ernesto Valverde, ai ende e pickon veten në shenjë mosbesimi që është në Camp Nou. Mesfushori Arthur Melo diskutoi për jetën e tij të re në Camp Nou. Ai e theksoi dukjen e jashtme të Gerard Pi-

ques, si dhe i përmendi edhe disa bashkëlojtarë të tjerë të tij në Barcelonë. "Pique është shumë i bukur. Ai është i gjatë, ka një fytyrë të bukur dhe duket gjithmonë si dhëndri në dasmë. Ai është një personalitet dhe gjithmonë bën shaka me të tjerët", është shprehur Arthur për gazetën gjermane, Ale Oliveira. Arthur Melo e lavdëroi

edhe kapitenin e skuadrës, Lionel Messi, por për arsye përtej aftësisë së tij si futbollist profesionist. "Messi është i mrekullueshëm brenda dhe jashtë fushës. Ai është lideri ynë në zveshtore, e lexon futbollin si askush tjetër dhe është tejet inteligjent. Ai u flet të gjithëve dhe unë ende mbes i mahnitur: "Ai është Messi". Arthuri tanimë




është rehatuar si lojtar mjaft i rëndësishëm në skuadrën e Barcelonës dhe ai e pranon se u përshtat në ekipin e ri më shpejt sesa që e kishte pritët. "Nuk e prisja të

luaja kaq shumë. Mendova se do ta kaloja një periudhë përshatjeje, por të gjithë bashkëlojtarët e mi më ndihmuan shumë", ka theksuar Melo.

“Vieiran e shoh si trajneri të Arsenalit ndonjë ditë sepse mendoj se është ende shumë i ri për të qenë trajneri i ekipit kombëtar. Mendoj se karriera e tij do të rrjedhë me futbollin e klubeve. Ai e ka ndërtuar karrierën e tij me durim dhe mençuri”, është shprehur Wenger.

Arsene Wenger beson se Patrick Vieira do të kthehet në Arsenal, mirëpo këtë herë ai do të emërohet në pozitën e trajnerit. Wenger nuk e di se kur do të ndodhë një gjë e tillë, mirëpo beson se do të jetë në të ardhmen. Ish-mesfushori i Arsenalit, Patrick Vieira, e ka filluar një sfidë të re në botën e futbollit. Ai e kishte marrë punën e trajnerit në ekipin e të rinjve të Manchester City pasi u pensionua, ndërsa pastaj u emërua trajner i ekipit të parë të New York City në MLS. Ai pastaj u kthye në Francë në verën e vitit 2018, kur u emërua trajner i Nices. Vieira ka qenë mjaft mbresëlënës në këtë sezon debutues në Ligue 1 dhe ka



PSG kërkon Icardin

Mauro Icardi drejt Paris Saint Germain! Një lajm sensacional i Gazzetta dello Sport, që u referohet zhvillimeve të fundit në merkato. Sipas kësaj të përditshmeje italiane, kampionët e Francës e kanë vënë emrin e sulmuesit argjentinas të Interit në krye të listës së dëshirave për merkaton e verës. Sigurisht që është herët për të folur për nisjen e bisedimeve, por duke marrë në konsideratë situatën që po kalon Mauro, thyerjen me tifozët dhe klubin zikaltër, gjithçka është e mundur. PSG duhet marrë seriozisht në konsideratë, është në avantazh krahasuar me skuadrat e tjera që duan shërbimet e Icardit, si Atletico e Madridit, që një mesazh sulmuesit ia ka dërguar. Interi mësohet se kërkon 70 milionë euro, shifër që parizienët me pronar Al Khelaifin nuk e kanë problem për ta paguar. Disa muaj më parë Icardi konsiderohej i pashitshëm, madje vlerësohej dyfishin e kësaj shumë, por në këtë realitet të ri klubi zikaltër duhet të marrë përsipër edhe kostot.

WENGER: VIEIRA DO TË JETË TRAJNERI I RI I ARSENALIT



marrë përkrahje edhe për ta zëvendësuar Didier Deschampsin në pozitën e trajnerit të ekipit kombëtar të Francës. Megjithatë, Wenger beson se futbollit i klubeve është më tërheqës dhe ka thënë se e sheh Vieiran në pozitën e trajnerit të Arsenalit ndonjë ditë. “E shoh si trajneri të Arsenalit ndonjë ditë sepse mendoj se është ende shumë i ri për të qenë trajneri i ekipit

kombëtar. Mendoj se karriera e tij do të rrjedhë me futbollin e klubeve. Ai e ka ndërtuar karrierën e tij me durim dhe mençuri”, është shprehur Wenger. “Ai u largua kur ishte i ri, shkoi në Nju Jork, tani është në Nice dhe ai ka marrë mjaftueshëm kohë për t’u pjekur dhe për ta mësuar këtë profesion. Ai është edhe elegant, edhe autoritativ. Ai ka kaluar në një kohë të

vështirë në Nice, por nuk ka shfaqur shenja dobësie. Në periudhe krize e sheh trajnerin e vërtetë”. Wengeri kishte qenë vetë trajner i Arsenalit për plot 22 sezone, mirëpo në fund të sezonit të kaluar i ndau rrugët me klubin, pasi që vitet e fundit nuk kishte qenë shumë i suksesshëm me klubin londinez, gjë që i kishte lënë tifozët të zemëruar.



Tifozët e Unitedit më kanë kërkuar ta fitoj titullin

Mbrojtësi i Manchester Cityt, Kyle Walker, beson se tifozët e Manchester Unitedit janë duke i mbështetur rivalët e qytetit të tyre në garën për titullin e Premierligës, për shkak të urrejtjes së madhe që ata e kanë për Liverpoolin. Manchester City është në garë të zjarrtë me Liverpoolin për titullin e kampionit të Anglisë, pasi që Liverpooli e mban kreun me një pikë më shumë dhe një ndeshje më shumë të zhvilluar se Manchester City, me vetëm pak ndeshje deri në fund. Kjo do të thotë që përballja mes Manchester Unitedit dhe Manchester Cityt do të jetë edhe më interesante sesa zakonisht, pasi që “Djajtë e kuq” janë rivali më i vështirë i skuadrës së Pep Guardiols në katër ndeshjet e fundit. Manchester Unitedi është i përqendruar ta sigurojë një vend në kuadër të top katërshes së Premierligës, ndërsa Manchester City e do titullin e kësaj gare. Të dyja skuadrat u eliminuan javën e kaluar nga Liga e Kampionëve. Por, përkundër urrejtjes që tifozët e Manchester Unitedit e kanë për Liverpoolin, Walker beson se ata i pret një derbi i vështirë të mërkurën. “Tifozët e Manchester Unitedit janë në një pozitë të vështirë natyrisht. Kur unë jam jashtë, duke i shëtitur qentë e mi, tifozët e Manchester Unitedit vijne dhe më thonë: “Do të preferonim që City ta fitoj titullin e ligës para Liverpoolit”, ka zbuluar Walker. “Është e çuditshme, mirëpo unë mund të ju sigurojë se lojtarët e Manchester Unitedit nuk do të na presin me tepih të kuq dhe të na thonë: “Vazhdoni City, shënonani gola”. Ata do të na i bëjnë të vështirë punën sepse është ndeshje futbollit dhe ata janë në luftë për top katërshen dhe ju duhen të gjitha pikët që mund t’i marrin”.

Sarri: Liga e Kampionëve mbivlerësohet

Trajneri i Chelsea, Maurizio Sarri, beson se Liga e Kampionëve është gara më elitare e futbollit në botë, mirëpo insiston se rëndësia e kësaj gare mbivlerësohet nga mediat. Chelsea duhet ta fitojë titullin e Ligës së Evropës ose ta sigurojë një vend në top katërshen e tabelës së Premierligës për t’u kualifikuar për sezonin e ardhshëm të Ligës së Kampionëve. Mospjesëmarrja në garën më prestigjioze të Evropës e dëmton klubin në aspektin financiar, si dhe i ul gjasat që klubi të ketë mundësi t’i transferojë lojtarët më të mirë në botë, të cilët preferojnë ta shfaqin talentin e tyre në skenën më të madhe




të futbollit. “Mendoj se mediat i japin më shumë rëndësi sesa që duhet Ligës së Kampionëve. Natyrisht që është gara më e rëndësishme për klube. Por është një garë

me eliminim të drejtpërdrejtë, kështu që ne kemi nevojë të luajmë mirë, mirëpo në këtë garë të duhet edhe fati”, është shprehur Sarri. “Mund ta kuptoj se nëse qëndron në Ligën e Kampionëve, është sikur një botë tjetër. Kam luajtur dy herë në Ligën e Kampionëve dhe është e qartë që kjo është gara më e rëndësishme për klubet në Evropë dhe në botë”. “Por, kjo është një garë në të cilën të nevojitet fati”. Chelsea do të përballlet me Eintracht Frankfurtin në gjysmëfinale të Premierligës, ndërsa mbrëmë barazuan me Burnleyn, duke humbur pikë të rëndësishme në garën për top katërshen të Premierligës.

Suso dhe 40 milionë euro, Milan bën “çmenduri” për yllin e Napolit

Në vrazhdën e zërave rreth merkatos një lajm me të vërtetë i madh vjen nga Italia. Sot, është zbuluar se Milani po tenton të marrë shërbimet e Lorenzo Insigne nga Napoli. Ka qenë gazeta napolitane “Il Mattino” që ka zbuluar se “Djalli” është duke shfrytëzuar momentin negativ të 27-vjeçarit për ta marrë në Milano. Aktualisht Insigne është i pakënaqur tek Napoli, edhe në ndeshjen ndaj Atalanta ishte në stol, në “San

Paolo” ka vetëm vërshëllima nga tifozët e tij dhe marrëdhënia me trajnerin Ancelotti nuk duket ideale. Këto arsye dhe situata, kanë bërë që Milani të besojë se mund të arrijë tek sulmuesi shtatshkurtër. Sipas gazetës në fjalë Milani do të takohet me agjentin Mino Raiola, i cili do të udhëtojë drejt Napolit për t’i paraqitur ofertën për Insigne. Shërbimet e Suso dhe 40 milionë euro. Në total, një shifër prej 80 milionë eurosh



për italianin e Napolit, që klubi më herët e ka konsideruar të pashitshëm dhe vlera e tij është mbi 100 milionë sipas tyre. Gjithsesi situata mund të ndryshojë pas pakënaqësisë që ka krijuar lojtari.



DASHI 21. mars - 20. prill

Dite goxha e ndërlikuar ka për te qene kjo e sotmja për ata qe janë në një lidhje. Do e kundërshtoni partneri për shume gjera dhe nuk do pranoni te hapni rruge. Beqaret do jene te pazezistueshem dhe do marrin shume propozime, vetëm se do e kenë paksa te vështirë te bëjnë zgjedhjen përfundimtare. Për financa te stabilizuara duhet patjetër te hiqni dore nga disa shpenzime.



DEMI 21. prill - 21. maj

Dite e mërzitshme ka për te qene kjo e sotmja për te gjithë ata qe janë në një lidhje. Mes jush dhe partnerit nuk do ketë asnjë lloj emocione dhe mund te ndihen keq. Beqaret do jene ne humorin e duhur dhe mund te bëjnë edhe ndonjë çmenduri te vogël vetëm për ta ndryshuar statusin. Ne planin financiar do dini si t'i rregulloni problemet dhe do jeni me te qete.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Nuk do merreni vesh aspak me partnerin tuaj gjate kësaj dite dhe here pas here do lindin edhe debate te forta me te. Beqaret do i vlerësojnë mjaft disa miq dhe me ta do jene gati te hedhin edhe hapa te rëndësishme. Ka mundësi qe ne jetën e tyre te këtë ndryshime. Shpenzimet duhet t'i mbani nen kontroll pasi ne te kundërt situata mund t'iu dale jashtë kontrollit.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Jeta juaj ne çift do jete fantastike gjate kësaj dite. Nuk do keni as problemin me te vogël me njeri-tjetrin, përkundrazi te dy do toleroni mjaft dhe do mbani një gjendje te qëndrueshme. Beqaret duhet te bëjnë edhe pak me shume durim ne mënyrë qe ta gjejnë personin me te përshtatshëm. Ne planin financiar duhet t'ua vini veshin këshillave te miqve sepse do ju ndihmojnë pa mase.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Ne përgjithësi jeta juaj ne çift do jete e mbrojtur sot. Do i lini pas krahëve te gjitha problemet e se shkuarës dhe do mendo ni si ta bëni te ardhmen sa me te bukur. Beqaret do jene te zënë me pune dhe angazhime te tjera, prandaj nuk do i përkushtohen gjetjes se dashurisë. Gjendja e financave do jete e shkëlqyer dhe nuk do keni asgjë për çfarë te shqetësoheni.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Te dashuruarit kane për te pasur një dite pasionante sot. Shume nga ëndrrat do realizohet dhe zemra do ndihet e përmbushur. Beqaret do preferojnë aventurat kalimtare, te cilat për te thënë te vërtetën sot do jene me shumice. Urani do jete shume i favorshëm për sektorin e financave. Gjendja ka për t'ua përmirësuar edhe me shume nëse tregoheni te matur me shpenzimet.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Dita e sotme do jete shume e favorshme për beqaret. Ata do kenë mundësi te gjejnë personin e ëndrrave me te cilin do kalojnë një jete te bukur. Te dashuruarit kane për te pasur një dite shume normale dhe pa ndonjë takim mbresëlënës. Çështjet financiare do jene goxha interesante kështu qe mund ta shfrytëzoni rastin për te bere edhe disa investime afatgjata.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Dite rutine ka për te qene kjo e sotmja për te dashuruarit. Për fatin e mire zemra do jete e qete dhe nuk do keni asnjë lloj mosmarrëveshjeje me partnerin. Beqaret do dine si ta joshin personin qe pëlqejnë dhe sot do bëjnë edhe deklarata te forta. Financat nuk do kërkojnë shume vëmendje sepse kohet e fundit i keni marre te gjitha masat qe gjendja mos ketë probleme.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Ju te dashuruarit nuk do keni për çfarë te qaheni gjate kësaj dite sepse partneri do ju garantoje momente fantastike e te mbushur me pasion. Beqareve do ju ndryshoje gjate gjithë kohës humorin dhe as vete nuk do jene te qarte për hapat qe duan te hedhin. Ne planin financiar situata do jete e kënaqshme dhe nuk do keni për çfarë te qaheni.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Për te përjetuar me shume e mocione ne jetën tuaj ne çift sot duhet t'i shtoni dozat e fantazisë dhe imagjinatës. Nëse ja lini çdo gjë kohës, rutina mund t'iu pushtoje. Beqaret do kenë takime te jashtëzakonshme qe do ua ndryshojnë jetën me shpejt nga sa mund ta kishin menduar. ne planin financiar yjet do ju mbështesin gjate gjithë kohës dhe nuk do ju dale as problemi me i vogël.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Kujdes me skenat e xhelozisë gjate kësaj dite sepse situata mund t'iu dale menjëherë jashtë kontrollit. Mos u mundoni as ta kontrolloni ne çdo moment atë qe keni ne krah sepse do i duket sikur i zini frymën. Beqaret do kenë disa takime, por asgjë serioze për t'ua veçuar. Buxhetin do e menaxhoni me shume përkujdes kështu qe gjendja ka për te qene gjate gjithë kohës e mire.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Ka rrezik qe tensioni, mosmarrëveshjet dhe problemet te mbizotërojnë gjate kësaj dite ne jetën tuaj ne çift sot. Nuk do jeni aspak te qete. Beqaret do i kenë idetë shume te qarta dhe nuk do nxitohen për asgjë. Për ta me e rëndësishme është te kalojnë çaste te bukura sesa te krijojnë një lidhje qe nuk do ju ofroje qëndrueshmëri.

DIEN	M	DIENI I MARRËS	P	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	P
L										



DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS	DIENI I MARRËS
I										
T										

ZGJIDHET M. P. P. LEVIZIA BESA, KARRIERA, PR. ADEL, IMZOT, TETEKSI, RI, BATA, TE D. ORTE, OPIUM, IM. O. INK, K. ER, SAMOA, ISH PRESIDENT, TEOHEMAT, I. TERIER, RISK, TIT, ATELJIT.

Shumë i mirë **Sudoku** *(100%)*

9		5				6			1			7			5
	1	6		9	8	2							2		
							7		3	6	1			9	2
				9	4	3			3				6	1	
8			1	5				3		4				5	
		4	8	6	2	1				2	5				6
	7							3		9	1	4			2
		1		8	7			9						9	
4			6					7	2				3		7

SHUMË I MIRË: 927514386, 316798245, 548236971, 165943728, 892175463, 734862159, 679451832, 251387694, 483629517, MEXIKAN: 129374865, 548692371, 736185924, 357946182, 614728539, 982513746, 891467253, 473259618, 265831497

BOTËS I MUNGOJNË 23 MILIONË VAJZA



Ndërprerjet vullnetare të shtatzënisë për të favorizuar lindjen e fëmijëve meshkuj, kanë krijuar disbalancë në rapor-

tin mes gjinive. Kështu rezultoi sipas studimit të fundit mbi gjinitë dhe popullsinë botërore, që ka zgjatur 15 vjet, i pu-

blikuar në Proceedings of the National Academy of Sciences. Sipas statistikave, çdo 100 të porsalindura vajza i korrespondojnë 103-107 meshkuj dhe kjo pabarazi jo naturale ka nisur në vitet 1970, të paktën në 12 vende të botës. Kërkuesit e universitetit të Singaporit kanë studiuar të dhënat demografike të 202 vendeve dhe në disa prej tyre rezultoi se adoptimi i disa normave sociale në favor të fëmijëve djem ka ndikuar në këtë prishje të ekuilibrit, ku në Kinë duket më i theksuar, 118 lindje djemsh kundrejt 100 të vajzave. Ndër këto 12 vende, më prire preferencash për lindjet e djemve hyn edhe vendi ynë, megjithatë kërkuesit vënë në dukje se raporti mes të lindurve vajza e djem tani ka nisur të rikthehet në normalitet.



10-vjeçarja pa duar fiton konkursin për dorëshkrim

Është pa duar, por kjo gjë nuk e ndaloi vajzën 10-vjeçare të fitonte konkursin kombëtar në shkrim. Sara Hinesley ngjyros, pikturon dhe gdhend argjilën. Ajo mund të shkruajë në anglisht dhe pak gjuhën



mandarin.

Kur mësoi të shkruante këtë vit, Sara tha se ishte e lehtë. "Unë kurrë nuk e kam dëgjuar këtë vajzë të thotë 'nuk mundem'", tha Cheryl Churilla, mësuesja e klasës së tretë të Saras. "Ajo është një yll i vogël. Mund të bëjë çdo gjë që i thua dhe jep më të mirën e saj".

10-vjeçarja, që studion në Shkolën Katolike Rajonale të Shën Gjonit në Frederick, fitoi çmimin Nicholas Maxim 2019 në konkursin e dorëshkrimit. Çmimi jepet çdo vit për dy nxënës me aftësi të kufizuara. Sara nuk ka mbajtur kurrë proteza.



Mbetjet elektronike, një tjetër kërcënim për mjedisin

50 milionë tonelata mbetje elektronike prodhon bota çdo vit dhe tashmë ato po shndërrohen në një kërcënim për mjedisin global. Alarmi jepet nga OKB, në raportin e së cilës theksohet se vetëm 20% e tyre riciklohet, të paktën zyrtarisht. Dhe kjo industri mbetjesh elektrike e elektronike që po pushton planetin, ka një vlerë që prek 55 miliardë dollarë.

Sipas OKB duhen masa urgjente, veçanërisht përsa i përket metaleve të rënda dhe të rrezikshme, si dhe lëndëve toksike që përmbajnë të gjitha pajisjet, të cilat përfundojnë në ujë, apo në tokë. Gjatë mbledhjes së fundit të mbajtur në Gjenevë, me përfaqësuesit qeveritarë dhe të organizatave sindikaliste, është arritur në dakordësim për promovimin e investi-



meve në infrastrukturën dhe sistemet e riciklimit në të gjitha nivelet.

Por tjetër urgjencë është edhe domosdoshmëria dhe krijimi i kushteve maksimale të sigurisë për të gjithë punonjësit e sektorit, duke qenë mjaft i rrezikshëm, si për shëndetin e njeriut ashtu edhe për mjedisin.

Sa i pasur është Putini?



Presidenti i Rusisë Vladimir Putin ka deklaruar 118.897 euro të ardhura për vitin 2018, sipas faqes zyrtare të Kremlinit. Të ardhurat mesatare mujore të Putin arrinin në rreth 10 mijë euro.

Sipas autoriteteve ruse, nuk ka ndryshime në pasurinë e Presidentit Putin, i cili zyrtarisht në posedim ka një apartament 77 m2 me një vend parkimi, dhe një apartament të dytë me sipërfaqe 153.7 m2 dhe me vend parkimi. Të dyja këto bane-

sa ndodhen në Rusi. Presidenti Putin zotëron dy edhe automjete që janë model i rrallë, Volga Gaz M21 dhe një furistradë Niva. Të ardhurat e Vladimir Putin për vitin 2018 ishin rreth 137 mijë Euro më pak krahasuar me vitin 2017, kur deklaroi 257.474 euro.

Përpara vitit 2015, të ardhurat e Presidentit të Rusisë ishin më të ulëta. Në vitin 2013, Putin kishte deklaruar 49.492 euro dhe në vitin 2014 - 104.484 euro.

1184 BC - Grekët futen në Trojë duke përdorur Kalin e Trojës (dita tradicionale).

858 - Nikolla I trashëgon Benediktin III si papë

1570 - Beteja mes trupave spanjoll dhe ithtarëve të Sulltan Sulejmanit

1762 - Rusia dhe Prusia nënshkruajnë traktat të paqes

1872 - Shpërthen vullkani i Vezufit

1877 - Lufta ruso-turke 1877-1878: Rusia i shpall luftë Perandorisë Osmane

1898 - Shtetet e Bashkuara i shpallin luftë Spanjës


1921 - Zgjedhjet e para lokale për burra dhe gra në Belgjikë

1953 - Uinston Çerçill shpallet kalorës nga Mbretresha Elizabeta II


1981 - SHBA përfundon embargon e drithit kundër BRSS

2005 - Kardinali Zhozef Raicinger inaugurohet si Papa i 265 i Kishës Katolike me emrin Papa Benedikti XVI.


Vetëm peshkaqenët nuk sëmuren kurrë. Ata mund të ngordhin në rrethana të ndryshme, por janë imune ndaj çdo sëmundje, madje edhe ndaj kancerit.



Fusha më e madhe e naftës në botë është ajo Ghawar. Madhësia e saj është me dimensione 241,5x35,42 km. Ajo mban rezervën sa për të mbushur 4.770,897 pishina noti të lojërave olimpike.



Gjirafat mund të flenë maksimum deri në dy orë në ditë, dhe gjumin e bëjnë me intervale dhe jo me kohë të plotë.



BORXHI

Një njeri hapë një qebaptore afër bankës.

Një ditë shkon një shok e i thotë:
- Vëlla, mos ke nja 500 euro borxh po më duhen, e t'i kthej pastaj. Ky ja kthen:

- Valla, s'mundem se jam marr vesh me këta të bankës, ata nuk shesin qebapë dhe unë nuk jap borxh.



Nuk mund të jesh i vetmuar, nëse ty të pëlqen personi me të cilin je vetëm. (Uayne Dyer)

